

1 E hënë, 3 prill 2023

2 [Deklarata hyrëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi, të gjithëve.

8 Përpara se të fillojmë, do t'u japim mundësinë
9 fotografëve të shkrepin disa fotografi të cilat synojnë t'i
10 përdorin.

11 Në cilësinë time si Kryegjykatës i Trupit Gjykses II dhe
12 në bazë të rregullës 124(1) të Rregullores, çel seancën.

13 I lutem, Sekretares së Gjykatës të paraqesë lëndën.

14 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
15 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
16 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Do ju lutesha palëve tani të prezantohen, duke filluar me
19 Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

20 Z. WHITING: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Për Prokurorinë sot
21 është Ward Ferdinandusse, prokurorët Clare Lawson, Alan
22 Tieger, Mett Halling, James Pace, prokuror; dhe, unë jam Alex
23 Whiting, ushtrues i detyrës së Prokurorit të Specializuar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Tani i drejtohem Mbrojtjes.

1 Z. Kehoe.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëmëngjes. Gregory Kehoe, Luka
3 Misetic, Peter McCloskey, si dhe kolegët Bonnie Johnston dhe
4 Sophie Menegon për president Thaçin.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
6 z. Kehoe.

7 Z. Emerson.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë përfaqësoj Kadri Veselin. Jam
9 me Andrew Strong, Annie O'Reilly dhe z. Hajredin Kuçi, Tess
10 Hughes, Gabriele Caon, si asistente juriste.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
12 z. Emerson.

13 Tani i drejtohem Mbrojtjes së Selimit. Z. Young.

14 Z. YOUNG: [Përkthim] Ne përfaqësojmë z. Rexhep Selimi.
15 Këtu kemi bashkëmbrojtësen Geoffrey Roberts, Eric Tully dhe
16 Dr. Rudina Jasini dhe na asiston znj. Nataliia Ryzhenko,
17 menaxhere e çështjes; dhe Fortuna Sheremeti.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 z. Young.

20 Mbrojtja e Krasniqit, znj. Alagendra.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë jam Venkateswari
22 Alagendra, përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Dhe këtu jam me
23 bashkëmbrojtësit Aidan Ellis, Victor Baiesu, konsulent Bilal
24 Shrefi dhe menaxhere e çështjes, Eva Jerman.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 znj. Alagendra.

2 Nga zyra -- më fal, z. Laws, Mbrojtësi i Viktimave. Fjala
3 është për ju.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Unë jam Simon Laws, Mbrojtësi i
5 Viktimave në këtë çështje gjyqësore së bashku me
6 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska dhe juristin Kiat Wei Ng.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Tani i drejtohem Zyrës Administrative.

9 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar. Për Zyrën
10 Administrative kemi administratoren znj. Fidelma Donlon dhe
11 unë jam Ralph Roche, drejtues i Shërbimeve Gjyqësore.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej se z.
13 Thaçi, z. Veseli, z. Selimi [sipas përkthimit] dhe z. Selimi
14 janë të pranishëm në sallën e gjyqit sot.

15 Seanca e sotme do të zhvillohet në bazë të rregullave
16 124, 125, 126 të Rregullores.

17 Përpara se të filloj, Trupi Gjykses vëren se është
18 dorëzuar një parashtrim të premtën, vonë ditën e premtë, nga
19 Mbrojtja e Thaçit. Ne e rishikuar këtë parashtrim dhe japim
20 këtë urdhër me gojë.

21 Më 31 mars 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një mocion
22 urgjent F0142 [sipas përkthimit], ku i kërkonte Trupit Gjykses
23 të ndalonte ZPS-në, të mos lejonte të shfaqte video të z.
24 Thaçi, gjatë deklaratave hyrëse dhe të z. Selimi, intervistat
25 e tyre përkatëse me ZPS-në.

1 Mbrojtja e Thaçit argumenton sepse i është dhënë më pak
2 se një javë për të rishikuar videot, që nuk janë as në listën
3 materiale të ZPS-së as objekt i mocionit apo kërkesave të ZPS-
4 së për të ndryshuar listën e provave materiale. Mbrojtja e
5 Thaçit parashtron se ZPS-ja ka cenuar apo ka shkelur rregullat
6 që trajtojnë nxjerrjen e materialeve dhe përdorimin dhe
7 përdueshmërinë e provave kundër të akuzuarit.

8 Më 1 prill 2023, ZPS-ja u kundërpërgjigj, se parashtrimi
9 F01413, kërkesa duhet rrëzuar si e vonuar dhe shtrembëruese.

10 Fillimisht, Trupi Gjykues thotë, shprehet, se videot janë
11 thjeshtë intervista të ZPS-së me z. Thaçi dhe z. Selimi.

12 Së dyti, ZPS-ja i ka nxjerrë këto video në dhjetor 2020,
13 që është në paketën 9 dhe 13 të nxjerrjes së materialeve.

14 Së treti, me parashtrimin e protokolluar F00213 të marsit
15 2021, Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit kërkuan nxjerrjen e të
16 gjitha videove dhe regjistrimeve audio krahas transkriptove të
17 dëshmitarëve dhe intervistave e të akuzuarve. Gjykatësi i
18 Procedurës Paraprake e rrëzoi kërkesën me urdhër gojor më 24
19 2021.

20 Trupi Gjykues më tej vëren se më 28 mars 2023, ZPS-ja
21 nxori video të z. Thaçi dhe të z. Selimi, pra, intervista e
22 tyre përkatëse me ZPS-në në paketën 726. Me nxjerrjen e këtyre
23 materialeve, ZPS-ja bëri njoftimin Mbrojtjes se synon të
24 përdorë pjesë të këtyre videove në deklaratat hyrëse bashkë me
25 transkriptin përkues që është nxjerrë më herët.

1 Trupi Gjykues rikujton se në bazë të rregullës 126(1),
2 deklaratat hyrëse duhet të jenë të kufizuara vetëm në
3 materialin lëndor të kësaj çështjeje.

4 Në prezantimin e paraqitjes së provave hyrëse, një
5 shpjegim konciz i provave, mund të paraqitet. Gjithashtu, me
6 fjalë të tjera, përdorimi i materialeve në deklaratë hyrëse
7 nuk do të thotë që do të paraqiten si prova apo do të pranohen
8 si prova. Përveç kësaj, pala që do të bëjë prezantimin nuk
9 mund të kufizohet që të përdorë në deklaratat hyrëse materiale
10 dhe informacione që synon t'i përdorë gjatë gjykimit. Pala që
11 bën prezantimin mund të përdorë materiale gjatë deklaratave
12 hyrëse por nuk do të thotë domosdoshmërisht që do t'i paraqesë
13 si prova gjatë gjykimit.

14 Prandaj, njoftimi dhe nxjerrja e materialeve gjithmonë
15 inkurajohet si kortezi gjatë palëve të tjera dhe pjesëmarrësve
16 dhe, sidomos për materialet që synohen të përdoren vetëm në
17 provat hyrëse, që nuk janë, në kuptimin e ngushtë, objekt i
18 rregullave mbi nxjerrjen e materialeve apo pranueshmërinë e
19 provave.

20 Rrjedhimisht, Trupi Gjykues vlerëson se ZPS-ja nuk është
21 kërkuar t'i nxjerrë këto video dhe as t'i shtojë këto video në
22 listën e provave materiale për t'i paraqitur si prova.

23 Lidhur në sa më sipër, ZPS-ja [sipas përkthimit] rrëzon
24 kërkesën e Mbrojtjes së z. Taçi dhe autorizon ZPS-në të
25 përdorë pjesë të videove të kontestuara si pjesë e deklaratave

1 hyrëse.

2 Urdhri nuk cenon sigurisht debatet juridike sa i takon
3 pranimin të deklaratave të akuzuarit në F01351. Në qoftë se
4 Mbrojtja dëshiron të paraqesë kundërshtime sa i takon cenimit
5 që mund të jetë bërë nxjerrjes së materialeve, konkretisht
6 video të të akuzuarit të intervistave me ZPS-në mund ta bëjë,
7 për t'u përgjigjur materialit F01351, brenda 17 prillit 2023.
8 ZPS-ja do të ketë mundësinë të kundërpërgjigjet në bazë të
9 afatit të rregullës 76.

10 Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë një
11 version të redaktuar publik të materialit F01412 ose të
12 njoftojë Panelin se synon të bëjë riklasifikim si publik
13 brenda 10 prillit 2023. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk ka
14 kundërshtime për riklasifikimin e përgjigjes, përkatësisht
15 F01413. Trupi Gjykses, rrjedhimisht, udhëzon menaxhimin
16 gjyqësor, Shërbimin e Menaxhimit Gjyqësor të riklasifikojë
17 01413 si publik brenda 10 prillit 2023.

18 Dhe kjo mbyll urdhrin me gojë të Trupit Gjykses sa i
19 takon kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit F01412.

20 Tani do kërkoj të pyes të akuzuarit nëse e kuptojnë
21 aktakuzën e ndryshuar dhe do t'u jap mundësinë të konfirmojnë
22 deklaratën e vetë fillestare, veçanërisht për pjesët e reja të
23 paredaktuara të aktakuzës së ndryshuar.

24 Më tej, do të informoj të akuzuarit mbi të drejtat dhe
25 detyrimet dhe në fund do t'u jap fjalën palëve dhe

1 pjesëmarrësve për deklaratat hyrëse duke filluar me Zyrën e
2 Prokurorit të Specializuar.

3 Para se të fillojmë, do tregoj pak historikun procedural
4 të kësaj çështjeje.

5 Më 30 tetor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatës të
6 Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar
7 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
8 Krasniqit.

9 Në 4 dhe 5 nëntor 2020, katër të akuzuarit u arrestuan
10 dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të
11 Specializuara në Hagë, Holandë.

12 Më 15 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia
13 kaloi çështjen Trupit Gjykses.

14 Më 18 janar 2023, Trupi Gjykses mbajti konferencën
15 përgatitore për këtë çështje.

16 Më 15 shkurt 2023, Trupi Gjykses organizoi konferencën
17 për Prokurorin e Specializuar dhe caktoi datën për çeljen e
18 kësaj çështjeje gjyqësore përkatësisht sot, 3 prill 2023 dhe
19 vendosi se paraqitja e provave nga ana e ZPS-së do të fillonte
20 më 11 prill 2023.

21 Rikujtoj se gjatë konferencës për përgatitjen për gjykim,
22 ekipet e mbrojtjes vendosën të mos lexohej e gjithë aktakuza
23 në seancën e deklaratave hyrëse dhe ZPS-ja u pajtua të mos e
24 bënte këtë lexim.

25 A mund ju pyes nëse qëndron ende?

1 Z. Kehoe?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

4 Z. Emmerson?

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

7 Më falni, z. Young?

8 Z. YOUNG: [Përkthim] Po.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

10 Alagenda?

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Prokuror, pa lexuar aktakuzën, ju lutem a mund të

14 lexoni paragrafët 176, 177 të aktakuzës së ndryshuar ku

15 përmbledhen format e përgjegjësisë dhe përcaktohen dhjetë

16 pikat.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

18 Unë do të lexoj paragrafët 176 dhe 177 të aktakuzës ku

19 është paraqitja e provave, me titullin Paraqitja e Provave.

20 Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më lart,

21 Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi

22 me anë të pjesëmarrjes së tyre në ndërmarrje kriminale të

23 përbashkët kryen dhe/ose ndihmuan dhe inkurajuan krimet e

24 paraqitura në këtë aktakuzë. Gjithashtu ose si alternativë,

25 Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi

1 janë përgjegjës si eprorë për krimet e kryera nga vartësit e
2 tyre. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup
3 Krasniqi dinin ose kishin arsye të dinin se krimet e
4 paraqitura në këtë aktakuzë ishin në prag të kryerjes së tyre
5 ose ishin kryer prej vartësve të tyre dhe nuk morën masat e
6 nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e atyre krimeve
7 dhe për ndëshkimin e kryesve të tyre.

8 Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup
9 Krasniqi kanë personalisht përgjegjësi penale për:

10 Pika 1: Përndjekje për arsye politike dhe/ose etnike,
11 krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm në bazë të neneve
12 13(1)(h), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të ligjit;

13 Pika 2: Burgosje, krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm
14 në bazë të neneve 13(1)(e), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të ligjit,

15 Pika 3: Arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar,
16 krim lufte, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c),
17 16(1)(a) dhe 16(c) të ligjit;

18 Pika 4: Akte të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit,
19 i ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(j), 16(1)(a) dhe
20 16(1)(c) të ligjit;

21 Pika 5: Trajtim mizor, krim lufte, i ndëshkueshëm në bazë
22 të neneve 14(1)(c)(i), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të ligjit;

23 Pika 6: Torturë, krim kundër njerëzimi, i ndëshkueshëm në
24 bazë të neneve 13(1)(f), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të ligjit;

25 Pika 7: Torturë, krim lufte, i ndëshkueshëm në bazë të

1 neneve 14(1)(c)(i), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të ligjit;

2 Pika 8: Vrasje e paligjshme, krim kundër njerëzimit i
3 ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(a), 16(1)(a) dhe 16(1)(c)
4 të ligjit;

5 Pika 9: Vrasje e paligjshme, krim lufte, i ndëshkueshëm
6 në bazë të neneve 14(1)(c)(i), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të
7 ligjit;

8 Dhe, Pika 10: Zhdukje me forcë e personave, krim kundër
9 njerëzimit, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(i),
10 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të ligjit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
12 znj. Lawson.

13 Tani do t'u jap mundësinë të akuzuarve të shprehen nëse e
14 kuptojnë aktakuzën e ndryshuar dhe të konfirmojnë
15 vetdeklarimin e tyre fillestar lidhur me fajësinë dhe
16 pafajësinë.

17 Z. Thaçi, a mund të çoheni në këmbë, ju lutem.

18 Z. Thaçi, ju pyes në bazë të rregullës 124(3), nëse e
19 kuptoni aktakuzën e ndryshuar?

20 I AKUZUARI THAÇI: E kuptoj. Jam Plotësisht i pafajshëm.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 z. Thaçi.

23 Gjatë paraqitjes së parë më 9 nëntor 2020 dhe më pas në
24 paraqitjen tjetër më 5 tetor 2022, ju u vetdeklaruat i
25 pafajshëm për të gjitha pikat e paraqitura në aktakuzën e

1 konfirmuar. Tani keni mundësinë të konfirmoni të njëjtin
2 vetdeklarim. A konfirmoni të njëjtin vetdeklarim, z. Thaçi?

3 I AKUZUARI THAÇI: Mund ta përsërisni edhe një herë
4 pyetjen?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në paraqitjen
6 e parë më 9 nëntor 2020 dhe më pas më 5 tetor 2022, u
7 vetdeklaruat i pafajshëm për të gjitha pikat e paraqitura në
8 aktakuzën e konfirmuar. Tani keni mundësinë të konfirmoni të
9 njëjtin vetdeklarim. A konfirmoni vetdeklarimin tuaj fillestar
10 si i pafajshëm?

11 I AKUZUARI THAÇI: Po.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 Mund të uleni.

14 Z. Veseli, a mund të çoheni në këmbë, ju lutem.

15 Ju pyes, në bazë të rregullës 124(3), a e kuptoni
16 aktakuzën e ndryshuar, z. Veseli?

17 I AKUZUARI VESELI: E kuptoj.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Veseli,
19 më 10 nëntor 2020 dhe 5 tetor 2022, u vetdeklaruat i pafajshëm
20 për të gjitha pikat në aktakuzën e konfirmuar. Tani keni
21 mundësinë të konfirmoni të njëjtin vetdeklarim. A konfirmoni
22 vetdeklarimin tuaj fillestar, z. Veseli?

23 I AKUZUARI VESELI: Po. Gjithsesi e shpreh pakënaqësinë
24 time për një vonesë të tillë dy vjeçare e gjysëm. Megjithatë,
25 ju falënderoj. Tërësisht i pafajshëm.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
2 z. Veseli.

3 Z. Selimi, a mund të çoheni në këmbë, ju lutem.

4 Z. Selimi, ju pyes në bazë të rregullës 124(3,) a e
5 kuptoni aktakuzën e ndryshuar?

6 I AKUZUARI SELIMI: Po, e kuptoj.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi, më
8 11 nëntor 2020 dh 5 tetor 2022, ju u vetdeklaruat i pafajshëm
9 për të gjitha pikat në aktakuzën e konfirmuar. Tani keni
10 mundësinë të vetdeklaroni të njëjtin vetdeklarim. A konfirmoni
11 vetdeklarimin tuaj fillestar si i pafajshëm?

12 I AKUZUARI SELIMI: Rikonfirmoj edhe një herë që jam i
13 pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 z. Selimi. Mund të uleni.

16 Z. Krasniqi, a mund të çoheni në këmbë, ju lutem.

17 Z. Krasniqi, ju pyes në bazë të rregullës 124,
18 nënparagrafi 3, a e kuptoni aktakuzën e ndryshuar?

19 I AKUZUARI KRASNIQI: Unë e kam vështirë që ta kuptoj
20 akuzën dhe mënyrën sesi është përpiluar kjo akuzë. Unë nuk kam
21 asnjë lidhje me asnjërën nga pikat që i lexoj Prokurorja para
22 pak kohe.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju pyesim a e
24 kuptoni aktakuzën?

25 I AKUZUARI KRASNIQI: Aktakuzën e kuptoj kështu siç është,

1 po nuk pajtohem me të, pasi nuk mbaj asnjë përgjegjësi për të
2 cilën flet aktakuza.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi,
4 më 9 nëntor 2020 dhe më pas më 5 tetor 2022, u vetdeklaruat i
5 pafajshëm për të gjitha pikat në aktakuzën e konfirmuar. Tani
6 keni mundësinë të konfirmoni të njëjtin vetdeklarim. A
7 vetdeklaroni të njëjtin vetdeklarim si i pafajshëm?

8 I AKUZUARI KRASNIQI: Jam tërësisht i pafajshëm.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 z. Krasniqi. Mund të uleni.

11 Z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi, tani do
12 ju informoj për të disa të drejta të rëndësishme që gëzoni
13 para kësaj Gjykate në bazë të kuadrit ligjor.

14 Ju keni të drejtën për të heshtur që nuk do të jetë
15 faktor gjatë përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë suaj.

16 Keni të drejtën të mos detyroni të pranoni fajësinë apo
17 të dëshmoni.

18 Ju keni të drejtën të mosinkriminoni vetveten apo
19 familjarët më të afërt.

20 Dhe keni të drejtën të përfaqësoheni nga një avokat
21 mbrojtës. Edhe e theksoj se të katërt përfaqësoheni nga
22 mbrojtës të specializuar.

23 Keni të drejtën të keni kohën dhe lehtësirat e nevojshme
24 për të përgatitur Mbrojtjen tuaj si dhe të komunikoni me
25 avokatin tuaj.

1 Ju keni të drejtën të gjykoheni brenda një afati të
2 arsyeshëm.

3 Keni të drejtën të merrni në pyetje ose të merren në
4 pyetje në emrin tuaj dëshmitarët dhe të siguron praninë dhe
5 marrjen në pyetje të dëshmitarëve për llogarinë tuaj.

6 Keni të drejtën të bëni një deklaratë pa betim në lidhje
7 me këtë çështje gjyqësore dhe mund të paraqiteni si dëshmitar
8 nën betim.

9 Z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi, unë ju
10 informova mbi të drejtat tuaj. Por përpara se të vijojmë më
11 tej, më duhet t'ju informoj sipas rregullores dhe mbi
12 detyrimet tuaja dhe masat që parashikohen në bazë të rregullës
13 61(2), pra, Rregullorja jonë e Procedurës dhe e Provave.

14 Unë si Kryegjykatës, kujdesem për mbarëvajtjen në sallën
15 e gjyqit dhe galerinë publike si dhe sjelljen e të
16 pranishmëve. Ndonëse nuk besoj se do të jetë nevoja, kam
17 detyrë t'ju njoftoj z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z.
18 Krasniqi, se si Kryegjykatës, mund të urdhëroj largimin e
19 përkohshëm tuajin nga salla e gjyqit dhe ta zhvilloj procesin
20 pa praninë tuaj në qoftë se ju vazhdoni të prishni
21 mbarëvajtjen e procesit edhe pasi të keni marrë paralajmërim
22 që kjo mund të ketë për pasojë largimin tuaj nga salla e
23 gjyqit.

24 Gjatë largimit nga salla e gjyqit, interesat tuaja do të
25 përfaqësohen prej avokatëve. Trupi Gjykues do të bëjë

1 organizimet e nevojshme që ta ndiqni procesin dhe ta udhëzoni
2 avokatin tuaj jashtë sallës së gjyqit.

3 Megjithëse, unë e thashë, unë nuk besoj se do jetë nevoja
4 të marrim masa të tilla.

5 Dhe për të gjithë të tjerët në sallën e gjyqit dhe
6 galerinë publike, ju kujtoj se si Kryegjykatës mund të marr
7 masat e nevojshme, përfshirë largimin e personit, për të
8 mbrojtur të drejtat e të akuzuarit për një gjykim të drejtë
9 dhe publik ose ruajtjen e dinjitetit dhe normave të
10 mirësjelljes gjatë procesit. Dhe mund të urdhëroj po ashtu një
11 kontroll fizik të çdo personi në sallën e gjyqit dhe galerinë
12 publike nëse është e nevojshme për arsye sigurie apo për
13 administrimin e duhur të drejtësisë.

14 Palët dhe pjesëmarrësit janë në dijeni të nevojës për të
15 pasur masa mbrojtëse për shumë nga dëshmitarët që do të
16 shfaqen në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykues pret që të
17 respektohen në mënyrë të rreptë masat e urdhëruara si brenda
18 dhe jashtë sallës së gjyqit qoftë nga avokatët mbrojtës apo
19 nga punonjësit e tyre në mënyrë që të respektojmë plotësisht
20 masat mbrojtëse që janë urdhëruar.

21 Trupi Gjykues udhëzon përfaqësuesit e palëve të
22 pjesëmarrësve të jenë të kujdesshëm në mënyrën si do t'i
23 drejtojnë pyetje një dëshmitari për të mos zbuluar informacion
24 që është objekt i masave mbrojtëse. Mosrespektimi i këtyre
25 masave apo çdo veprimtari që do të konsiderohet nga Trupi

1 Gjykues si intimidues do të sanksionohet nga Trupi Gjykues në
2 mënyrë të rreptë.

3 Në veçanti, Trupi Gjykues urdhëron palët dhe
4 pjesëmarrësit t'u referohen, t'u drejtohen dëshmitarëve të
5 mbrojtur me pseudonimet e tyre. Trupi Gjykues po ashtu udhëzon
6 palët dhe pjesëmarrësit që të përdorin formulime neutrale nga
7 pikëpamja gjinore dhe të mos përmendin në seancë publike
8 informacione që mund të zbulojnë identitetin e dëshmitarëve të
9 mbrojtur, viktimave apo të afërmeve të tyre.

10 Para deklaratave hyrëse, palët dhe pjesëmarrësit
11 sigurisht kanë detyrimin të sigurojnë se nuk të përmenden
12 emrat e dëshmitarëve të mbrojtur apo informacione të tjera
13 identifikuese apo nuk do të përmenden anëtarët e familjes së
14 dëshmitarëve të viktimave në deklaratat me gojë, prezantimet
15 PowerPoint apo me video. Në qoftë se ka informacione që mund
16 të bëjnë identifikimin e tyre në këto materiale, personi që
17 bën deklaratën hyrëse duhet të njoftojë Trupi Gjykues dhe
18 Trupi Gjykues do ta kalojë në seancë private.

19 Kur mbrojtësit paraqesin një çështje apo kanë një
20 kundërshtim që mund të ketë ndikim në mbrojtjen e
21 dëshmitarëve, kjo duhet bërë në seancë private.

22 Çështjet që kanë lidhje me masat mbrojtëse apo sigurinë e
23 dëshmitarit si rregull nuk duhen diskutuar në praninë e
24 dëshmitarit në fjalë përveç nëse prania e tij apo e saj është
25 e nevojshme.

1 Nëse ndonjë palë, pjesëmarrës apo nga Zyra Administrative
2 vihen në dijeni lidhur me nevojën për të ndryshuar një urdhër
3 mbrojtës për viktimën apo një dëshmitar apo individ tjetër të
4 mbrojtur, Trupi Gjykses dhe palët e tjera duhen njoftuar pa
5 asnjë vonesë.

6 Së fundmi, dua të bëj një deklaratë të përgjithshme sa i
7 takon redaktimeve dhe seancave të mbyllura dhe private.

8 Trupi Gjykses udhëhiqet nga fakti se gjykimet duhet të
9 jenë publike, që publiku të informohet dhe të ketë besim në
10 procesin gjyqësor si dhe të kuptojë aspekte të ndryshme dhe
11 vendimet që merren përgjatë një gjykimi. Ky parim mishërohet
12 në Rregulloren e Procedurës dhe Provave.

13 Redaktimi i emrave dhe të dhënave personale të
14 dëshmitarëve, viktimave dhe të tjerëve në rrezik për shkak të
15 dëshmisë që kanë dhënë dëshmitarët, sigurisht, që është e
16 mundshme dhe kur urdhërohet nga Trupi Gjykses mund të ketë një
17 përjashtim të këtij rregulli të përgjithshëm.

18 Do të udhëhiqemi nga parimi i gjykimit publik, prandaj
19 seancat private dhe të mbyllura duhet përdorur sa më pak dhe
20 të jenë më shumë një përjashtim dhe jo një rregull. Palët janë
21 udhëzuar që ta planifikojnë mirë marrjen në pyetje të
22 drejtpërdrejtë apo kundërpjetet dhe këtë do ta bëjnë
23 gjithmonë duke pasur për synim që pyetjet të merren përgjigjen
24 në seanca private dhe të mbyllura në mënyrë që të përsërisim
25 edhe njëherë seancat e mbyllura.

1 Në bazë të rregullës 126, deklarata hyrëse e ZPS-së nuk
2 është provë. Sidoqoftë, i jep mundësinë ZPS-së të paraqesë një
3 panoramë dhe të njoftojë çfarë provash synon të përdorë në
4 gjykim.

5 Trupi Gjykses synon, pret që palët të kufizojnë
6 parashtrimet e tyre dhe të shmangin deklaratat politike dhe
7 diskutime që nuk kanë çështje me këtë proces gjyqësor.

8 Trupi Gjykses po ashtu thekson se palët, parimisht, nuk
9 duhet të ndërpresin deklaratën hyrëse të palës tjetër. Nëse
10 një palë mendon se duhet të paraqesë një kundërshtim për
11 deklaratën hyrëse, duhet ta bëjë këtë në fund të deklaratës
12 hyrëse të asaj pale.

13 Z. Prokuror, fjala është për ju. Keni pesë orë për
14 deklaratat hyrëse.

15 Z. WHITING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 Me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës, Znj. Administratore,
17 z. Mbrojtësi i Viktimave, zotërinj avokatë të të akuzuarëve.
18 Po fillojmë sot gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
19 Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

20 Z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi ishin anëtarë themelues
21 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të Shtabit të
22 Përgjithshëm të UÇK-së. Gjatë gjithë periudhës së aktakuzës,
23 katër të akuzuarit ishin anëtarë kryesorë të Shtabit të
24 Përgjithshëm dhe mbanin poste të larta drejtuese në UÇK.

25 Ata të katërt, pa asnjë dyshim, ishin udhëheqësit

1 parësorë të UÇK-së dhe për këtë janë vlerësuar dhe nderohen.
2 Por, kishte dhe një anë tjetër më të errët të udhëheqjes së
3 tyre dhe kjo është objekt i gjykimit që po fillon sot.

4 Provat do të tregojnë se katër të akuzuarit në rolet e
5 tyre si udhëheqës të lartë në Shtabin e Përgjithshëm
6 mbështetën dhe zbatuan një politik e cila vinte një shënjestër
7 ata persona të cilët konsideroheshin prej tyre si
8 kundërshtarë, përfshirë ata që akuzoheshin si
9 kolaboracionistë, shpesh mbështetur në asnjë post lidhjeve me
10 institucionet serbe, si edhe personat e perceptuar si jo
11 mbështetës të qëllimeve apo mjeteve të UÇK-së dhe më vonë të
12 qeverisë së përkohshme të Kosovës. Ata që perceptoheshin si
13 kundërshtarë të tillë përfshinin personat e lidhur me Lidhjen
14 Demokratike të Kosovës, e njohur ndryshe si LDK-ja, si dhe
15 persona me përkatësi etnike serbe apo rome.

16 Kjo politikë e promovuar nga të akuzuarit gjatë gjithë
17 periudhës së aktakuzës, kjo politikë, pra, synonte burgosjen,
18 keqtrajtimin, torturimin dhe ndonjëherë vdekjen e
19 kundërshtarëve. Aktakuza përfshin - dhe ne synojmë të
20 vërtetojmë - me qindra burgosje në mbarë Kosovën, zakonisht në
21 kushte të tmerrshme keqtrajtimi dhe mbi njëqind vrasje.
22 Shumica e viktimave të të akuzuarve ishin shqiptarë të Kosovës
23 njësoj si ata. Me zellin e tyre për të shënjestruar dhe
24 eliminuar ata që i mendonin si kundërshtarë, të akuzuarit
25 mbështetën dhe zbatuan një politikë, viktimë e së cilës shpesh

1 binin njerëzit e tyre vetë.

2 Për vërtetimin e këtyre krimeve dhe përgjegjësisë së të
3 akuzuarve do të nevojitet paraqitja si prova e shumë copëzave
4 mozaiku në formën e dokumenteve, të siguruara nga vendndodhje
5 dhe burime të ndryshme dhe e dëshmitarëve, të cilët do të
6 flasin si për krimet ashtu edhe për strukturën e UÇK-së.

7 Krimet që do të vërtetohen ishin të përhapura, të shumta si në
8 gjeografi ashtu edhe në kohë.

9 Lidhur me strukturën e UÇK-së dhe rolet e të akuzuarve,
10 për vërtetimin e tyre do të nevojitet prishja e një niveli të
11 caktuar fshehtësie që ekzistonte si gjatë luftës ashtu edhe
12 pas saj.

13 Gjatë luftës, mbaheshin të fshehta funksionet e UÇK-së,
14 shpesh nga që kjo ishte e nevojshme, sepse UÇK-ja ishte një
15 ushtri rebele që luftonte kundër një shteti. Ushtarët e UÇK-së
16 shpesh përdornin emra të koduar, ndonjëherë mbanin maskë, mund
17 të ishin jo të hapur në komunikimet e tyre me ndërkombëtarët
18 lidhur me funksionimin e vërtetë të UÇK-së. Dhe pas lufte,
19 disa dëshmitarë dhe persona të dyshuar kanë pasur interes për
20 të fshehur strukturën edhe rolet që ekzistonin gjatë luftës.

21 Edhe pse kjo çështje gjyqësore do të vërtetohet përmes
22 shumë copëzash mozaiku, në fund sjellja kriminale për të cilën
23 Prokuroria synon ta vërtetojë është në fakt mjaft e thjeshtë.
24 Siç do ta dëgjoni gjatë deklaratës hyrëse të Prokurorisë sot,
25 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, ku katër të akuzuarit ishin

1 anëtarët më të rëndësishëm, përqafojë në komunikimet dhe
2 deklaratat e veta një politikë të shprehur shumë qartë të
3 shënjestrimit të kolaboracionistëve dhe atyre që
4 perceptoheshin si tradhtarë, përfshirë edhe kundërshtarët
5 politikë. Katër të akuzuarit u përfshinë drejtpërdrejt në
6 artikullimin dhe në zbatimin e kësaj politike, përfshirë këtu
7 dhe duke caktuar dhe mbikëqyrjen e komandantëve dhe
8 strukturave të cilat i vunë në jetë. Dhe, të nderuar Gjykatës,
9 provat do të tregojnë se politika e shpallur u vu vërtetë në
10 jetë. Që prej fillimit e deri në fund të luftës, nga veriu në
11 jug, nga lindja në perëndim të Kosovës dhe në disa pjesë të
12 Shqipërisë, pati një praktikë shënjestrimi të kundërshtarëve,
13 një praktikë kjo që konfirmonte udhëzimin e shprehur dhe
14 faktik që vinte nga lart, nga të katër të akuzuarit.

15 Ajo që do të tregojnë provat është se ndërkohë që u ndoq
16 një fshehtësi për funksionimin e UÇK-së, që vazhdon edhe sot e
17 kësaj dite, qëllimi kriminal i përbashkët për të vënë në
18 shënjestër kundërshtarët që përbën edhe thelbin e kësaj
19 çështjeje gjyqësore, nuk ishte aspak i fshehtë. Mesazhi
20 përsëritej vazhdimisht, si ritëm timpani se kush pretendohet
21 se ishte kolaboracionist dhe tradhtar, përfshirë këtu edhe
22 kundërshtarët politik, përbënte rrezik ekzistencial kundër
23 UÇK-së dhe Kosovës.

24 Kjo përsëritje publike e këtij shënjestrimi ishte
25 thelbësore për realizimin e qëllimit kriminal të përbashkët,

1 thelbësore që njerëzit nëpër njësi dhe zona të vepronin sipas
2 planit. Prandaj edhe qëllimi i shënjestrimit të kundërshtarëve
3 shpallej hapur nga Shtabi i Përgjithshëm ku, siç do ta shihni,
4 përmendej kudo nëpër komunikime, urdhra dhe raportime, si
5 përpara, ashtu edhe gjatë periudhës së aktakuzës.

6 Kur UÇK-ja burgoste njerëz, familjarët e këtyre të fundit
7 kishin frikë se mos i ndodhte gjë, e se mos humbnin jetën,
8 sepse e dinin se mund të keqtrajtoheshin apo të vdisnin dhe e
9 dinin se çfarë do të thoshte të të etiketonin si
10 kolaboracionist apo tradhtar në Kosovë. Dhe që në verën e
11 vitit 1998, ndërkombëtarët filluan të përballëshin me
12 udhëheqësit e UÇK-së, përfshi edhe disa prej të akuzuarve,
13 lidhur me pretendimet për burgosje dhe keqtrajtim sepse edhe
14 ata e dinin. Që atëherë disa prej ndërkombëtarëve e dinin,
15 pra, se çfarë po ndodhte.

16 Kësaj përballjeje, të akuzuarit u përgjigjën duke mos
17 ndaluar, nuk ndaluan. Sepse kjo ishte politika dhe qëllimi i
18 tyre dhe ata ishin angazhuar për këtë. E vetmja gjë që
19 ndryshoi pasi ndërkombëtarët zunë të bënë pyetje është se
20 Shtabi i Përgjithshëm filloi të tregonte më shumë kujdes dhe
21 të ishte më pak i hapur në mënyrën me të cilën e deklaronte
22 politikën. Por, porosia mbeti e pagabueshme, sidomos për ata
23 të cilëve u drejtohej dhe krimet kundër kundërshtarëve vijuan.

24 Përse e bënë këtë? Përse i kryen të akuzuarit këto krime?
25 Provat do të tregojnë se arsyeja ishte për të fituar pushtet.

1 Pushtet në luftë dhe pushtet edhe në Kosovë ndaj personave që
2 perceptoheshin si kundërshtarë të UÇK-së. Mund t'i kenë kryer
3 krimet edhe nga frika, nga frika se mos kauza e tyre do të
4 zhbëhej apo minohej nga ata që i perceptonin si kundërshtarë.
5 Apo mund t'i kenë kryer edhe nga urrejtja apo hakmarrja për
6 shkak të krimeve që kryheshin apo ishin kryer kundër tyre. Do
7 të shihni prova për të dy këta faktorë, të nderuar Gjykatës.
8 Do të shihni se ndonjëherë komunikatat e Shtabit të
9 Përgjithshëm dhe të të akuzuarve i mbronin dhe i justifikonin
10 veprimet e UÇK-së duke theksuar rrezikun që i kanosej UÇK-së
11 prej kundërshtarëve - dhe kjo është frika - ose duke potencuar
12 krimet e palës tjetër - hakmarrja.

13 Por, tek e fundit, motivi i të akuzuarve, arsyeja përse i
14 kryen krimet për të cilat ngrihet aktakuza, as nuk përbën
15 element të veprave penale të aktakuzës dhe, ajo që është më e
16 rëndësishme, as nuk është argument mbrojtës. E në këtë aspekt,
17 të nderuar Gjykatës, kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me
18 sundimin e ligjit në kohë lufte, kohë edhe kur rrezikohet më
19 shumë sundimi i ligjit.

20 Sundimi i ligjit. Për këtë jemi këtu sot. Në kohë lufte,
21 rreziku dhe intensiteti i konfliktit mund të bëjë që përdorimi
22 i mjeteve të paligjshme për përparimin e kauzës të ngjajë i
23 justifikuar dhe i domosdoshëm dhe këtu hyn në lojë ligji.
24 Pikërisht për këtë arsye i kemi ligjet e luftës: Për të
25 frenuar instinktet më të këqija që në mënyrë të pashmangshëm

1 dalin në sipërfaqe në kohë lufte. Për të siguruar që cilësia e
2 të qenit njeri të mos humbasë mes tmerreve të luftës. Ja përse
3 janë ligjet e luftës dhe ja përse ky ligj duhet zbatuar me
4 forcë.

5 Nuk mund të ketë asnjë justifikim dhe nuk ka asnjë
6 justifikim, për ndalimin arbitrar të civilëve dhe të personave
7 të paangazhuar në luftime dhe për keqtrajtimin, torturimin dhe
8 vrasjen e tyre. Kjo bie ndesh me ligjin dhe kjo është arsyeja
9 përse Prokuroria ka ngritur këtë çështje gjyqësore: për të
10 vendosur në vend shtetin ligjor dhe parimin se askush nuk
11 qëndron mbi ligjin, qoftë edhe në kohë lufte.

12 Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë dhe me viktimat dhe me
13 familjet e tyre, viktimat e krimeve të tmerrshme që presin
14 prej më shumë se 20 vjetësh të vihet në vend drejtësia.
15 Viktimat që në mënyrë të përsëritur u thuhet gjatë këtyre 20
16 viteve të fundit se: Duhet të harrojnë, duhet të shohin nga e
17 ardhmja, të mos merren me të shkuarën, të mos flasin, të hapin
18 një faqe të re, se drejtësia është shumë e vështirë, drejtësia
19 është shumë e kushtueshme. Është e lehtë t'i thuash këto kur
20 nuk je viktimë. Por për viktimat e krimeve të ngritura në
21 aktakuzë dhe për familjet e tyre dëmi dhe trauma që kanë
22 pësuar është diçka me të cilën jetojnë përditë. E mbajnë
23 gjithmonë mbi supe. Viktimat kanë të drejtë të dëgjohen. Kanë
24 të drejtë që për ta të vihet në vend drejtësia. Dhe
25 Prokuroria, në këtë çështje gjyqësore kërkon vënien në vend të

1 këtyre interesave.

2 Në këtë deklaratë hyrëse, do të bëjmë një prezantim të
3 përgjithshëm të provave të Prokurorisë si vijon: Së pari, z.
4 Halling do të bëjë një përmbledhje të provave të cilat do të
5 tregojnë pushtetin që ushtronin të akuzuarit në Kosovë në
6 vitin 1998 dhe 1999. Pastaj, z. Ferdinsndusse dhe z. Tieger do
7 të përvijojnë artikulin dhe zbatimit e qëllimit kriminal të
8 përbashkët për të cilin ngrihet aktakuza gjatë së njëjtës
9 periudhë. Z. Pace do të përshkruajë më pas praktikën e
10 krimeve, ndalimet, keqtrajtimet, torturat dhe vrasjet e
11 paligjshme që ndodhën gjatë periudhës së aktakuzës sipas
12 qëllimit kriminal të përbashkët dhe nën pushtetin e katër të
13 akuzuarve. Në përfundim, znj. Lawson do të bëjë një
14 përmbledhje dhe do ta mbyllë duke u përqendruar tek
15 përgjegjësia e katër të akuzuarve.

16 Por, përpara se tua lë fjalën kolegëve, dua të flas pak e
17 të them se me çfarë nuk ka të bëjë kjo çështje gjyqësore, të
18 flas për një vështirësi në prodhimin e çështjes dhe për një
19 pikë për të cilën Prokuroria dhe Mbrojtja pajtohen.

20 Kjo çështje gjyqësore nuk kërkon të procedojë UÇK-në dhe
21 nuk i akuzon të gjithë anëtarët e saj. Nëse dikush e thotë
22 këtë, e ka gabim, është e rreme. Thjesht nuk është e vërtetë.
23 Akuzat ngrihen kundër katër vetëve - Hashim Thaçit, Kadri
24 Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit - se kanë kryer
25 krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në vitin 1998 dhe

1 1999. Shumica e anëtarëve të UÇK-së nuk kishin të bënin fare
2 me këto apo me krimet për të cilat ngrihet aktakuza. Kjo
3 çështje gjyqësore ka të bëjë vetëm me çfarë kanë bërë këta
4 katër të akuzuar, ka të bëjë me krimet që kanë kryer gjatë
5 luftës, me ato për të cilat mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

6 Një vështirësi e cila do ta shoqërojë të gjithë këtë
7 çështje gjyqësore është atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve
8 që ekziston në Kosovë. Është reale dhe është e përhapur. Është
9 një pjesë e arsyes përse kjo Gjykatë u vendos këtu në Hagë dhe
10 kjo gjykatë në mënyrë të përsëritur ka konstatuar në
11 aktgjykime dhe vendimet e saj se frikësimi vijon edhe sot e
12 kësaj dite, përfshirë dhe përmes etiketimit që bashkëpunojnë
13 me këtë Gjykatë si kolaboracionistë dhe tradhtarë.

14 Nuk ka asnjë dyshim që kjo atmosferë do të jetë fort e
15 pranishme edhe në këtë gjykim dhe do të hyjë herë pas here në
16 këtë sallë gjyqi. Dëshmitarëve do t'u duhet guxim të dëshmojnë
17 këtu. Dhe padyshim, që kemi për të parë dëshmitarë të thirrur
18 në këtë sallë gjyqi të cilët nuk do të duan t'i tregojnë
19 Trupit Gjykues ato që dinë, ndonjëherë dhe gjëra të cilat më
20 parë i kanë deklaruar, për shkak të frikës apo edhe për shkak
21 të besnikërisë së gabuar ndaj të akuzuarve.

22 Në fund, u takon të nderuarve Gjykatës të gjykojnë sesi
23 frika dhe besnikëria ndikojnë te provat në këtë çështje
24 gjyqësore dhe si ta vlerësojnë dëshminë e dëshmitarëve parë
25 nga këndvështrimi i realitetit të atmosferës që rrethon këtë

1 gjykim. Por ajo që nuk mund të ndodhë është që frikësimi,
2 frika apo besnikëria të mund ta pengojnë arritjen e një
3 rezultati të drejtë në këtë çështje gjyqësore. Kjo nuk mund të
4 ndodhë dhe nuk ka për të ndodhur.

5 Në fund, të nderuar Gjykatës, dëshiroj ta mbyll me një
6 pikë për të cilën Prokuroria dhe Mbrojtja pajtohen. Mes nesh
7 nuk ka shumë pika për të cilat pajtohem. Por për një gjë, do
8 të pajtohem gjithmonë dhe kjo gjë është se i takon
9 Prokurorisë - dhe vetëm Prokurorisë - barra për të provuar çdo
10 krim për të cilin ngrihet akuzë përtej dyshimit të arsyeshëm.
11 Këtë barrë e pranojmë dhe këtë barrë kemi për ta realizuar në
12 këtë çështje gjyqësore. Mbrojtja nuk ka asnjë barrë dhe ata
13 bashkë me të akuzuarit, pra, avokatët bashkë me të akuzuarit,
14 mund të qëndrojnë të heshtur përballë akuzave. Nuk është
15 nevoja të thonë asgjë.

16 Por për aq sa të akuzuarit të kenë folur, fjalët e tyre
17 mund dhe duhet të merren në konsideratë nga të nderuarit
18 Gjykatës. Mund të merren në konsideratë nëse kanë bërë pohime
19 dhe disa prej të akuzuarve kanë bërë pohime dhe mund të merren
20 në konsideratë nëse kanë bërë mohime të rreme dhe ka pasur
21 edhe prej këtyre.

22 Nëse do të konstatojmë se të akuzuarit kanë mohuar në
23 mënyrë të rreme një fakt në kundërtën e saj që e kanë ditur,
24 pra, që e dinin që ishte i vërtetë, pyetja që duhet t'i bëni
25 vetes është përse? Përse? Përse duan që të mohojnë fakte që i

1 dinë që janë të vërteta?

2 Do t'ju jap vetëm një shembull nga provat përpara se ta
3 mbyll.

4 Gjatë hetimit të kësaj çështjeje, Hashim Thaçi erdhi disa
5 herë fshehurazi në Hagë për t'u dhënë prokurorëve të ZPS-së
6 një intervistë të zgjatur të videoincizuar. Gjatë këtyre
7 intervistave, mes një sërë pranimesh të rëndësishme, ai mohoi
8 shumëçka lidhur me rolin e tij gjatë vetë luftës në rolin e
9 Shtabit të Përgjithshëm. Për shembull, z. Thaçi pretendoi se
10 Shtabi i Përgjithshëm nuk kishte asnjë funksion deri në nëntor
11 të 1998 dhe edhe pas kësaj date, ekzistonte vetëm në letër. Ai
12 mohoi gjithashtu se kishte ndonjëherë dijeni për ndalimet.

13 Provat që do të paraqiten në këtë gjykim, të nderuar
14 Gjykatës, do të tregojnë se këto pretendime ishin të rreme.
15 Ato bien ndesh edhe me vetë deklaratat që z. Thaçi i ka dhënë
16 herë të tjera, me deklaratat që kanë dhënë disa prej të
17 akuzuarve dhe nga provat e shumta që do të paraqiten në
18 gjykim.

19 Ndërkohë që do të dëgjoni provat e paraqitura gjatë këtij
20 gjykimi, të nderuar Gjykatës, ju sugjerojmë t'i bëni vetes
21 këtë pyetje: Përse z. Thaçi erdhi këtu në Hagë dhe bëri këto
22 pretendime të rreme sa i takon rolit të tij gjatë luftës dhe
23 lidhur me UÇK-në? Nga se po donte të largohej? Çfarë po
24 përpiqej të fshihte? Në fund fare, gjykimi që po fillojmë sot
25 do t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve.

1 Por tani do t'ia jap fjalën z. Halling për të vijuar
2 deklaratën hyrëse duke bërë një prezantim të përgjithshëm të
3 provave që vërtetojnë pushtetin që ushtrojnë të akuzuarit
4 gjatë periudhës së aktakuzës. Faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Halling, mund të vazhdoni.

7 Në orën 11.00 do të bëjmë një pauzë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

9 Sot, do të flas për mënyrën se të akuzuarit i kanë
10 ushtruar kompetencat e tyre në UÇK.

11 A mund t'i kërkoj Sekretares së Seancës të transmetojë
12 prezantimin në PowerPoint në ekran për të gjithë për ta parë.

13 Ne kemi përshkruar më parë zhvillimet e UÇK-së gjatë
14 periudhës së aktakuzës si konsolidim dhe zgjerim të një
15 hierarkie ekzistuese dhe funksionale. Sot, ne do të
16 prezantojmë sesi provat e vërtetojnë këtë gjë.

17 Pyetja që shtrohet përpara Trupit Gjykses nuk është se
18 kur apo si u organizuar UÇK-ja në opinionin e ndonjë prej
19 individëve të caktuar apo për mënyrën sesi organizimi i UÇK-së
20 krahasohej me organizimin e një ushtrie tradicionale. Pyetja
21 është nëse të akuzuarit mbanin poste brenda UÇK-së që u
22 lejonte atyre të kryenin krimet që përmban aktakuza. Provat do
23 të tregojnë se ata kishin poste të tilla.

24 Me kalimin e kohës dhe me zhvillimin organizativ, secili
25 prej të katër të akuzuarve kishte kompetenca, autoritet dhe

1 ndikim që ju bënë atyre të mundur që të zbatonin dhe të vinin
2 në jetë qëllimin kriminal të përbashkët dhe të ushtronin
3 kontroll efektiv.

4 Sigurisht, në këtë gjykim do të jetë e rëndësishme të
5 bëhet dallimi midis asaj që aspironte të bënte UÇK-ja dhe asaj
6 që ajo bëri faktikisht. Nuk ka pikë dyshimi lidhur me këtë.
7 Realiteti në terren ndonjëherë mund të jetë kompleks dhe
8 ndonjëherë mund të jetë opak. Megjithatë pohimet e hierarkisë
9 së Shtabit të Përgjithshëm nuk ishin vetëm objektiva
10 aspiratash apo diçka që ekzistonte vetëm në letër. Ekzistojnë
11 demonstrime specifike dhe konkrete të të gjithë autoritetit të
12 saj kolektiv dhe të autoritetit të secilit prej anëtarëve
13 individual gjatë gjithë shtrirjes së kohës së aktakuzës, duke
14 treguar se organizimi reflektuar në deklarata dhe në
15 dokumentet e UÇK-së ishte i përjetuar në terren.

16 Po cila është historia e organizimit të UÇK-së? Në mënyrë
17 që të mbijetonte si një lëvizje çlirimtare klandestine brenda
18 Kosovës, UÇK-ja duhet të kishte një strukturë të organizuar që
19 prej fillesave të saj.

20 UÇK-ja buroi nga Lëvizja Popullore e Kosovës, LPK, e cila
21 besonte se liria për shqiptarët mund të fitohej vetëm përmes
22 forcës. Kjo ishte në kundërshtim me qasjen e Lidhjes
23 Demokratike të Kosovës, LDK dhe kryetarin e saj, Ibrahim
24 Rugova, e cila ishte partia politike dominuese në Kosovë aso
25 kohe dhe mbështeste politikën e rezistencës jo të dhunshme

1 ndaj shtetit serb.

2 Udhëheqësia e UÇK-së buroi kryesisht nga LPK-ja,
3 përfshirë dhe pjesëtarët e ardhshëm të Shtabit të Përgjithshëm
4 të UÇK-së Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Xhavit
5 Haliti dhe pjesëtarin e identifikuar me emër të NKP-së Azem
6 Syla. Përmes Adem Jasharit dhe të tjerëve UÇK-ja filloi të
7 sulmonte në mënyrë të vazhdueshme ushtrinë, policinë dhe
8 bashkëpunëtorët serbë përgjatë viteve 1990.

9 UÇK-ja dhe Shtabi i saj i Përgjithshëm që zakonisht
10 njihen me emrin Shtabi Qendror, ka filluar e ka zanafillën e
11 vet në vitet 1990. Pjesëtari i Shtabit të Përgjithshëm Xhavit
12 Haliti, duke e kujtuar në diapozitivin, në qoftë se mund t'i
13 referoheni diapozitivit këtu, pra, duke kujtuar një bisedë në
14 vitin 1993 të zhvilluar me Azem Sylën thotë:

15 "Ne u pajtuam se gjithçka duhej të funksiononte sipas një
16 hierarkie dhe vendimmarrjeje. Përndryshe dikush mund të
17 keqpërdorte grupe të caktuara apo UDB-ja dhe shërbimi i
18 kundërzbulimit mund të bënte gjëra të rrezikshme".

19 Kjo ishte e rëndësishme. Që prej fillimi hierarkia ishte
20 qendrore e rëndësishme. Hierarkia jepte mbrojtje. Hierarkia
21 ndalonte të infiltruarit. Për rrjedhojë roli i udhëheqjes i
22 Shtabit të Përgjithshëm ishte kritik.

23 Dhe që prej fillimit, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
24 ushtruan autoritete si më vete dhe bashkërisht, në një mënyrë
25 që nuk ishte e kufizuar ngushtë nga titujt dhe vizionet

1 formale.

2 Në diapozitivin B3, Kadri Veseli përgjigjet se:

3 "Në fakt, ne kemi pasur përgjegjësitë tona në periudha të
4 vitit 1998-1999. Ne nuk kishim detyra të veçanta por
5 megjithatë ne bëmë çfarëdo që mundnim. Ne kemi qenë të
6 përfshirë në udhëheqjen, në logjistikë, në zbulim sepse
7 rrethanat ishin të tilla".

8 Thaçi, Veseli dhe Selimi ishin ndërmjet themeluesit e
9 Shtabit të Përgjithshëm. Në një intervistë të medias me Rexhep
10 Selimin në tetor 1999, në diapozitivin B4, Selimi e përshkruan
11 krijimin e Shtabi i Përgjithshëm të UÇK-së dhe ka shtuar që:

12 "...Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli kishin shumë detyra të
13 rëndësishme, si pjesëtarë të Shtabit të Përgjithshëm,
14 veçanërisht në lidhje me kontaktet me jashtë me furnizimet
15 edhe pse jo gjithmonë ata ishin në Kosovë".

16 Në këtë periudhë të hershme dhe, përveç çështjeve
17 politike, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli punuan, ndër të tjera,
18 me organizimin e UÇK-së, duke përfshirë ndërlidhjen ndërmjet
19 pjesëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë dhe të atyre
20 me bazë gjetkë. Rexhep Selimi e kishte bazën në Kosovë dhe së
21 bashku me të tjerët konsolidonte dhe bashkëpunonte veprimet e
22 armatosura në terren.

23 Në një intervistë tjetër, të shfaqur këtu në diapozitivin
24 B5, Selimi e përshkruan 1997 si "një fazë tjetër të zhvillimit
25 të strukturave të UÇK-së dhe gjendjes së luftës, ose ndryshe

1 si vitin e maturimit të UÇK-së, që i lejojë asaj të bënte një
2 luftë me dinjitet, në vitin 1998”

3 Në 1997, UÇK-ja arriti një pikë, ajo mund të kryente
4 sulme të shënjestruara në disa objektiva serbe në të njëjtën
5 kohë. Për shembull, në vitin 1997 UÇK-ja ndërmori një sulm të
6 njëkohshëm kundër 12 stacioneve të policisë me granatahedhëse.
7 Provat do të tregojnë se ky sulm u organizua nga Rexhep Selimi
8 dhe se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli ndihmuan për të siguruar
9 armët e përdorura.

10 Sulmi është përjetësuar në komunikatën numër 37 të UÇK-
11 së, të cilën mund ta shikoni këtu në ekran në diapozitivin B6.
12 Komunikata 37 është e para ndër shumë komunikata që do të
13 shfaqen sot. Dhe z. Ferdinandusse, në veçanti, do të flasë për
14 mënyrën sesi ato kontribuan për qëllimin kriminal të
15 përbashkët.

16 Pra, që përpara periudhës së aktakuzës, të akuzuarit dhe
17 pjesëtarë të tjerë kryesorë kishin lidhje me marrëdhënie
18 besimi të gjata brenda UÇK-së. Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe
19 Rexhep Selimi e filluan këtë ndërmarrje kriminale të
20 përbashkët përmes krijimit të Shtabit të Përgjithshëm dhe
21 udhëheqjes së tyre që herët. Dhe ata, së bashku me Jakup
22 Krasniqin, i cili ishte pjesëtar i Shtabit të Përgjithshëm që
23 në fillim të vitit 1997, ishin të gjithë të konsoliduar në
24 këto role, ndërsa kalendari ktheu faqe në vitin 1998.

25 Pas sulmeve të UÇK-së të llojeve të përmendura më sipër,

1 forcat serbe nisën një përpjekje shumë të përforsuar në zonën
2 e Drenicës në Kosovë me dy operacione në fillim të vitit 1998
3 në Likoshan dhe Qirez që çuan në humbje të mëdha të jetëve të
4 civilëve të cilat e tronditën fort publikun shqiptar.

5 Më 5 deri më 7 mars 1998, forcat IRJ sulmuan kompleksin e
6 Adem Jasharit në Prekaz duke e vrarë atë dhe pothuajse të
7 gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes së tij. Kjo ngjarje
8 kishte një efekt jashtëzakonisht nxitës në Kosovë, me shumë
9 vullnetarë që u kyçën në radhët e UÇK-së. Luftimet u
10 përshkallëzuan më tej në mars të vitit 1998 duke konfirmuar
11 ekzistencën e një konflikti të armatosur jondërkombëtar.

12 Zhvillimet e marsit të vitit 1998 i kërkuan Shtabit të
13 Përgjithshëm të ndante përgjegjësi dhe të konsolidonte radhët
14 e veta. Afër periudhës së aktakuzës, Hashim Thaçi dhe Kadri
15 Veseli e drejtuan një grup me vullnetarë relativisht të lartë
16 të LKP-së në Kosovë. Ky grup përfshiu shumë vetë që më vonë do
17 të caktoheshin në poste komanduese, duke përfshirë Fatmir
18 Limajn, i cili shkoi në Kleçkë dhe në Malishevë; Shukri Bujën,
19 i cili u udhëzua nga Thaçi, në emër të Shtabit të
20 Përgjithshëm, që shkonte në Lipjan; dhe Xhemë Gashi, i cili u
21 dërgua në Drenoc. Limaj dhe Buja janë pjesëtar të identifikuar
22 me emër të NKP-së në këtë çështje gjyqësore. Më vonë do të
23 dëgjoni sesi ata kanë luajtur role në zbatimin e qëllimit
24 kriminal të përbashkët.

25 Përpara sesa të fillojmë me kronologjinë na duhet të

1 flasim për gjeografinë.

2 Gjatë luftës, komanda ishte e ndarë në të gjithë Kosovën
3 në atë që më vonë u njohën si shtatë zona operative, të cilat
4 mund t'i shikoni këtu në diapozitivin B7. Mund të shihni se
5 cilat janë kufijtë e zonave këtu dhe, në fakt, gjatë periudhës
6 së aktakuzës ato kanë ndryshuar dhe nuk kanë tërësisht të
7 njëjtën konfigurim. Këto quheshin nënzona më herët në kohën e
8 aktakuzës dhe ishin pjesë e Zonës më të madhe Operative 1, e
9 cila përfshinte të gjithë Kosovën.

10 Këto zona operative janë njohur zyrtarisht në periudha të
11 ndryshme të vitit 1998, ndërkohë që tani unë do ju tregoj
12 harta të qendrave të ndalimit në të gjitha zonat. Për shkak të
13 faktit që shumë prej këtyre qendrave janë të redaktuara për
14 publikun, unë do i them Sekretares se cilat harta të tregohen
15 dhe cilat nuk duhet të tregohen.

16 Zona e parë është zona e Drenicës, e cila është krijuar
17 në vitin 1998 në pranverë.

18 Ndërkohë që diapozitivi tjetër nuk do të shfaqet, nuk
19 duhet, pra, që të shfaqet për publikun.

20 Shikoni diapozitivin B8.

21 Komandanti i parë i zonës së Drenicës ishte anëtari i
22 identifikuar i NKP-së Sylejman Selimi, i cili më vonë në
23 periudhën e aktakuzës u bë komandanti i përgjithshëm i UÇK-së
24 në vend të Azem Sylës dhe më pas në vend të tij erdhi Sami
25 Lushtaku. Sabit Geci, një pjesëtar me emër i NKP-së i cili

1 është kryesi i drejtpërdrejtë i disa krimeve të akuzuara,
2 kishte gjithashtu përgjegjësi zbulimi këtu dhe në zona të
3 tjera gjatë luftës.

4 Konkretisht zona e Drenicës është zona e vendndalimeve të
5 akuzuara më herët në periudhën e aktakuzës, të tilla si
6 Likoci, ndërsa është edhe zona ku gjenden dhe qendrat e
7 mëvonshme në aktakuzë si Qirezi, Baica dhe zona të tjera të
8 cilat janë të përmendura shprehimisht në aktakuzë.

9 Zona e dytë ishte zona e Pashtrikut, të cilën mund ta
10 shikoni këtu në diapozitivin B9, e cila mund të tregohet për
11 publikun, të paktën si fillim. Zona e Pashtrikut është krijuar
12 zyrtarisht në verën e vitit 1998, por më herët ishin
13 organizuar shtabe lokale në koordinim të drejtpërdrejtë të
14 Shtabit të Përgjithshëm.

15 Në këtë zonë gjendej numri më i madh i qendrave të
16 ndalimit të përmendura në aktakuzë në këtë çështje gjyqësore,
17 duke përfshirë këtu Drenocin, Llapushnikun, i cili gjendet mu
18 në cep të Pashtrikut dhe Drenicës, kufij të e tij kanë
19 ndryshuar me kalimin e kohës, megjithatë ai ka qenë gjatë
20 gjithë kohës nën përgjegjësinë e Shtabit të Përgjithshëm,
21 është zonë e cila përfshinë gjithashtu Malishevën, Kleçkën,
22 Sedllarin, Budakovën, Semetishten, Bubelin, Kostercin dhe
23 Retinë. Dhe kjo është vetëm në pjesën veriore.

24 Ndërkohë që pjesa jugore e zonës së Pashtrikut nuk mund
25 të transmetohet për publikun.

1 Në zonën e jugut janë katër qendra që përmenden në
2 aktakuzë, është Prizreni si dhe Jeshkova. Dhe të gjitha këto
3 zona, pra, janë përsëri të dhëna në diapozitiv, por do të
4 kërkoja të mos transmetoheshin.

5 Musa Jashari u caktua si komandanti i parë. Komandant
6 Drini, Ekrem Rexha, ka qenë komandant për një periudhë kohe në
7 këtë zonë përpara sesa të zëvendësohej në mars të vitit 1998
8 me Tahir Sinanin.

9 Zona e tretë është zona e Dukagjinit, të cilën mund ta
10 shikoni këtu në diapozitivin B10, që mund të transmetohet për
11 publikun. Komandant i kësaj zone është Ramush Haradinaj, ju do
12 të merrni një sërë provash në këtë çështje që tregojnë nivelin
13 e kontrollit të ushtruar prej tij në këtë zonë.

14 Pjesëtarët e Shtabit të Përgjithshëm dhe personi i
15 identifikuar me emrin NKP-së Lahi Brahimaj ishte veçanërisht
16 aktiv në këtë zonë, pra, në zonën e Dukagjinit. Dhe kemi një
17 vend krimi i cili shfaqet në këtë zonë në Jabllanicë.

18 Zona e katërt është zona e Llapit, harta për këtë zonë
19 nuk mund të transmetohet për publikun. Mund ta shihni hartën
20 këtu në diapozitivin B11.

21 Komandanti i zonës ishte Rustem Mustafa, i njohur ndryshe
22 si Remi, një pjesëtar i identifikuar me NKP-së në aktakuzë.
23 Latif Gashi ishte përgjegjës për zbulimin në këtë zonë. Edhe
24 ai është një person i identifikuar me emër NKP në aktakuzë dhe
25 ju do të dëgjoni prova për përfshirjen e tij në krimet e

1 akuzuara në këtë zonë. Kemi vendndalimet e Majacit,
2 Llapashticës, Potokut, Dobrotinit, Sharbanit, kemi gjithashtu
3 edhe Zllashin dhe të cilat po ashtu gjenden në këtë zonë,
4 vendndalimi i fundit dhe i parafundit është vendi i krimeve të
5 akuzuar në çështjen Mustafa përpara kësaj Gjykate.

6 Prishtina dhe vendndalimi i saj, qendra e ndalimit të saj
7 gjenden gjithashtu në këtë zonë.

8 Zona e pestë është zona e Nerodimes dhe dua të them që
9 kjo hartë dhe të gjitha hartat e tjera mund të transmetohen
10 për publikun. Mund ta shohim hartën këtu në diapozitivin B12.
11 Zona e Nerodimës drejtohej nga Shukri Buja. Në bazë të
12 udhëzimeve nga Shtabi i Përgjithshëm, Buja ka qenë përgjegjës
13 për organizimin e UÇK-së në këtë zonë që prej fillimit të
14 prillit 1998 dhe është caktuar komandant zone prej tyre në
15 qershor ose korrik ose dy-tre muaj më pas në të njëjtin vit.

16 Në këtë zonë përfshihen qendra të ndalimit si ato të
17 Bobit, Ivajës, Bicecit, Varoshit e të tjerë.

18 Zona e gjashtë ishte zona e Shalës, komandant i së cilës
19 ishte Rrahman Rama. Nuk ka qendra ndalimi që përfshihen në
20 aktakuzë lidhur me këtë zonë, siç mund ta shikoni në këtë
21 diapozitiv, në diapozitivin B13.

22 Zona e Karadakut është zona e fundit nga shtatë zonat, e
23 cila është krijuar nga fundi i 1998. Komandant i kësaj zone
24 ishte Ahmet Isufi dhe ju do të atakoheni me një komandant dhe
25 person ndërkombëtar i cili do të flasë për nivelin e

1 autoritetit që kishte një person, pra, kishte ky z. Isufi në
2 këtë zonë në verën e vitit 1999. Kjo është zona e cila mund të
3 shihet në diapozitivin e radhës ku kanë ndodhur shumë nga
4 krimet e akuzuara më vonë në këtë aktakuzë, të tilla si ato të
5 Gjilanit, Novobërdës dhe Verbanit.

6 Megjithëse jo një zonë operative e Kosovës, ka krime të
7 akuzuara në aktakuzë në Shqipëri, sikurse mund të tregohet
8 këtu në diapozitivin B15, në Kukës dhe në Cahan në vitin 1999.
9 Kjo zonë ka të bëjë me krimet e akuzuara në çështjen Shala që
10 është në shqyrtim përpara kësaj Gjykate. Ky është një vend
11 tjetër ku Sabit Geci, person i identifikuar me emër si anëtar
12 i NKP-së, ka qenë aktiv gjatë luftës.

13 Këtu mund të shikoni të gjitha zonat. Është diapozitivi
14 B16. Për pjesën më të madhe të periudhës së aktakuzës Shtabi i
15 Përgjithshëm i UÇK-së ishte vendosur këtu në malet e Berishës,
16 në afërsi të Kleçkës, në një vend të quajtur Divjakë. Shtabi i
17 Përgjithshëm ishte në Likoc për pak kohë, në fillim të
18 periudhës së aktakuzës. Ata u zhvendosën përkohësisht në një
19 pikë kohe dhe iu desh që të shkonin në Novoselë, pjesëtarët e
20 Shtabit të Përgjithshëm kanë udhëtuar gjithashtu gjerësisht në
21 shtabet e UÇK-së në të gjithë Kosovën dhe në zona të tjera.
22 Megjithatë, kjo zonë është vendi ku ka qëndruar kryesisht
23 Shtabi i Përgjithshëm.

24 Pas një prezantimi nga një narrator, Fatmir Limaj ka
25 shpjeguar se pse bazën Shtabi i Përgjithshëm e kishte këtu dhe

1 në këtë fragment, pra, jepet shpjegimi sepse UÇK-ja ishte
2 këtu.

3 [Luhet videoincizimi]

4 Z. HALLING: [Përkthim] Këtë mund ta identifikoni dhe nga
5 ky shpjegim dhe mund ta shihni edhe nga hartat. Shtabi i
6 Përgjithshëm ishte, në kuptimin e parë të fjalën, në qendër të
7 të gjithë kësaj.

8 Le t'i kthehemi pranverës së vitit 1998 dhe Shtabit të
9 Përgjithshëm të UÇK-së që po organizonte komandën e UÇK-së në
10 ato pjesë të Kosovës. Hashim Thaçi e ka diskutuar rolin e vet
11 dhe atë të Kadri Veselit në këto zhvillime në fragmentet nga
12 një dokumentar në nder të Agim Çelajt, një pjesëtar i Shtabit
13 të Përgjithshëm i vrarë në verën e vitit 1998. Këto janë dy
14 segmentet kur është shprehur z. Thaçi.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. HALLING: [Përkthim] "Ne mblodhëm së bashku
17 ushtarakët".

18 Vazhdon më tej Thaçi.

19 [Luhet videoincizimi]

20 Z. HALLING: [Përkthim] Thaçi dhe Veseli ishin personat që
21 kishin kontaktuar me ushtarakët në diasporë.

22 Kemi një fragment tjetër të tretë që ka një ERN të
23 ndryshme dhe mban numrin B13 si diapozitiv.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. HALLING: [Përkthim] Ushtarakët u shpërndanë në zonat

1 operative të Kosovës me vendim të Shtabit të Përgjithshëm.

2 Një ndër ushtarakët e sjellë në Kosovë ishte Bislim
3 Zyrapi, i cili hyri në Kosovë në fund të majit 1998, i
4 shoqëruar nga Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli. Zyrapi ishte
5 ushtarak profesionist i cili u bë pjesëtar i Shtabit të
6 Përgjithshëm të UÇK-së në qershor të 1998 dhe mbajti poste të
7 larta drejtuese në UÇK gjatë gjithë luftës.

8 Në një intervistë të medias në 1998, Zyrapi e përshkroi
9 kontrollin që kishte Shtabi i Përgjithshëm rreth asaj kohe siç
10 përshkruhet në diapozitivin B20. Në veçanti, ai thotë:

11 “Unë mund të them se në atë kohë Shtabi i Përgjithshëm i
12 UÇK-së kishte kontroll mbi njësitet e veta, por mënyra sesi
13 shtabi ushtronte kontroll deri atëherë kishte qenë një barrë e
14 madhe për të”.

15 Ky ishte realiteti, kjo ishte situata kur arriti z.
16 Zyrapi.

17 Një raport i komandës së shtabit operativ të Rahovecit në
18 diapozitivin B21 është po ashtu domethënëse. Ky raport
19 përshkruan mënyrën sesi Shtabi i Përgjithshëm dërgoi Xhemë
20 Gashin në zonë gjatë pranverës 1998 për të kontrolluar trupat
21 atje. Gashi dhe zëvendëskomandanti Mahir Hasani, i cili po
22 ashtu përmendet në këtë raport, nuk ishin nga ajo zonë dhe ata
23 morën autoritet mbizotërues dhe drejtues për anëtarët e tjerë
24 lokal të UÇK-së, morën kompetenca eprorë ndaj tyre.

25 Ne i kemi përfshirë këtë raport në provat e mocionit të

1 parë për pranimin e provave dhe do të dëgjojmë persona që mund
2 të flasin për komandën e Drenocit në atë kohë dhe mund të
3 tregojnë sesi u krijua kjo zonë.

4 Përfshirja e Shtabit të Përgjithshëm konfirmohet më tej
5 nga një autorizim zyrtar i emërimit të Mahir Hasanit, që mund
6 të shikohet këtu në diapozitivin B22, në një dokument të
7 gjetur në banesën e Jakup Krasniqit.

8 Më vonë në pranverën e 1998, Shtabi i Përgjithshëm
9 vazhdoi me konsolidimin e vet duke u rikonfiguruar në disa
10 drejtori. Jakup Krasniqi përshkruan se është shpallur zëdhënës
11 i Shtabit të Përgjithshëm dhe ka shkruar një përshkrim të
12 përbërjes së Shtabit të Përgjithshëm.

13 Kjo strukturë organizative, kjo organigramë, iu
14 përshkruan atë çfarë ka thënë, çfarë shpjegimi ka dhënë z.
15 Krasniqi lidhur me formacionin, mënyrën sesi dukej Shtabi i
16 Përgjithshëm në atëkohë. Hashim Thaçi identifikohet si shefi i
17 Drejtorisë së Informacionit si dhe përgjegjës për Drejtorinë
18 Politike së bashku me persona të tjerë, me Kadri Veselin dhe
19 Jakup Krasniqin.

20 Drejtoria Politike kishte për detyrë të formëzonte
21 direktivat politike të UÇK-së dhe të siguronte mbështetjen
22 ndërkombëtare. Z. Thaçi ka thënë, në intervistën e vet me ZPS-
23 në, se ai ishte përgjegjës për, ose kishte marrë përgjegjësi
24 për Drejtorinë Politike drejt fundit të 1998, megjithatë
25 dëshmitë dhe provat në këtë gjykim do të tregojnë që kjo nuk

1 është e vërtetë, përfshirë këtu prova nga të bashkëakuzuarit
2 Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi si dhe dokumente të tjera
3 përfshirë këtu dhe biografinë zyrtare të vetë z. Thaçi në
4 faqen e internetit të qeverisë së Kosovës.

5 Kadri Veseli ishte përgjegjës për Drejtorinë e Zbulimit,
6 i ngarkuar me mbledhjen e informacionit për ekspozimin e
7 kundërshtarëve të UÇK-së. Emra për aparatin e zbulimit
8 ndryshojnë përgjatë konfliktit. Më herët në periudhën e
9 aktakuzës, operativët që punonin për zbulimin dhe
10 kundërzbulimin, punonin për G2, që quhet ndonjëherë dhe ZKZ.
11 Vetë Veseli thotë se G2 ishte departamenti i Shërbimit
12 Informativ të Kosovës dhe shton se ky vendim ishte marrë në
13 qershor të vitit 1998.

14 Veseli gjithashtu ka pohuar në një deklaratë të UNMIK-ut
15 se ai kishte marrë përgjegjësi për G2 në shtator të vitit
16 1998, por përsëri provat do të dëshmojnë se ai kishte
17 përgjegjësi zbulimi përpara asaj kohe dhe, në fakt, ka qenë
18 përgjegjës për këtë gjatë gjithë luftës.

19 Rexhep Selimi ishte Inspektori i Përgjithshëm përgjegjës
20 për Drejtorinë Operative, e cila ndihmonte për organizimin e
21 operacioneve ushtarake, trajnimeve për ushtarët dhe logjistikë
22 trupat në terren. Në këto role, Selimi udhëtonte në të gjithë
23 Kosovën për t'u takuar me komandantë dhe për të inspektuar
24 operacione.

25 Jakup Krasniqi ishte zëdhënësi zyrtar i Shtabit të

1 Përgjithshëm, personi i cili artikulonte pozicionet e Shtabit
2 të Përgjithshëm publikisht.

3 Komunikatat ishin një lloj i veçantë komunikimi me UÇK-në
4 dhe me botën më të gjerë dhe ishin një element i rëndësishëm
5 për Thaçin dhe Krasniqin, veçanërisht në periudhën e
6 aktakuzës. Në rolin e vet në drejtorinë politike, politika e
7 UÇK-së ishte përgjegjësi e Thaçit. Si zëdhënës Krasniqi ishte
8 ngarkuar për t'i dhënë zë këtyre qëndrimeve.

9 Kjo ndarje detyrash u confirmua nga Rexhep Selimi në
10 intervistën e tij me ZPS-në. Selimi, në diapozitivin B24,
11 fillon duke folur për Sokol Bashotën, një anëtar i Shtabit të
12 Përgjithshëm që u bë zëvendëskomandant i UÇK-së, përpara se të
13 fliste për rolet e Thaçit dhe Krasniqit pas emërimit të
14 Krasniqit si zëdhënës i UÇK-së.

15 Si koment paraprak përpara sesa të dëgjojmë këtë video,
16 dua të them që i kemi hequr të gjithë përkthyesit që flasin
17 mbi këto fragmente, duke e pastruar videon në mënyrë që ju të
18 gjithë të dëgjoni atë çfarë thotë Selimi me fjalët e veta.

19 [Luhet videoincizimi]

20 Z. HALLING: [Përkthim] Krasniqi merrej me komunikatat,
21 ndihmohej dhe suportohet nga Thaçi. E njëjta pjesë e
22 intervistës së Selimit përshkruan sesi informohej Shtabi i
23 Përgjithshëm normalisht për përmbajtjen e këtyre komunikatave
24 përpara sesa ato të nxirreshin.

25 Dhe dua që të sqaroj për sekretarinë që në qoftë se nuk

1 them që diapozitivët nuk mund të transmetohen për publikun, të
2 gjithë diapozitivët duhet të transmetohen për publikun.

3 UÇK-ja vazhdon të miratojë struktura të tjera ushtarake
4 më formale për të përcaktuar më tej hierarkinë brenda radhëve
5 të veta në periudhën e verës së 1998. Po identifikoheshin
6 brigada paralelisht me shefat lokal të zbulimit dhe
7 komandantët e policisë ushtarake.

8 Dhe këto zhvillime kanë ndodhur përpara syve të Shtabit
9 të Përgjithshëm. Siç mund të shihet në diapozitivin B25, sipas
10 fjalëve të një përgjigje të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së
11 këtu në këtë diapozitiv ndaj një nënzone operative në mesin e
12 vitit 1998 thuhet:

13 "Hierarkia respektohet në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës ..."

15 Ky udhëzim gjendet në shënimet e shkruara me dorë të
16 Jakup Krasniqit dhe është gjetur në shtëpinë e tij si material
17 i sekuestruar. Në shënimet e tij pranë kësaj fjalie mund të
18 shihni të shkruar:

19 "Në situatën tonë duhet të respektojmë hierarkinë me
20 fanatizëm".

21 Kjo është një frazë domethënëse. Ajo pranon se në
22 rrethanat ose "në situatën tonë" hierarkia ishte e rëndësishme
23 për të akuzuarin dhe për udhëheqjen e UÇK-së. Dhe më tej
24 tregon se kishte një interes fanatik nga ana e udhëheqjes për
25 ta imponuar atë hierarki. Dhe këtë duhet ta mbani parasysht kur

1 të shqyrtoni qëllimin kriminal të përbashkët edhe rolin e
2 Shtabit të Përgjithshëm dhe të akuzuarëve në zbatimin e tij.

3 Shtabi i Përgjithshëm e bëri të qartë se ai e komandonte
4 UÇK-në. Dhe njësitet në terren e dinin këtë gjë. Më 29 qershor
5 1998, UÇK-ja thirri një mbledhje në komunën e Malishevës, e
6 regjistruar, ku folën anëtarët e identifikuar të NKP-së,
7 Fatmir Limaj dhe Shukri Buja. Dëgjoni sesi e përshkruan Limaj
8 komandën e njësitit të tij në diapozitivin B26.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. HALLING: [Përkthim] "Është një sepse është nën
11 komandën e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës".

13 Autoriteti i Shtabi i Përgjithshëm mbi zonat e tij nuk
14 është më i qartë sesa kur UÇK-ja kishte mosmarrëveshje
15 ndërpersonale me pjesëtarët e armatosur të forcave të
16 armatosura të qeverisë së Rugovës të njohur si FARK. UÇK-ja
17 pranoi të luftonte përkrahë FARK-ut, por kjo çoi në
18 mosmarrëveshje se kush kishte komandë më të gjerë mbi bazat
19 operative dhe kush ishte epror ndaj kujt.

20 Në zonën e Dukagjinit, Ramush Haradinaj emëroi Tahir
21 Zemajn e FARK-ut në krye të Brigadës I brenda zonës. Zemaj
22 kishte një mbështetje të tillë të madhe brenda zonës sa që u
23 zgjodh komandanti i zonës së Dukagjinit duke zëvendësuar
24 Haradinajn me një vendim që Haradinaj e pranoi.

25 Ndryshimi i komandës u raportua nga shërbimet e

1 inteligjencës të drejtuar nga Kadri Veseli dhe urdhrat
2 ushtarake dhe të dhënat në gusht të vitit 1998 tregojnë se
3 çfarë ka ndodhur pas këtij ndryshimi.

4 Pra, persona të UÇK-së, përfshirë këtu Hashim Thaçin,
5 Rexhep Selimin, udhëtuan në zonën e Dukagjinit, anuluan
6 emërimin e Zemajt dhe riemëruan Haradinajn si komandant të
7 zonës. Këtë ju mund ta shikoni nga ky dokument që jepet në
8 diapozitivin B27, të nënshkruar nga Tahir Zemaj, që struktura
9 me Zemajn në komandë u kundërshtua nga Shtabi i Përgjithshëm
10 duke e bërë të qartë si drita e diellit se kush e kishte
11 fjalën e fundit për emërimet si komandant zone.

12 Shtabi i Përgjithshëm nuk bënte vetë emërimet në zonat
13 operative. Po ashtu drejtonin veprimtaritë e policisë
14 ushtarake dhe ndalimet. Dhe kjo mund të shihet në një
15 dokumentar të korrikut 1998, *slide* B28, është një klip i Sahit
16 Jasharit, që është shef i policisë ushtarake në zonën e
17 Drenicës.

18 [Luhet videoincizimi]

19 Z. HALLING: [Përkthim] Gjithmonë të përgatitur që të
20 zbatonin urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm.

21 Hierarkia që shprehet Sahit Jashari, në fakt, gjen
22 konfirmim në një urdhër të 2 korrikut 1998 të Shtabit të
23 Përgjithshëm që është gjetur në banesën e Jakup Krasniqit, që
24 po e shohim këtu në diapozitivin B29. Specifikon që në një
25 takim të Shtabit të Përgjithshëm në këtë takim u vendos që të

1 bëhej konfiskimi i automjeteve me forcë dhe për këtë kërkohet
2 leje e posaçme nga komandanti i regjionit. Më pas vijon se
3 policia ushtarake kishte të drejtën të ndalonte personat e
4 dyshimtë dhe materialet apo ky person apo automjeti do të
5 trajtohej më tej nga autoriteti përkatës.

6 Siç do ta shihni, disa nga viktimat të cilat janë
7 paraqitur në këtë çështje gjyqësore janë ndaluar në automjetet
8 e tyre dhe janë ndaluar fiks në formën siç përshkruhet në këtë
9 urdhër.

10 Dhe ky është vetëm një nga shumë vendimet që do të
11 dëgjoni sot që janë marrë gjatë takimeve të Shtabit të
12 Përgjithshëm të UÇK-së. Provat na tregojnë se takoheshin
13 shpesh për gjatë gjithë periudhës së paraqitur në aktakuzë.
14 Edhe kur disa prej anëtarëve udhëtonin ende merreshin vendime
15 dhe anëtarët e tyre azhurnoheshin lidhur me zhvillimet më të
16 fundit.

17 Diapozitivët e radhës nuk mund të përcillen publikisht.

18 Sa i takon veprimtarive të policisë ushtarake në nivel
19 zone, këtu kemi një vendim të policisë ushtarake nga zona e
20 Dukagjinit që është mesi i 1998, konkretisht në diapozitivin
21 B30. Mund të shihni ndalimin e një personi që ishte autorizuar
22 formalisht duke e bërë të nevojshëm urdhrin nga komandanti për
23 lirimin e këtij personi. Mund ta shihni këtu kur është
24 urdhëruar se ky i ndaluar duhej liruar por ndërkohë automjeti
25 dhe arma e zjarrit i duheshin konfiskuar.

1 Ajo që nuk shihni këtu, në këtë urdhër, është se personi
2 në fjalë u ndalua në mënyrë arbitrare, u akuzua se ishte
3 kolaboracionist dhe u rrah nga UÇK-ja. Do të dëgjoni në fakt
4 prova për këtë person në fillim të gjykimit.

5 Secila nga zonat individuale të UÇK-së kishte dhe
6 funksionarë të zbulimit brenda organizimit të cilët kryenin
7 funksione zbulimi dhe kundërzbulimi. Në përgjithësi i
8 raportnin komandantëve të zonës, po këto raporte i
9 përcilleshin edhe Drejtorisë së Zbulimit që drejtonte Kadri
10 Veseli. Raportet e zbulimit po ashtu i përcilleshin anëtarëve
11 të Shtabit të Përgjithshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë, madje
12 ndonjëherë anashkalonin edhe kanalet normale të raportimit.

13 Shtabi i Përgjithshëm ishte i informuar mbi veprimtaritë
14 e policisë ushtarake dhe të zbulimit për gjatë gjithë
15 konfliktit.

16 Në një diapozitiv tjetër, që nuk duhet transmetuar
17 publikisht, ky dokument është diapozitivi B31, flet për fletë-
18 arrestimet në Drenoc, që nga përmbajtja, duket të jenë shkruar
19 rreth mesit të vitit 1998. Mund të shihni këtu një vrasje për
20 të cilën është ngritur akuzë dhe zhdukje me forcë e një
21 viktime në fund të kësaj faqes. Ky material është gjetur në
22 banesën e Jakup Krasniqit.

23 Shtabi i Përgjithshëm kishte autoritet të urdhëronte
24 ndalimin edhe madje ekzekutim personash dhe do të dëgjoni
25 prova nga dëshmitarët që do t'u shpjegojnë sesi lëshoheshin

1 urdhrat për të vrarë kolaboracionistët nga Shtabi i

2 Përgjithshëm.

3 Që tani e në vijim, të gjitha diapozitivët e mi mund të
4 përcillen publikisht.

5 Në korrik 1998, UÇK-ja bëri një përpjekje të pasuksesshme
6 gjatë një ofensive për të marrë zonën e Rahovecit nga forcat
7 serbe. Fitorja e hershme u venit shpejt për shkak të
8 kundërsulmit serb, që detyroi UÇK-në të tërhiqej nga shumë
9 prej zonave që kishte nën kontroll. Ka prova se Shtabi i
10 Përgjithshëm, në fakt, nuk e nxori urdhrin fillestar për të
11 hyrë në Rahovec por Thaçi, Veseli, Selimi dhe anëtarë të tjerë
12 të Shtabit të Përgjithshëm shumë shpejt hynë në zonë për të
13 drejtuar veprimtaritë e njësiteve të UÇK-së në terren. Gjatë
14 kësaj kohe, ju do të dëgjoni prova sesi UÇK-ja mori civilët
15 serbë në zonën e Rahovecit. Disa nga këta persona nga këto
16 operacione janë viktima të vrasjes së paligjshme në Listën B
17 konkretisht nga Malisheva dhe do të dëgjoni prova për ta gjatë
18 gjykimit. Shtabi i Përgjithshëm vijoi të punonte dhe të
19 drejtonte operacionet pas kësaj ofensive. Në gusht 1998, për
20 shembull, një delegacion i Shtabit të Përgjithshëm ku ishte
21 dhe Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi udhëtuan drejt
22 zonave të Shalës dhe Llapit dhe ndër të tjera formalizuan edhe
23 komandën e tyre.

24 Manifestimi i autoritetit, pra, ky ushtrim autoriteti që
25 kemi diskutuar përputhet me dokumentet normative që

1 reflektojnë kompetencat që kishte Shtabi i Përgjithshëm në të
2 gjitha zonat operative. Këto rregullore u krijuan nga Shtabi i
3 Përgjithshëm dhe anëtarët kishin dijeni për to. Do të shihni
4 shumë urdhra ushtarakë nga zonat operative në këtë gjykim që u
5 referohen shprehimisht këtyre rregulloreve si bazën e tyre.

6 Jakup Krasniqi në librin e tij Kthesa e Madhe -ERN U115-
7 8743-U015-8935-ET, e rishikuar, që është përkthyer gjithashtu
8 Pikëkthesa e Madhe dhe ai flet për përfshirjen që ka pasur në
9 hartimin e këtyre rregulloreve. Kthesa e Madhe jep
10 informacione të brendshme sesi ishte organizuar UÇK-ja për
11 gjatë gjithë luftës dhe mund të konfirmohet dhe nga prova të
12 tjera në shumë drejtime të rëndësishme.

13 Në një takim, rastësisht, të ish-komandantëve të UÇK-së
14 ku merrte pjesë Thaçi, Veseli dhe të tjerë në 2001, që shohim
15 në diapozitivin B32, Hashim Thaçi tha se Jakup Krasniqi nuk
16 boton libra pa u konsultuar me "ne".

17 Rregulloret e para që do të diskutojmë janë rregulloret e
18 përkohshme ose provizore për organizimin e brendshëm të
19 ushtrisë, të miratuara në fillim të korrikut të vitit 1998 që
20 janë gjetur në banesën e Jakup Krasniqit. I shohim këtu në
21 diapozitivin B33. Krasniqi pranon tek libri Kthesa e Madhe që
22 është një nga hartuesit e këtij dokumenti dhe ka udhëzime të
23 detajuara për komandën dhe kontrollin brenda UÇK-së dhe flet
24 mbi nevojën për të zbatuar urdhrat dhe për të respektuar
25 hierarkinë.

1 Provat do të tregojnë se këto rregullore u dërguan tek
2 zonat operative. Ky dokumenti i mes-1998 që u gjet në banesën
3 e Krasniqit tregon sesi duhej respektuar me fanatizëm
4 hierarkia dhe po ashtu bën me dije se zona e Dukagjinit do të
5 merrte një kopje të këtyre rregulloreve provizore apo të
6 përkohshme dhe, në fakt, i morën. Mund ta shihni ndikimin që
7 kanë pasur sepse e kanë përdorur si bazë të dokumentet e UÇK-
8 së, siç e shohim tek autorizimi që paraqitet në diapozitivin
9 B34 që Faton Mehmetaj të krijonte strukturat e zbulimit në
10 zonën e Dukagjinit, në mbështetje të këtyre rregulloreve
11 provizore.

12 Po ka gjithashtu edhe rregullore për Shtabin e
13 Përgjithshëm të UÇK-së, e shohim këtu në diapozitivin B35,
14 fragmentet përkatëse janë gjetur në banesën e Jakup Krasniqit
15 dhe janë dorëzuar për t'u pranuar si prova gjatë gjykimit.

16 Ky dokument artikulon shprehimisht se Shtabi i
17 Përgjithshëm operonte si një komandë e unifikuar dhe ishte
18 niveli më i lartë drejtues dhe organi komandues i UÇK-së. Mund
19 të shihni gjetkë në këtë dokument një përshkrim të rolit që
20 kishte drejtorja e zbulimit, në veçanti, duke e bërë të qartë
21 se ishte një organizatë e rëndësishme kjo pranë Shtabit të
22 Përgjithshëm.

23 Do të shihni prova se rregulloret e Shtabit të
24 Përgjithshëm të UÇK-së në mënyrë të përsëritur shërbejnë si
25 bazë për urdhrat që lëshonte Shtabi i Përgjithshëm. Më

1 konkretisht e shohim tek diapozitivi B36, ky është një urdhër
2 i nënshkruar nga Bislime Zyrapi mbi emërimet në zonën e
3 Pashtrikut dhe ka përdorur si bazë këto rregullore. Për një
4 tjetër, ky urdhri që është gjetur në banesën e Jakup
5 Krasniqit, konkretisht në diapozitivin B37, është për
6 komandantët e zonës dhe faktin që duhet të dërgonin raporte
7 ditore Shtabit të Përgjithshëm dhe kjo është po ashtu në
8 mbështetje të rregullores së brendshme të Shtabit të
9 Përgjithshëm.

10 Në vijim janë rregulloret për organizimin e zbulimit. Një
11 kopje po ashtu është gjetur në banesën e Krasniqit, e shohim
12 këtu në diapozitivin B38. Krasniqi shkroi në Kthesën e Madhe
13 se ai po ashtu kishte ndihmuar në përpilimin e këtyre
14 rregulloreve që është miratuar konkretisht kjo rregullore më
15 23 korri 1998. Mund të shihni nivelin e autoritetit që
16 theksohet mbi aparatit e zbulimit në këtë dokument.
17 Rregullorja kërkon disiplinë të hekurt dhe ndarje të qartë të
18 autoritetit.

19 Rregulloret parashikonin që zbulimi duhej organizuar në
20 nivel selie dhe personeli në të gjitha nivelet dhe mund të
21 shihni në këto rregullore zbulimin ushtarak si ishte
22 organizuar në nivel qarku dhe u ishte shpërndarë operativëve,
23 funksionarëve të zbulimit në të gjitha zonat e UÇK-së dhe e
24 shohim të ilustruar këtë në diapozitivin B39.

25 Ky dokument ndër të tjera parashikon që shefi i Shërbimit

1 të Zbulimit ishte në varësi të drejtpërdrejtë të komandantit
2 të forcave të armatosura.

3 Dokumentet e fondit rregullator janë miratuar pak a shumë
4 në të njëjtën periudhë dhe unë do të diskutoj sot po ashtu
5 rregullorja e disiplinës së UÇK-së, që e shohim në
6 diapozitivin B40. Kemi dhe një dublikatë që është SITF0068883
7 deri në SITF000688899.

8 Këto rregullore trajtojnë kush kishte autoritet për të
9 zbatuar disiplinën brenda UÇK-së, përfshirë edhe shefat e
10 drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm apo krerët. Do të shihni
11 nga nenet 3 dhe 7 të këtij dokumentit se ka detyrime që të
12 gjithë oficerët ushtarakë të jenë të barabartë kur bëhet fjalë
13 për disiplinën dhe se duhet të zbatojnë urdhrat nga një epror
14 edhe kur ky person nuk është eprori i tyre i drejtpërdrejtë.
15 Provat edhe njëherë do të tregojnë se këto rregullore të
16 disiplinës u përdorën, në fakt, kur donte UÇK-ja t'i përdorte.

17 Këtu në diapozitivin B41 është një vendim lidhur me një
18 apel në vijim të një procedure disiplinare i nënshkruar nga
19 Bislam Zyrapi. Kemi dhe një tjetër shembull në diapozitivin
20 B42, kjo vjen nga zona e Nerodimës. Dhe ka shumë të tjera
21 syresh.

22 Në bazë të këtyre rregulloreve dhe përveç pushtetit të
23 tyre *de facto* si figura të larta udhëheqëse brenda UÇK-s , të
24 akuzuarit, përmes posteve të tyre zyrtare në Shtabin e
25 Përgjithshëm kishin kompetenca të gjera formale ndër të cilat

1 lavdërimin, gradimin, disiplinimin ose ndalimin e ushtarëve.

2 Një marrëveshje për armëpushim e negociuar nga diplomatët
3 u nënshkrua mes IRJ-së dhe ndërkombëtarëve më 15 tetor 1998.
4 Provokimet dhe luftimet, në fakt, vijuan edhe UÇK-ja në fund
5 të atij viti deklaroi se do të rifillonte veprimtaritë e plota
6 të armatosura në vitin 1999.

7 Shtabi i Përgjithshëm vijoi të komunikonte mesazhin
8 politik në mënyrë të drejtpërdrejtë tek ushtarët e UÇK-së.
9 Këtu kemi një video në diapozitivin B43, që është Jakup
10 Krasniqi që u drejtohet ushtarëve të UÇK-së në fund të
11 nëntorit 1998 në Divjakë në një fjalim që festoi 1-vjetorin e
12 paraqitjes së parë të UÇK-së. Mund të shihni autoritetin e
13 Krasniqit që e shpalos tek sa ecën në rreshtin e ushtarëve.

14 [Luhet videoincizimi]

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do ta dorëzojmë të gjithë videon
16 që ta merrni parasysh të nderuar Gjykatës në kohën e duhur,
17 por do luajmë edhe një fragment tjetër për të parë ku Krasniqi
18 përshkruan organizimin dhe arritjet e UÇK-së.

19 [Luhet videoincizimi]

20 Z. HALLING: [Përkthim] Në kontekstin e tërësisë së
21 provave që do të shfaqen, është e qartë se kjo referencë, pra,
22 "spektrit të armiqve" në këtë video i bën një referencë të
23 përceptë, në fakt, partisë LDK.

24 Në fund të vitit 1998 dhe në vijim të asaj që kishte një
25 ofensivë e rëndë serbe, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së u

1 zgjerua edhe më tej. Këtu në diapozitivin B44 mund të shihni
2 vizualisht bazuar në përshkrimin e hollësishëm të Jakup
3 Krasniqit të organigramës, pra, si ishte organizuar UÇK-ja aso
4 kohe. Mund të shihni Krasniqin që bën me dije emërimin e vet
5 si zëvendëskomandant i UÇK-së dhe rolin që kishin tre të
6 akuzuarit e tjerë: Hashim Thaçi, politik; Rexhep Selimi,
7 inspektor i përgjithshëm; Kadri Veseli, funksionar zbulimi.

8 Mund ta shihni në vendimin 061168-061168, i datës 2
9 nëntor 1998 dhe i nënshkruar nga Zyrapi, Veseli dhe të tjerë
10 se ishin miratuar struktura të reja të UÇK-së.

11 Ristrukturimi në vjeshtën e 1998 përfshiu në fakt dhe
12 formalizimin e një drejtorie për policinë ushtarake që duhet
13 të mbikëqyrte policinë ushtarake që, në fakt, ekzistonte
14 tashmë. Përgjegjësitë e policisë ushtarake që shtjellohen në
15 rregulloren provizore të ushtrisë janë zhvilluar dhe
16 përditësuar në një dokument të vitit 1998 që e ka lëshuar
17 Fatmir Limaj në cilësinë e tij si drejtor i kësaj drejtorie,
18 që mund ta shohim në diapozitivin B45.

19 Mund të shihni zinxhirin e komandës këtu:

20 "Organet e policisë ushtarake janë në varësi të
21 Drejtorisë së Policisë Ushtarake që emëron komandantët në
22 nënzonat operative të policisë ushtarake".

23 Mund të shihni më pas, në të njëjtën faqe, se policia
24 ushtarake duhej që të ndihmonte dhe të bashkëpunonte me
25 njësitet e zbulimit të UÇK-së.

1 Limaj si përgjegjës i Drejtorisë së Policisë Ushtarake
2 është një shembull si Shtabi i Përgjithshëm - rrjedhimisht të
3 akuzuarit caktojnë një anëtar të NKP-së - që përmendet me emër
4 në një post të lartë autoriteti. Do t'ju tregojmë se ky
5 anëtari NKP-së me emër në mënyrë të drejtpërdrejtë kreu krimet
6 për të cilat ngrihen akuza tek sa ushtronte këtë autoritet,
7 përfshirë drejt anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm dhe
8 komandantët e zonave që janë dënuar për krime lufte pas
9 konfliktit.

10 Shtabi i Përgjithshëm vijoi të drejtonte aktivitetet e
11 policisë ushtarake përtej emërimit të Limajt. Ky urdhër i
12 fillimit të dhjetorit 1998, i nënshkruar nga Jakup Krasniqi,
13 në B46 dhe që është gjetur në banesën e tij, është një
14 shembull tjetër ku udhëzon komandantët e zonës që të
15 urdhërojnë policinë ushtarake:

16 "...të arrestojnë ata shtetas që i tregojnë besnikëri
17 okupatorit që mbajnë uniformat e policisë serbe, sepse kështu
18 kanë kryer akte tradhtie ndaj shqiptarëve. E njëjta gjë do të
19 bëhet në të ardhmen për çdo qytetar që është i implikuar me
20 çdo forcë policie që nuk është pjesë e UÇK-së përpara se të
21 vendosi statusi politik i Kosovës".

22 Ata që kanë kryer krime ishin të gjithë në linjat e
23 raportimit, i raportonin në mënyrë të drejtpërdrejtë Shtabit
24 të Përgjithshëm pjesë e të cilës ishin të akuzuarit.

25 Dijenja e të akuzuarëve sa u takon ndalimeve të

1 paligjshme të UÇK-së për periudhat e paraqitura në aktakuzë do
2 të vërtetohen dhe nga provat ku tregohet komunikimi i tyre me
3 personat që janë mbajtur në mënyrë të paligjshme në Likoc,
4 Qirez, Shalë dhe Drenoc.

5 Në fillim të 1999, u bënë emërime, emërimet e larta
6 mbetën në provincën e Shtabit të Përgjithshëm. Në programin e
7 takimit të Shtabit të Përgjithshëm që është gjetur në banesën
8 e Rexhep Selimit, që shohim në diapozitivin B47, Jakup
9 Krasniqi diskuton emërimet dhe ngritjet në detyrë dhe thotë
10 "se asgjë nuk duhet nënshkruar pa miratimin e Shtabit të
11 Përgjithshëm".

12 Mund të shihni organizimin e emërimeve nga ana e Shtabit
13 të Përgjithshëm të UÇK-së që nga pranvera e 1998 që është
14 formalizuar pastaj me një këshillë personeli. Autoriteti i
15 këtij organi mund të shihet konkretisht në një raport të 20
16 janarit 1999 në një takim me komandantët e zonave të UÇK-së që
17 është marrë nga banesa e Krasniqit dhe është në diapozitivin
18 B48. Është nënshkruar nga Bislime Zyrapit dhe konfirmon
19 praktikën e mëhershme duke thënë se siç parashikon
20 rregullorja, komandanti i njësisë vartëse propozon ngritjen në
21 detyrë apo pushimin e komandantit të zonës, komandanti i zonës
22 e përcjellë propozimin me shkrim te Shtabi i Përgjithshëm i
23 UÇK-së. Këshilli i personelit e shqyrton dhe i paraqet më pas
24 propozimin komandantëve të Shtabit të Përgjithshëm.

25 Përbërja e këtij këshilli të personelit, në fakt, gjendet

1 në procesverbalet e takimeve që janë gjetur dhe që kanë qenë
2 në zotërim të Rexhep Selimit dhe mund t'i shohim në slide B49.
3 Mund ta shihni që në këtë grup përmenden të katër të
4 akuzuarit, pra, në krye ishte Krasniqi dhe zëvendëskryetari
5 ishte Thaçi.

6 Prova të mëtejshme lidhur me këtë diskutim të 20 janarit
7 në 1999, mund t'i shohim në këtë ftesë me detyrim që kishte
8 dërguar Jakup Krasniqi për një takim me të gjithë komandantët
9 e zonës dhe kjo është në diapozitivin B50 dhe këtu në
10 diapozitivin B51, në një dokument të nënshkruar formalisht po
11 në të njëjtën datë dhe këtu shohim nënshkrimet e të shtatë
12 komandantëve të zonave. Të dy këto materialet e fundit që
13 përmenda u gjendën në banesën e Krasniqit. Dhe provat do të
14 tregojmë më tej se komandantët e zonës udhëtonin për të takuar
15 me Shtabin e Përgjithshëm në mënyrë të përsëritur drejt fundit
16 të 1998 e në vijim.

17 Tani unë kam edhe diçka më shumë. Nuk e di nëse mund të
18 ndalojmë. Apo mund të vazhdoj për pesë minuta apo sugjeroni që
19 të bëjmë pushimin.

20 Një shembull tjetër i ushtrimit të autoritetit nga ana e
21 Shtabit të Përgjithshëm mund të shihet në ngjarjet e 8 janarit
22 1999, ku UÇK-ja kapi tetë trupa -- të burgosura në zonën e
23 Shalës. UÇK-ja kërkoi ndihmë nga OSBE-ja për të negociuar
24 lirimin e tyre. Kjo histori është një ilustrim i gjallë i
25 qasjes së Shtabit të Përgjithshëm dhe autoritetit që kishte

1 mbi komandantët e zonave. Siç shpjegon Jakup Krasniqi në një
2 dorëshkrim të pabotuar që u gjet në banesën e tij:

3 "Ne nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, drejt këtij
4 problemi si dhe ndaj çdo problemi tjetër që ishte me rëndësi
5 kombëtare për Kosovën, kishim një qasje të përgjegjshme dhe të
6 angazhuar. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së informohej në
7 hollësi edhe lidhur me këtë diskutim si dhe lidhur me çdo
8 diskutim tjetër".

9 Dëshmitarët ndërkombëtarë do të shpjegojnë se Krasniqi
10 ishte pika e kontaktit për këto negociata për këta ushtarët
11 edhe ishte gjithmonë -- Armatës Jugosllave - më falni - dhe
12 ishte gjatë gjithë kohës në telefon. Hashim Thaçi po ashtu
13 ishte përfshirë dhe, një dëshmitar tjetër ndërkombëtar do të
14 thotë që në një moment të diskutimeve i dha telefonin që të
15 fliste me Thaçin që ishte nga ana tjetër.

16 Krasniqi shpjegon më tej në diapozitivin B53 se:

17 "Kemi diskutuar me Shtabin e Përgjithshëm për këtë
18 çështje. Nuk kishte mendime të kundërta dhe ndamë një mendim
19 unanimit."

20 Mund ta shihni dhe në diapozitivin B54, që është këtu, në
21 janar, një fotografi e janarit 1999, ku është Krasniqi dhe
22 Sokol Bashota gjatë negociatave me OSBE-në.

23 Në diapozitivin B55, shohim që, në fakt, zona e Shalës i
24 liroi ushtarët që kishin kapur në 13 janar 1999 dhe shtypi i
25 Kosovës raportoi atë ditë se lirimi u bazua mbi urdhrin

1 ekzekutiv të Shtabit të Përgjithshëm.

2 Në fillim të shkurtit 1999, u organizua një konferencë
3 paqe ndërkombëtare në Rambuje të Francës. Hashim Thaçi, Kadri
4 Veseli, Jakup Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të
5 Përgjithshëm morën pjesë në këto bisedime. Forcat e IRJ-së, në
6 fakt, nisën një seri sulmesh të mëtejshme në fund të shkurtit
7 dhe fillim të marsit 1999 dhe bisedimet për paqen dështuan në
8 mes të marsit të atij viti.

9 Më 24 mars 1999, NATO-ja hyri në konfliktin e armatosur
10 kundër Serbisë. Forcat e UÇK-së vijuan të luftonin tek sa
11 NATO-ja bombardonte pozicionet e Serbisë, më gjegjësisht
12 përmes Operacionit Shigjeta në pranverën e 1999 dhe krijuan
13 një korridor për furnizimin e armëve nga Shqipëria në zemër të
14 Kosovës.

15 Teksa shpaloseshin këto ngjarje, këto zhvillime, Shtabi i
16 Përgjithshëm i UÇK-së krijoi një qeveri provizore të Kosovës.
17 Strukturat e kësaj qeverie u bënë me dije formalisht në një
18 komunikatë që lëshoi vetë Hashim Thaçi dhe mund ta diskutojmë
19 organigramën apo strukturën pas pushimit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë një
21 pushim. Ju lutem kthehemi në orën 11.30.

22 Seanca mbyllet këtu.

23 --- Pauza fillon në orën 10.59

24 --- Seanca rifillon në orën 11.31

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju

1 lutem.

2 Z. Halling ende fjala për ju.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

4 Siç e diskutuam, pak para se ta merrnim pushimin, Shtabi
5 i Përgjithshëm i UÇK-së krijoi një qeveri të përkohshme të
6 Kosovës që u zyrtarizua në një komunikatë të lëshuar nga z.
7 Hashim Thaçi dhe mund të shihni në këtë komunikatë të
8 vizualizuar pra, këtu, në diapozitivin B56. Struktura e kësaj
9 qeverie përmend rolet, përmban rolet që në fakt të akuzuarit i
10 luanin ndërkohë. Hashim Thaçi u emërua Kryeministri i kësaj
11 Qeverie, Kadri Veseli Shefi i Shërbimit Informativ të Kosovës,
12 SHIK ndryshe. Rexhep Selimi Ministri i Rendit Publik, çka dhe
13 i dha autoritetin operativ ndaj policisë së UÇK-së. Jakup
14 Krasniqi u bë Zëdhënësi i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

15 Qasja e Shtabit të Përgjithshëm sa i takon vendimmarrjes,
16 ruhet në të njëjtën kohë përgjatë këtyre zhvillimeve. Në një
17 intervistë të 4 marsit 1999 ku diskutohet krijimi i qeverisë
18 së përkohshme, mund ta shohim këtu, në diapozitivin B57, Jakup
19 Krasniqi e bën të qartë se:

20 "Asnjë zëvendësim individual i askujt nuk mund të
21 zëvendësojë punën kolektive të Shtabit të Përgjithshëm apo
22 Drejtorinë Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së".

23 Në fillim të periudhës të vitit 1999, policia ushtarake
24 vijoi të punonte me shërbimin informativ për të arrestuar dhe
25 burgosur, apo për të ndaluar, armiqtë e perceptuar të UÇK-së.

1 Formimi i kësaj qeverie nuk ndryshoi në mënyrë të njemendtë
2 llojet e funksioneve që në fakt i luanin operativët e
3 zbulimit. Do të shihni se si SHIK-u e vazhdoi punën
4 antikoracioniste që kishte nisur më herët, edhe do të
5 dëgjoni dëshmitarë që ose kanë punuar për SHIK-un ose që janë
6 mbajtur të ndaluar apo janë marrë në pyetje nga ata që punonin
7 për SHIK-un.

8 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së vijoi të informohej mbi
9 operacionet apo mbi veprimtaritë e zbulimit. Këtu, në
10 diapozitivin B58, është një shënim me shkrim dore që është
11 gjetur në banesën e Rexhep Selimit. Shënimet që i kishte në
12 zotërim Selimi janë të datës 1 mars 1999 dhe përshkruajnë
13 aktivitetet apo veprimtaritë në zonën operative të Dukagjinit.
14 Mund të shihni se thuhet:

15 "Zbulimi dhe kundërzbulimi po funksionojnë në nivele të
16 kënaqshme."

17 Në qershor 1999, marrëveshja e demilitarizimit u
18 nënshkrua mes NATO-s dhe autoriteteve të RJ-së dhe serbe. Kjo
19 marrëveshje parashikonte armëpushim të menjëhershëm dhe
20 tërheqje të plotë të forcave të RJ-së nga Kosova brenda 20
21 qershorit 1999. NATO-ja ndaloi fushatën e bombardimeve më 10
22 qershor dhe po në të njëjtën ditë Këshilli i Sigurisë së OKB-
23 së miratoi Rezolutën 1244. Rezoluta kërkonte armëpushim dhe
24 vendosi dislokimin e forcave ndërkombëtare në Kosovë. Këtu
25 përfshihej si një operacion paqeruajtës nga NATO për forcën e

1 Kosovës, e njohur ndryshe si KFOR-i, dhe një organ të
2 administratës civile ndërkombëtare që njihet ndryshe si
3 Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, apo
4 UNMIK-u.

5 Do të dëgjoni se si edhe KFOR-i, UNMIK-u bashkë, hetuan
6 krimet e UÇK-së dhe shkeljen e marrëveshjes së demilitarizimit
7 në momentin që ata mbërritën në Kosovë.

8 UÇK-ja ose kjo qeveri, e ruajtën komandën mbi zonat
9 operative gjatë kësaj periudhe. Në fakt, edhe kur forcat serbe
10 u tërhoqën dhe u dislokuan forcat ndërkombëtare, UÇK-ja dhe
11 qeveria përfituan nga ky vakumi i kompetencave edhe morën në
12 kontroll administratën civile në gjithë vendin.

13 UÇK-ja - kjo qeveri ishin të detyruara nga marrëveshja
14 për demilitarizimin të mos përfshihen në aktivitete policore
15 në Kosovë, sepse kjo do të ishte përgjegjësia e forcave
16 ndërkombëtare që do të mbërrinin në mes të vitit 1999.

17 Sidoqoftë, ju do të dëgjoni prova se si Rexhep Selimi lëshoi
18 autorizime të paligjshme për veprimtari policore dhe këto do
19 t'i dëgjoni edhe nga dëshmitarë ndërkombëtarë që u përpoqën të
20 merrnin masa për t'i ndaluar këto.

21 Përfaqësuesit e UÇK-së dhe të qeverisë së përkohshme
22 takoheshin me ndërkombëtarët për të planifikuar angazhimet që
23 do të kishin me komunitetin ndërkombëtar. Ne do të tregojmë
24 prova nga dëshmitarë të shumtë ndërkombëtarë që janë takuar me
25 Hashim Thaçin, si përfaqësuesi i UÇK-së edhe të Qeverisë së

1 Përkohshme gjatë këtyre diskutimeve.

2 Në përputhje me marrëveshjen për demilitarizimin, UÇK-ja
3 duhet të çarmatosej brenda 20 shtatorit 1999. Dhe ky hap është
4 dhe fundi i periudhës së paraqitur në aktakuzë për këtë
5 çështje gjyqësore.

6 Të nderuar Gjykatës, përgjatë këtyre zhvillimeve dhe
7 ristrukturimeve, UÇK-ja ishte një ushtri e organizuar përgjatë
8 gjithë periudhës së paraqitur në aktakuzë. Ishin ushtri ditën
9 dhe ushtri natën. Ky organ i qendëruar i kësaj ushtrie ishte
10 në duart e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, një grup i
11 përzgjedhur ku përfshiheshin të katër të akuzuarit.

12 Të akuzuarit nuk janë në gjyq sot për shkak të
13 organizimit dhe strukturave që unë përshkrova. Por, janë në
14 gjyq për shkak të mënyrës se si ushtruan autoritetin e tyre
15 dhe shfrytëzuan strukturat për të realizuar qëllimet e veta.
16 Qoftë ushtrimi i autoritetit si anëtar i Shtabit të
17 Përgjithshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në terren, në fillim
18 të periudhës së aktakuzës, apo përmes komandantëve të niveleve
19 më të ulëta, që pritej që të zbatonin politikat teksa vijonte
20 lufta, secili nga të katër të akuzuarit, e thënë thjesht, mund
21 të zbatonte vullnetin e vet. Pra mund të zbatonin vullnetin e
22 tyre.

23 Pra, cili ishte vullneti i tyre? Dhe kjo është një temë
24 që kolegët e mi do ta shtjellojnë më tej, dhe do të flasin për
25 qëllimin e përbashkët kriminal, pjesë e të cilit ishin të

1 katër të akuzuarit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
3 z. Halling.

4 Z. Ferdinandusse keni fjalën.

5 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
6 Gjykatës.

7 Sapo dëgjuat se si katër të akuzuarit e kësaj çështjeje e
8 ushtruan pushtetin e tyre gjatë periudhës së aktakuzës me anë
9 të roleve të tyre në Shtabin e Përgjithshëm dhe në qeverinë e
10 përkohshëm të Kosovës.

11 Në këtë pjesë të deklaratës hyrëse, do të përshkruajmë se
12 si të akuzuarit e zbatuan qëllimin kriminal të përbashkët të
13 shënjestrimit - me frikësim, ndalim dhe dhunë - të personave
14 të konsideruar si kundërshtarë. Këtë pjesë do ta paraqesim unë
15 dhe z. Tieger, dhe në këtë pjesë të parë që do ta prezantoj
16 unë të gjithë diapozitivat mund të transmetohen publikisht.

17 Ndër kundërshtarët përfshiheshin ata persona të cilët
18 mendohej se bashkëpunoni ose ishin të lidhur me institucionet
19 serbe ose ata persona që thjesht nuk mbështetnin qëllimin dhe
20 metodat e UÇK-së përfshirë personat e lidhur me Lidhjen
21 Demokratike të Kosovës, LDK-në pra, si edhe persona të
22 kombësisë serbe, rome apo përkatësi etnike të tjera.
23 Ndonjëherë këta quheshin tradhtarë, bashkëpunëtorë, ose
24 kolaboracionistë.

25 Provat do të tregojnë se këta terma vazhdimisht

1 keqpërdoreshin ose ngatërroreshin. Provat do të tregojnë se
2 personat e etiketuar kështu ndaloheshin në mënyrë arbitrare
3 dhe pa proces të rregullt ligjor dhe në shumë raste
4 keqtrajtoheshin në mënyrë të tmerrshme, siç do ta dëgjoni më
5 pas gjatë kësaj deklaratë hyrëse.

6 Qëllimi kriminal i përbashkët vuri në shënjestër këdo që
7 mendohej se pengonte objektivat dhe taktikat e të akuzuarve.
8 Katër të akuzuarit e shpërdoruan postin në Shtabin e
9 Përgjithshëm për të menduar, mbikëqyrur, urdhëruar,
10 inkurajuar, nxitur dhe ndihmuar zbatimin e këtij plani gjatë
11 gjithë periudhës së aktakuzës.

12 Cilat janë provat për këtë qëllim kriminal të përbashkët?
13 Ato i gjeje të qarta dhe të shprehura në mënyrë të përsëritur
14 në komunikatat zyrtare të Shtabit të Përgjithshëm të bëra me
15 dijeninë dhe miratimin e të akuzuarve, dhe i gjen të
16 përsëritura nëpër fjalime dhe intervista, norma dhe
17 rregullore, urdhra, mbledhje dhe raporte. Kjo politikë u
18 zbatua edhe nëpërmjet incidenteve me pjesëmarrjen e
19 drejtpërdrejtë të të akuzuarve, për të cilat do të japim disa
20 shembuj në këtë deklaratë hyrëse.

21 Në fund, provat do të vërtetojnë përtej çdo dyshimi se
22 gjatë gjithë periudhës së aktakuzës të akuzuarit ishin dakord
23 për qëllimin kriminal të përbashkët dhe se nxitën zbatimin e
24 tij.

25 Të fillojmë me komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm. Siç

1 dëgjuat nga z. Whiting, ajo që të bën përshtypje në këtë
2 çështje gjyqësore, është se qëllimi kriminal i përbashkët nuk
3 mbahej i fshehtë. Në Kosovë, dihej gjerësisht dhe mbrohej
4 hapur. Zbatimi i tij mbështetej pjesërisht në këtë përhapje të
5 gjerë të mesazhit, për t'i nxitur ushtarët nëpër zona të
6 vepronin kundër kundërshtarëve, dhe për të siguruar që të
7 gjithë personat që mund të bënin pjesë në kategorinë e
8 përgjithshme të kundërshtarëve, të kërcënoheshin dhe të
9 frikësoheshin.

10 Që me komunikatat më të hershme, duke vazhduar edhe në
11 periudhën e aktakuzës, ku katër të akuzuarit kishin role kyçe
12 në çdo kohë përkatëse, Shtabi i Përgjithshëm ndoqi një
13 politikë të shënjestrimit të pamëshirshëm të kundërshtarëve,
14 me dhunë dhe vdekje.

15 Komunikata e parë e ditur e Shtabit të Përgjithshëm doli
16 në nëntor 1994, siç do ta shihni këtu në diapozitivin C1. Siç
17 e dëgjuat nga z. Halling, Rexhep Selimi ka thënë se ai, Hashim
18 Thaçi dhe Kadri Veseli ishin asokohe anëtarë të Shtabit të
19 Përgjithshëm. Në një intervistë publike përpara aktakuzës,
20 Rexhep Selimi ka folur lirisht për përfshirjen e tij nëpër
21 sulme si edhe në diskutimet që patën si rezultat këtë
22 komunikatë.

23 Siç e shihni në ekran, komunikata njofton një sulm të
24 UÇK-së dhe deklaronte:

25 "Informojmë se dhe rastet e mëparshme të atentateve në

1 Kosovë kundër okupatorëve dhe tradhtarëve janë kryer nga
2 njësitë tona të armatosura. Poshtë okupatorët dhe tradhtarët!"

3 Kjo politikë u përsërit në mënyrë edhe më të qartë
4 vazhdimisht, nëpër komunikata, gjatë viteve 1996-1997, dhe
5 1998. Komunikatat shpallnin ekzekutimet e të ashtuquajturve
6 kolaboracionistë dhe tradhtarë, dhe se masa të -- dhe
7 informonin se masa të tilla do të vijonin.

8 Komunikata numër 29, e dalë në janar të vitit 1997, që
9 është në këtë diapozitiv C2, përbën shembull të kësaj. Në të
10 thuhej se ishin kryer atentate kundër personave të akuzuar si
11 bashkëpunëtorë dhe aty thuhej:

12 "Është hera e fundit që ua tërheqim vëmendjen të gjithë
13 bashkëpunëtorëve të pushtuesit, që të tërhiqen nga rruga e
14 tyre e turpshme, përndryshe dora hakmarrëse e popullit do të
15 godasë pamëshirshëm".

16 Pamëshirshëm. Porosia është e qartë. Personat e akuzuar
17 si kolaboracionistë do të vireshin në shënjestër dhe do të
18 goditeshin, pamëshirshëm. Kjo politikë u përsërit vazhdimisht
19 nëpër komunikata.

20 Të shohim komunikatën numër 36 të shtatorit 1997 në
21 diapozitivin C3. Këtu thuhet:

22 "Ditë më parë nga një njësi i ynë në zonën e Drenicës u
23 ekzekutuan edhe dy kolaboracionistë të pushtuesit".

24 Komunikata numër 42, e shkurtit 1998, njoftonte vrasjen e
25 disa kolaboracionistëve të pretenduar.

1 Komunikata numër 43, e marsit 1998:

2 "Vdekje armiqve dhe tradhtarëve."

3 Komunikata numër 47, e majit 1998, tani në ekran në
4 diapozitivin C4:

5 "Gjatë kësaj periudhe, u kryen aksione edhe kundër disa
6 kolaboracionistëve shqiptarë, të cilët me gjithë
7 paralajmërimet e mëparshme, nuk hoqën dorë nga rruga e tyre
8 antikombëtare".

9 Kjo politikë e shënjestrimit të atyre që pretendohet se
10 ishin kolaboracionistë, tradhtarë, kundërshtarë ishte pra
11 mjaft e pranishme në arenën publike në Kosovë.

12 Edhe vëzhguesit ndërkombëtarë të informuar e vunë re
13 këtë. Në korrik 1998, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm
14 përfshirë Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin dhe Kadri Veselin e
15 intensifikuan punën afruese me ndërkombëtarët për të marrë
16 mbështetje jetike për UÇK-në. Në një takim në korrik 1998, z.
17 Thaçi dhe z. Veseli iu thanë përballë në mënyrë të
18 drejtpërdrejtë pretendimet për ndalimet dhe kidnapimet. Do të
19 dëgjoni se z. Thaçi nuk i mohoi këto pretendime, por u
20 përgjigj me zotimin se UÇK-ja do të respektonte Konventat e
21 Gjenevës sepse, tha ai, UÇK-ja ishte ushtri e rregullt.

22 T'u kthehemi komunikatave.

23 Gjatë kësaj periudhe, vera e vitit 1998, me
24 intensifikimin e punës afruese me ndërkombëtarët, pati një
25 ndryshim të tonit të komunikatave. Këto u bënë më të

1 rezervuara, më të koduara, por porosia mbeti e pagabueshme.

2 Përpilimi i komunikatës numër 49 është me interes këtu.

3 Është diapozitivi C5. Këto janë shënimet, siç e shikoni

4 majtas, në të majtë pra, që mban titullin "Kom Nr. 49." Këto

5 janë gjetur pra në shtëpinë e të akuzuarit Jakup Krasniqi,

6 përfshin edhe këtë rresht -- këto shënime përfshijnë edhe këtë

7 rresht që është tani në ekran:

8 "U likuiduan disa kolaboracionistë."

9 Këto shënime janë gjetur në shtëpinë e Jakup Krasniqit,

10 jo vetëm pra të daktilografuara, të shtypura, por edhe me

11 shkrim dore. Diapozitivi C6. Siç e shihni, ky version me

12 shkrim dore që mban titullin "Komunikatë Nr. 49", në të

13 thuhet:

14 "U likuiduan edhe kolaboracionistët".

15 Por, kur komunikata 49 u botua në korrik të vitit 1998,

16 dhe e shihni tani në diapozitivin C7, ky rresht është

17 shndërruar në -- dhe po citoj këtu:

18 "U ndërmorën masa edhe ndaj disa kolaboracionistëve me

19 damkë, të cilët ende punonin kundër interesave kombëtare."

20 Ndërsa në komunikatat e mëparshme trumbetoheshin hapur

21 atentatet, ekzekutimet dhe sulmet, këtej e tutje fjalët "masa"

22 ose "masa ndëshkuese" do të bëheshin termi i ri i këtyre

23 veprimeve kundër kundërshtarëve.

24 Komunikata 52, e gushtit 1998, thoshte se, "masa

25 parandaluese dhe ndëshkuese" janë "marrë kundër disa",

1 "elementeve kolaboracioniste".

2 Komunikata 53, datë 18 -- nga shtatori 1998, thoshte:

3 "Masa ndëshkuese të formave të ndryshme po ndërmerren
4 edhe kundër elementeve kolaboracioniste të cilët vazhdojnë të
5 kryejnë shërbimin e pushtetit okupator."

6 Nuk ka dyshim, se me fjalën "masa", nënkuptohej vënia në
7 shënjestër, nënkuptohej ndalim, keqtrajtim i dhunshëm,
8 nënkuptohej vrasje.

9 Por çfarë kuptimi kishin termat "kolaboracionist" apo
10 "tradhtar" në këto komunikata? U referoheshin vetëm atyre që
11 përbënin rrezik për UÇK-në ngaqë i jepnin informata të dëmshme
12 ushtrisë serbe? Jo. Provat do të tregojnë se këta terma
13 përdorëshin më në përgjithësi për personat që kishin lidhje me
14 serbët, ose që kishin një mendim të ndryshëm politik, ose që
15 ishin kundër taktikave të UÇK-së. Të shohim komunikatën numër
16 21 të korrikut 1996 këtu në diapozitivin C8. Në komunikatë
17 thuhej se qendrat ndërkombëtare të vendosjes nuk po e merrnin
18 seriozisht çështjen e Kosovës, dhe shprehej shqetësimi se mund
19 të ishte arritur një ujdi që do ta kompromentonte qëllimin për
20 pavarësi të Kosovës.

21 Pastaj komunikata paralajmëronte:

22 "Ata që do të kenë guximin për të nënshkruar marrëveshje
23 të tilla do të ndëshkohen me tradhti."

24 Me fjalë të tjera, të kundërshtojë taktikat e UÇK-së do
25 të thoshte të viheshe në shënjestër për t'u vrarë.

1 Të shohim komunikatën numër 27, në diapozitivin C9. Kjo
2 ka dalë në -- është lëshuar në tetor 1996, por është botuar,
3 publikuar në nëntor të atij viti. Komunikata njoftonte për
4 ekzekutimin e dy njerëzve, me vendim të Shtabit të
5 Përgjithshëm të UÇK-së që në këtë dokument ende quhet Shtabi
6 Qendror. Komunikata u drejtonte mesazh atyre që shqiptarëve që
7 kritikonin politikisht taktikat e UÇK-së si terroriste.

8 Paralajmërimi për këta kundërshtarë politikë ishte i qartë
9 "Ju ndërpreni akuzat dhe mbështetni luftën tonë
10 përndryshe do të trokasim edhe në dyert tuaja për t'ju dhënë
11 dënimin e merituar".

12 Dënimi i merituar për mosmbështetjen e luftës. Nuk ka
13 asnjë dyshim se çfarë do të thoshte kjo.

14 Të shohim edhe komunikatën 29 të janarit 1997, që
15 paraqitet tani në diapozitivin C10. Siç e thashë më lart, në
16 të njoftoheshin disa ekzekutime. Le ta shohim më me vëmendje.

17 Sulmi i dytë i përshkruar është kundër rektorit të
18 universitetit serb në Prishtinë. Përse u vu në shënjestër ai?
19 Komunikata thotë:

20 "Pasojat e veprimeve të tij antishqiptare, e në veçanti
21 ato në fushën e arsimit, janë -- na janë të njohura të
22 gjithëve".

23 Ai nuk ishte objektiv legjitim ushtarak, ishte civil. Dhe
24 u vu në shënjestër për veprimtaritë e tij në sistemin arsimor.

25 Po kështu, në komunikatën 36, të shtatorit 1997, Shtabi i

1 Përgjithshëm, "u bënte me dije", politikanëve të Kosovës që po
2 "villnin vrer" kundër UÇK-së.

3 Në komunikatën 47, e lëshuar në maj 1998, i dënonte të
4 ashtuquajturit kolaboracionistë për "rrugën kundër interesave
5 kombëtare".

6 Komunikata 49 e lëshuar në korrik 1998, vinte në
7 shënjestër kolaboracionistët që "punojnë kundër interesave
8 kombëtare".

9 Në shtator 1998, deklarata politike numër 10, e lëshuar
10 nga Shtabi i Përgjithshëm, sugjeronte se qëndrimet e mbajtura
11 nga aktorët politikë në Kosovë përbënin tradhti. Dhe ne e dimë
12 nga komunikatat e mëparshme se çfarë do të thoshte të akuzoje
13 dikë për tradhti.

14 Duhet të jemi të qartë, termat "kolaboracionist" dhe
15 "tradhtar" në këto komunikata të Shtabit të Përgjithshëm më në
16 përgjithësi përfshinin persona të cilët mbronin metodat
17 politike që devijonin nga ato që promovoheshin nga UÇK-ja dhe
18 paralajmërimi për këta persona ishte i qartë. Ishte i qartë
19 nga gjuha e komunikatave dhe rreziku ku ndodheshin,
20 konfirmohet nga incidentet e përfshira në aktakuzë, që kishin
21 të bënin me shënjestrimin e kundërshtarëve.

22 Gjatë verës së vitit 1998, Shtabi i Përgjithshëm e
23 përfshiu më tej shënjestrimin e kundërshtarëve politikë në
24 fushatën e tij kundër asaj që e quante "luftë speciale". Termi
25 "luftë speciale", kishte të bënte me propagandën e ushtruar

1 kundër UÇK-së nga forcat serbe dhe nga të tjerë për ta minuar
2 mbështetjen e UÇK-së si brenda Kosovës ashtu dhe jashtë saj.

3 Shembuj të luftës speciale që perceptohej si e tillë
4 ishte etiketimi i UÇK-së si organizatë terroriste apo si
5 organizatë e dobët dhe e përçarë. Mirëpo, në komunikatat
6 zyrtare të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, duke filluar nga
7 vera e vitit 1998, kundërshtarët politikë futeshin në të
8 njëjtin grup me ata që bënë këtë luftë speciale, apo
9 propagandë, kundër UÇK-së. Me fjalë të tjera, kritikën kundër
10 taktikës apo qëllimeve të UÇK-së nga kundërshtarët politikë
11 dhe mbështetja që kundërshtarët politikë u jepnin zgjidhjeve
12 alternative të konfliktit, siç ishte për shembull dhënia e
13 autonomisë së Kosovës dhe jo pavarësisë, barazoheshin ose
14 thuhej se ishin në shërbim të propagandës serbe kundër UÇK-së.

15 Të shohim deklaratën politike numër 7 në diapozitivin
16 C11. Kjo është lëshuar nga Drejtoria Politike e Shtabit të
17 Përgjithshëm të UÇK-së në gusht 1998. Kjo deklaratë është e
18 rëndësishme sepse zbuloi publikisht disa prej përfaqësuesve
19 politikë të UÇK-së, përfshirë dy prej të akuzuarve - Hashim
20 Thaçin dhe Jakup Krasniqin.

21 Por shihni edhe se çfarë thotë kjo deklaratë edhe për
22 luftën speciale. Në të thuhet:

23 "Krahas goditjeve që iu dhanë pushtuesit në fushëbetejë,
24 Ushtria Çlirimtare e Kosovës përballoi me sukses forma të
25 luftës speciale që e shoqëruan ofensivën e pushtuesit".

1 Por ç'formë kishte kjo luftë speciale? Ja se ç'thuhet më
2 tej në deklaratën politike:

3 "Spekulimet lidhur me formimin e institucioneve paraqesin
4 njënjën prej formave të luftës speciale kundër interesave
5 jetike të popullit shqiptar. U bëjmë apelin e fundit bartësve
6 të këtyre spekulimeve, t'u japin fund veprimeve të tyre
7 përçarëse. Në të kundërt, goditja jonë do të jetë e
8 pamëshirshme".

9 Porosia është e qartë. Çdo pajtim politik do të vihet në
10 shënjestër pa mëshirë.

11 Të shohim komunikatën -- diapozitivin 12 ku duket
12 komunikata 51, lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm në gusht
13 1998. Komunikata raporton mbi veprimet ushtarake dhe pastaj i
14 kthehet luftës speciale. Në të thuhet:

15 "Luftimet kudo do të ishin edhe më të suksesshme edhe pse
16 kudo u tregua guximi dhe vendosmëria e nivelit të lartë
17 ushtarak dhe profesional, sikur që të mos tentohej që në
18 radhët e UÇK-së të futeshin elementet armiqësore disfatiste që
19 zhvilluan dhe po zhvillojnë një luftë të ulët speciale duke
20 përhapur disinformata dhe duke krijuar ndjenjën e panikut, jo
21 vetëm te popullata".

22 Eliminimi i luftës speciale, vijoi të ishte pjesë e
23 synimeve të Shtabit të Përgjithshëm dhe përbënte një
24 justifikim për të vënë në shënjestër, si rrezik për UÇK-në të
25 gjithë ata që guxonin të kritikonin UÇK-në apo të propozonin

1 rrugë alternative.

2 Do t'i kthehemi kësaj teme pas pak gjatë këtij
3 prezantimi.

4 Tani, që prej fundit të luftës, kur hetimet e krimeve të
5 pretenduara të krimeve të kryera gjatë luftës filluan, provat
6 do të tregojnë se disa prej të akuzuarave kanë bërë përpjekje
7 t'u largohen këtyre shprehjeve të qarta të politikës nga
8 Shtabi i Përgjithshëm, duke pretenduar se komunikatat dhe
9 deklaratat politike nuk ishin tjetër veçse propagandë apo se
10 nuk janë lëshuar fare nga Shtabi i Përgjithshëm.

11 Provat që do të paraqiten gjatë këtij gjyqi do të
12 tregojnë se këto pretendime janë thjesht të rreme. Megjithëse
13 komunikatat ndonjëherë mund t'i kenë ekzagjeruar disa prej
14 sukseseve të disa operacioneve të caktuara ushtarake, provat
15 do të tregojnë se operacionet e veçanta kundër atyre që
16 quheshin kolaboracionistë, siç njoftoheshin në komunikata, në
17 fakt kanë ndodhur. Nuk është për t'u habitur.

18 Mund ta merrni me mend vështirësinë sikur Shtabi i
19 Përgjithshëm të njoftonte ekzekutimin e një kolaboracionisti
20 apo tradhtari të pretenduar në një komunikatë, e të nesërmen
21 ky person të dilte shëndoshë e mirë në publik.

22 Pamë komunikatën 36 të shtatorit 1997, ku njoftoheshin
23 sulme të sinkronizuara kundër stacioneve të policisë në
24 Kosovë. Siç e dëgjuat sot, Rexhep Selimi e ka konfirmuar
25 publikisht se këto sulme kanë ndodhur.

1 Patë komunikatën numër 29, të janarit 1997, ku njoftohej
2 sulmi kundër rektorit të universitetit serb në Prishtinë. Do
3 të merrni prova se ky sulm i shënjestruar vërtet ka ndodhur.
4 Z. Krasniqi e ka pranuar nën betim se sulmet kundër të
5 ashtuquajturve kolaboracionistë të përshkruara në komunikata
6 të veçanta në vitet 1997 dhe 1998, kanë ndodhur vërtet.

7 Më e rëndësishme, nuk ka kuptim të përshkruhet politika e
8 shënjestrimit të kolaboracionistëve apo tradhtarëve të
9 pretenduar e shprehur nëpër komunikatë, si propagandë.

10 Komunikatat kërkonin dhe lejonin nga aktorët e tjerë të
11 lartë të UÇK-së, komandantë zone dhe njësi të zbulimit,
12 policia ushtarake -- të vinin në shënjestër kundërshtarët, për
13 t'i ndaluar dhe keqtrajtuar. Nëse kjo politikë kërkonte të
14 ishte propagandë e rreme, kjo do t'i befasonte të gjithë ata
15 që e zbatuan gjatë luftës.

16 A janë lëshuar komunikatat nga Shtabi i Përgjithshëm ku
17 të akuzuarit ishin anëtarë kryesorë? Sigurisht që janë lëshuar
18 prej tij, sigurisht. Provat në gjyq do të tregojnë se detyra e
19 nxjerrjes së komunikatave ishte rregulluar brenda Shtabit të
20 Përgjithshëm apo Shtabit Qendror siç u quajt në publik për një
21 farë kohe, që prej fillimit.

22 Z. Krasniqi ka deklaruar se UÇK-ja filloi lëshimin e
23 komunikatave në vitin 1994 për të informuar publikun, dhe ai
24 ka identifikuar konkretisht disa komunikata që në vitin 1997,
25 që -- kanë dalë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, përfshirë

1 komunikatën 35 të gushtit 1997, komunikatën 42 të shkurtit
2 1998, ku, siç u tha, njoftoheshin atentatet kundër disa
3 kolaboracionistëve të pretenduar; komunikatën 47 të majit
4 1998, ku gjithashtu njoftohesh se ishin vënë në shënjestër disa
5 kolaboracionistë; dhe komunikatën 53 të 18 shtatorit 1998 ku
6 njoftohesh se, "masa ndëshkuese të formave të ndryshme po
7 ndërmerren edhe kundër elementeve kolaboracionistë të cilët
8 vazhdojnë të kryejnë shërbimin e pushtetit okupator". Dhe kjo
9 komunikatë u lëshua vetëm pak ditë përpara se të ndaloheshin
10 disa prej viktimave.

11 Shënimet hartuese. Projekte të plota dhe versionet e
12 publikuara të shumë komunikatave janë gjetur gjatë bastisjes
13 së shtëpisë së Jakup Krasniqi në forma origjinale të shtypura,
14 të fotokopjuara, të shkruara me dorë, të daktilografuara si
15 dhe format digjital. Në fakt, Z. Krasniqi zotëronte 42
16 komunikime të ndryshme publike të Shtabit të Përgjithshëm nga
17 periudha e aktakuzës, përfshirë edhe komunikata, gjithsej 84
18 [sipas përkthimit] versione ose kopje.

19 Nëse ju kujtohet kjo përfshinte edhe komunikatën numër 49
20 të korrikut 1998, ku njoftoheshin masa kundër
21 kolaboracionistëve të dyshuar, që e dimë nga shënimet
22 përpiluese të gjetura në shtëpinë e Z. Krasniqi se kjo do të
23 thoshte se këta persona ishin likuiduar.

24 Në një intervistë me TPNJ-në në 2004, Hashim Thaçi pranoi
25 se Shtabi i Përgjithshëm komunikonte publikisht me anë të

1 komunikatave, dhe konkretisht tha se komunikata numër 47 e
2 majit 1998 ishte e Shtabit të Përgjithshëm siç ishte edhe
3 komunikata numër 49 e korrikut 1998, të cilat i përmenda të
4 dyja pak përpara.

5 Në këtë gjyq, do të dëgjoni dëshmi edhe nga dëshmitarë të
6 brendshëm që ishin marrësit e porosisë së këtyre komunikatave,
7 që konfirmojnë çfarë mund të shihet në vetë komunikatat, dhe
8 çfarë është pranuar nga shumica e të akuzuarve përpara se --
9 kundër tyre të ngrihej aktakuza. Shtabi i Përgjithshëm i
10 përdorte komunikata për të përhapur porosi në një auditor të
11 gjerë.

12 Kur një komunikatë ishte e rreme dhe dilte gjoja në emër
13 të Shtabit të Përgjithshëm, ky i fundit dinte si ta
14 përgënjeshtronte. Komunikata 42 e marsit 1998 është shembull i
15 kësaj. Në të thuhet:

16 "Komunikata e fabrikuar nga qarqe të caktuara
17 antishqiptare dhe e lëshuar në emër të UÇK-së, në të cilën
18 kërcënohej Kryeministri i Shqipërisë, nuk është e jona, dhe si
19 e tillë është e pavlefshme".

20 Historia e autorësisë dhe autenticitetit të komunikatës
21 numër 59 që u publikua në tetor 1998 dhe që do të jetë objekt
22 debatesh të konsiderueshme gjatë këtij gjyqi, është me
23 rëndësi. Komunikata 59 akuzoi në mënyrë të rrejshme një
24 individ të caktuar se ishte kolaboracionist ngaqë, siç do ta
25 tregojnë provat, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë

1 Hashim Thaçin, donin që ky person të bëhej objekt keqtrajtimi,
2 në mos vdekjeje.

3 Në një intervistë televizive të shkurtit 2019, Hashim
4 Thaçi pretendoi se kjo komunikatë nuk ishte lëshuar nga Shtabi
5 i Përgjithshëm i UÇK-së, se ishte lëshuar nga individë
6 keqdashës pa dijeninë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe
7 se në përgjithësi, disa prej komunikatave dhe deklaratave të
8 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nuk ishin lëshuar nga Shtabi
9 i Përgjithshëm por, "nga Bahnhofa", që do të thotë stacione
10 treni, persona të panjohur jashtë shtetit, për të përçarë UÇK-
11 në dhe për të mbjellë konfuzion.

12 Gjatë intervistës së tij më vonë me ZPS-në, Hashim Thaçi,
13 që e shihni edhe në diapozitivin C13, në këtë intervistë, e
14 përsëriti këtë pretendim, duke deklaruar se nuk e dinte se
15 kush e shkroi komunikatën 59, por se nuk ishte komunikatë e
16 UÇK-së. Dy prej të akuzuarve të tjerë, reagues shumë
17 publikisht ndaj intervistës televizive të Hashim Thaçit të
18 vitit 2019. Jakup Krasniqi u shpreh se:

19 "Hashim Thaçi, si udhëheqës politik i UÇK-së e di shumë
20 mirë se asnjë komunikatë e UÇK-së nuk është lëshuar nga
21 Bahnhofat, me qëllim që të përçajë UÇK-në".

22 Z. Krasniqi më tej tha:

23 "Hashim Thaçi e di se që nga viti 1998, të gjitha
24 komunikatat janë shkruar në Kosovë".

25 Rexhep Selimi doli në televizor, në nëntor 2019, dhe e

1 konfrontoi atë që kishte thënë z. Thaçi se Shtabi i
2 Përgjithshëm s'kishte të bënte fare me komunikatën 59.

3 Z. Selimi që e kemi këtu në diapozitivin C14, i vuri
4 gjërat në vend dhe tha se në fakt ishte Hashim Thaçi vetë ai
5 që e kishte shkruar komunikatën 59. Le ta shohim.

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Këtë deklaratë, e ka shkruar një individ dashakeqës,
8 pajtohem plotësisht. Por ai është Hashim Thaçi.

9 Hashim Thaçi e ka shkruar komunikatën 59.

10 Komunikatën 59 është hartues dhe lëshues është Hashim
11 Thaçi."

12 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Në intervistën e tij më vonë
13 me ZPS-në Z. Selimi u qëndroi fjalëve që kishte thënë në këtë
14 intervistë televizive duke konfirmuar se ishte Hashim Thaçi ai
15 që e kishte shkruar komunikatën 59, dhe përshkroi se në vitin
16 1998 Hashim Thaçi ia kishte lexuar tekstin e komunikatës 59 me
17 telefon satelitor duke shtuar se synimi ishte të shkatërrohej
18 plotësisht personi që cekej me emër në atë komunikatë.

19 Çfarë përfshin pra, apo përmbledh kjo histori e
20 komunikatës numër 59? Gjatë luftës Hashim Thaçi përdori
21 etiketimin kolaboracionist në këtë komunikatë për të njollosur
22 dhe për të shkatërruar dikë. Pas lufte, kur erdhi koha për të
23 marrë përsipër përgjegjësinë, për t'i dalë zot kësaj, çfarë
24 bëu z. Thaçi? Ai i largohet përgjegjësisë dhe në mënyrë të
25 rreme mohon se nuk ka të bëjë fare me komunikatën, por ja që e

1 nxjerrin zbuluar dy prej të akuzuarve të tjerë.

2 U lutemi, të nderuar Gjykatës, ta mbajmë parasysh këtë
3 histori, kur të dëgjojnë dëshmitë e tjera të kësaj çështjeje
4 gjyqësore.

5 Unë këtu e mbyll pjesën time, z. Tieger do të vijojë prej
6 këtej.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Tieger e keni ju fjalën.

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sapo dëgjuat
10 se politika e shënjestrimit të kolaboracionistëve dhe
11 kundërshtarëve theksoi në mënyrë të vazhdueshme në komunikatat
12 e nxjerra nga Shtabi i Përgjithshëm në vitet përpara dhe gjatë
13 aktakuzës.

14 Provat do të tregojnë më tej se politikat e shprehura në
15 këto komunikata reflektoheshin në deklarata, intervista,
16 urdhra, raporte, rregullore, si edhe në veprimet e të
17 akuzuarve për të çuar më përpara dhe për të realizuar
18 objektivin e përgjithshëm, qëllimin e përgjithshëm. Unë do t'i
19 kaloj disa prej tyre kronologjikisht, dhe edhe pse do të
20 përzgjedh vetëm shembuj, për qëllime të këtij prezantimi,
21 konsistenca dhe vijimësia e përpjekjeve të të akuzuarve të
22 bien në sy dhe janë të dukshme gjatë gjithë kohës.

23 Herën e parë fare kur UÇK-ja doli publikisht ishte në një
24 ceremoni mortore pas një luftimi ndërmjet UÇK-së dhe forcave
25 serbe në nëntor 1997. Atje, Rexhep Selimi theksoi se gjatë

1 katër viteve të fundit UÇK-ja kishte kryer operacione kundër,
2 "okupuesve në vende delikate si dhe kundër kolaboracionistëve
3 shqipfolës". Ai gjithashtu denoncoi figura politike të cilët,
4 "Përpiqen që të denigrojnë luftën tonë me pozicionet e tyre
5 pacifiste".

6 Kalojmë në mars 1998, ndërkohë që të akuzuarit koordinuan
7 kyçjen e vullnetarëve në UÇK pas ngjarjeve në Prekaz, ata
8 caktuan persona që ishin në një linjë me ta për të zbatuar
9 politikat e tyre. E mbani mend referencën e z. Halling dhe
10 përmendjen tij të Xhemë Gashit dhe Mahir Hasanit në Drenoc ku
11 ata kishin pozicionet komandant batalioni dhe
12 zëvendëskomandant batalioni dhe sikurse u përmend në një
13 raport që e përmendi gjithashtu z. Halling që ata ishin të
14 pranishëm në Drenoc me urdhër dhe me leje të Shtabit të
15 Përgjithshëm. Në fakt ata kishin qenë pjesë të grupeve të
16 drejtuara në Kosovë nga Shqipëria nga z. Thaçi dhe z. Selimi
17 nga Shqipëria dhe ishin instaluar në vende si Drenoci për të
18 organizuar dhe zhvilluar njësitet lokale në emër të Shtabit të
19 Përgjithshëm.

20 Provat do të tregojnë më tej se z. Selimi gjithashtu
21 ishte shpesh i pranishëm në Drenoc gjatë kësaj periudhe. Po
22 ashtu provat do të tregojnë që qëllimi i përbashkët u zbatua
23 atje.

24 Do të shikoni për shembull një bllok shënimesh me shënime
25 nga qershori deri në gusht 1998, që përmban informacion rreth

1 personave të dyshuar dhe të ndaluar në Drenoc, përfshirë këtu
2 edhe personat e arrestuar që ishin dërguar në Shtabin e
3 Përgjithshëm. Aktakuza pretendon se të paktën 38 persona janë
4 ndaluar në Drenoc në këtë periudhë.

5 Likoci ishte një vend ku fillimisht ishte vendosur Shtabi
6 i Përgjithshëm dhe më pas u bë selia e zonës së Drenicës që
7 ishte në komandën e Sylejman Selimit, Sami Lushtaku u bë
8 zëvendëskomandanti i Selimit dhe Sahit Jashari, të cilin e
9 kemi parë në video që shpalli gatishmërinë e vet për të
10 respektuar urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm, ishte komandanti
11 i policisë. Të dy këta njerëz kishin ardhur në Kosovë në
12 pranverën e 1998 në grupe të drejtuara nga i akuzuari Hashim
13 Thaçi, dhe të tjerë. Dhe këtu sërish qëllimi i përbashkët
14 ishte përdorur.

15 Më 18 maj 1999 [sipas përkthimit] në një dokument të
16 kësaj date përmbahen emrat e disa prej personave të cilët
17 ishin ndaluar, marrë në pyetje në Likoc e në disa raste edhe
18 janë zhdukur. Të paktën janë 25 persona që janë ndaluar dhe
19 keqtrajtuar në Likoc duke filluar që në prill të 1998.

20 Ka prova të tjera që në pranverë të 1998 politika e
21 shënjestrimit të kundërshtarëve po zbatohet në terren nën
22 drejtimin e të akuzuarve. Kjo reflektohet në diapozitivin D1.

23 Dua të them që të gjithë diapozitivat duhet që të jepen
24 për publikun me përjashtim të dy diapozitivave të fundit.

25 Në ekran mund të shikoni faqen e parë të një blloku

1 shënimesh që është gjetur në kërkimin e -- në kontrollin e
2 kryer në shtëpinë e z. Selimi në kohën kur ai u arrestua. Në
3 bllokun e shënimit përmbahen disa shënime nga maji 1998. Disa
4 prej këtyre shënimeve i referohen takimeve dhe konsultimeve me
5 Rexhep Selimin, ku ka qenë i pranishëm Rexhep Selimi, i cili
6 identifikohet ose si numri Dhjetë ose me nofkën Rexhë. Në
7 bllokun e shënimeve ka informacion rreth çështjeve logjistike
8 dhe operacionale si dhe informacion rreth angazhimeve
9 ushtarake. Brenda të njëjtit blloku shënimesh referencë pas
10 reference përmenden kolaboracionistët, të cilët zakonisht
11 identifikohen me emër. Disa prej tyre konsiderohen si të
12 dyshimtë sepse, citoj, ata konsiderohen se janë "pranë"
13 personave të tjerë që janë të dyshimtë. Një grua, për
14 shembull, konsiderohet si e dyshuar sepse kishte një fëmijë me
15 një oficer policie rrugore serb.

16 Të akuzuarit promovuan dhe pranuan politikën në fjalimet
17 dhe intervistat e tyre. Pothuajse menjëherë pasi Jakup
18 Krasniqi është caktuar zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të
19 UÇK-së dhe siç e thotë dhe ai vetë me fjalët e veta për të
20 përfaqësuar dhe për të bërë publike politikat e Shtabit të
21 Përgjithshëm, ai dha një intervistë për Der Spiegel-in, që
22 mund ta shikoni këtu në diapozitivin D2, ku pranon haptazi
23 politikën e shënjestrimit të kolaboracionistëve. Pyetja që iu
24 bë atij ishte kjo:

25 "Në Perëndim UÇK-ja shpesh cilësohet si lëvizje

1 terroriste. Pse vret ajo shqiptarë paqësorë?"

2 Dhe z. Krasniqi përgjigjet:

3 "Kolaboracionistët i kemi paralajmëruar që do të vriten
4 në qoftë se do të vazhdojnë në rrugën e gabuar".

5 Z. Krasniqi më vonë konfirmon saktësinë e këtij
6 artikulli.

7 Muajin pasues, z. Krasniqi dha një intervistë për Kohën
8 Ditore dhe iu bë pyetje lidhur me dënimin ndërkombëtar të
9 veprimeve të UÇK-së që shënjestronin civilë. Duke u përpjekur,
10 duke qenë në pozitë jokomode, për të shpjeguar dhe madje dhe
11 për të justifikuar praktikën që kishte shkaktuar dënimin, ai
12 bëri disa pranime:

13 "Ka pasur raste ku ka pasur kidnapime, por në këtë rast
14 ato janë dorëzuar në organizatat ndërkombëtare, sigurisht kur
15 ato kanë qenë të pafajshëm".

16 Ai vijon më tej:

17 "Ne nuk preferojmë kidnapimin. Edhe në qoftë se dikush ka
18 vuajtur, ato kanë qenë kryesisht kolaboracionistë shqiptarë
19 sesa civilë serbë. Ne nuk merremi me civilë, dhe ne i kthejmë
20 ata të cilët janë marrë si të burgosur lufte."

21 Dhe citon më tej:

22 "Ata që janë kidnapuar ose janë njoftuar në një listë ose
23 raportohen për t'u ekzekutuar, megjithatë neve nuk sillemi
24 sipas mënyrës së Serbisë".

25 Shqetësimet ndërkombëtare sa i takon sjelljes së UÇK-së

1 dolën sërish në pah në korrik 1998, kur diplomati austriak Jan
2 Kickert u takuan me z. Thaçi dhe z. Veseli. Siç u tha dhe më
3 parë z. Kickert ngriti çështjen e pretendimeve të ndalimeve
4 dhe rrëmbimeve në kontekstin e mundshëm të KNPK-së. Z. Thaçi
5 dhe z. Veseli nuk i mohuan pretendimet, por z. Thaçi sikur e
6 dëgjuam dhe më përpara, tha që, UÇK-ja do të respektonte
7 Konventat e Gjenevës.

8 Në mënyrë të ngjashme, Rexhep Selimi ka pranuar gjatë
9 intervistës së vet me ZPS-në, se edhe ai ishte në dijeni që
10 bëheshin ndalime. Megjithëse ai pretendon që nuk e dinte
11 ekzaktësisht se ku ishin qendrat e tilla.

12 Z. Halling foli për zbatimin e rregulloreve dhe
13 dokumenteve juridikë normativë si pjesë dhe të zhvillimit
14 organizativ të UÇK-së. Shtabi i Përgjithshëm sigurohej që
15 shënjestrimi i kundërshtarëve reflektohej në funksionet e
16 shërbimeve të inteligjencës dhe të policisë ushtarake të UÇK-
17 së të cilat të dyja u krijuan në verën dhe pranverën e 1998
18 dhe që punuan me njëra-tjetrën për të identifikuar dhe për të
19 ndaluar kolaboracionistët e pretenduar.

20 Më përpara dëgjuam përmendjen e rregulloreve të
21 përkohshme për organizimin e brendshëm të ushtrisë të miratuar
22 në fillim të korrikut 1998 dhe këto ishin ndërmjet shumë
23 dokumenteve të tjera të gjetura në shtëpinë e Jakup Krasniqit.
24 Një kapitull i rregulloreve që tregohet këtu në këtë
25 diapozitiv në D3, mbulon ushtrinë -- policinë ushtarake dhe

1 detyrat e veta. Ai përfshin një seksion që reflekton
2 komunikatat dhe deklaratat e Shtabit të Përgjithshëm. Në të
3 thuhet se policia ushtarake, "duhet të jetë e pamëshirshme
4 ndaj armiqve dhe ndaj të gjithë atyre që mundohen që të
5 pengojnë dhe të sabotojnë luftën tonë çlirimtare".

6 Siç mund të shihet edhe në diapozitivin D4, rregulloret
7 gjithashtu kërkojnë që policia ushtarake "të ndihmojë dhe të
8 bashkëpunojnë me shërbimin e zbulimit, drejtorinë e shërbimit
9 të zbulimit për hetimin e formave të ndryshme të krimit".
10 Ndërkohë që dokumentin e përmendur nga z. Halling, reflektohet
11 po ashtu e njëjta gjë.

12 Përgjegjësitë e policisë ushtarake reflektoheshin
13 gjithashtu në rregulloret e policisë ushtarake në Dukagjin, që
14 mund ta shikoni këtu në dokumentin D5. Janë rregulloret të
15 cilat miratoheshin në takimet e Shtabit të Përgjithshëm në
16 prani të Lahi Brahimajt. Këto rregullore përfshinin detyrat e
17 mëposhtme:

18 "Është detyrë e policisë ushtarake që të hetojnë dhe që
19 të zbulojnë të gjithë ata personat të cilët bashkëpunojnë në
20 çdo mënyrë me armikun".

21 Më tej vijohet në të njëjtin dokument se:

22 "Është detyrë e policisë ushtarake që të merren masa ndaj
23 të gjithë atyre që punojnë kundër Ushtrisë Çlirimtare të
24 Kosovës."

25 Përveç pranisë së Brahimajt, procesverbalet e takimeve të

1 shtabit të Dukagjinit duhet që të dërgoheshin në Shtabin e
2 Përgjithshëm në përputhje me urdhrin e tij.

3 Do të dëgjojmë gjithashtu prova nga dëshmitarë të shumtë
4 dhe dokumente të ndryshme sa i takon Shërbimit të Informativ i
5 cili është drejtuar nga z. Veseli.

6 Kjo këtu është një shënim nga një bllok shënimesh i UÇK-
7 së nga korriku 1998 që rendit shumë persona të dyshuar si
8 kolaboracionistë të pretenduar. Sikurse thuhet këtu, puna dhe
9 detyra e sektorit të zbulimit përfshin, "zbulimin e
10 kolaboracionistëve të armikut", dhe gjithashtu "kidnapime,
11 veprime, aktivitete me zyrtarë të policisë ushtarake".

12 Ngjashëm, rregulloret e zbulimit ushtarak në nivel
13 distrikti, që i përmendi edhe z. Halling më përpara, flasin
14 për kidnapime, për vrasje ose për likuidimin e personave që
15 konsiderohen të rëndësishëm për armikun.

16 Sikurse e dëgjuat më herët, në veçanti pas ofensivës së
17 verës 1998 dhe shprehjes në rritje të shqetësimeve të publikut
18 dhe ndërkombëtar lidhur me qasjen e UÇK-së dhe pasojat e saj,
19 vëmendja e kundërshtarëve për sa i takon luftës speciale,
20 filloi që të intensifikohen në drejtimin e të akuzuarve.

21 Shënime që shpjegojnë dhe përshkruajnë takimet e Shtabit
22 të Përgjithshëm të UÇK-së më 9 korrik 1993 [sipas përkthimit]
23 23 korrik të të njëjtit vit dhe 23 gusht 1998 [sipas
24 përkthimit] janë gjetur në shtëpinë e Jakup Krasniqit, që
25 zbulojnë që më 23 korrik 1998, Shtabi i Përgjithshëm diskutoi,

1 "që ekzistonin tendenca të forta për të shkatërruar UÇK-në
2 përmes LDK-së", dhe më 16 gusht 1998, Shtabi i Përgjithshëm
3 "foli për luftën speciale", si dhe veprimet e oficerëve të
4 FARK-ut të prezantuar nga Tahir Zemaj të ndërmarrë kundër UÇK-
5 së dhe luftës së saj në përgjithësi.

6 Në gusht 1998 sikurse e përmendi z. Halling, një
7 delegacion i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së përfshirë z.
8 Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi vizituan zonat e Shalës dhe
9 të Llapit. Z. Krasniqi më tej - më pas shkruan, ata u ndaluan
10 së pari në zonën e Llapit [sipas përkthimit] ku diskutuan me
11 komandantët lokalë rreth luftës speciale dhe rrezikut që
12 përbënte ajo për UÇK-në.

13 Në shtator z. Krasniqi dha një intervistë për Zërin e
14 Kosovës, ku sulmoi ata që pretendoheshin që të ishin të
15 përfshirë në luftën speciale në veçanti duke i lidhur këtë me
16 LDK-në. Ai akuzoi LDK-në për drejtimin e luftës speciale, "në
17 mënyrë që të pranohet një zgjidhje e pafavorshme për Kosovën",
18 dhe duke e paraqitur këtë si jo zgjidhje për situatën politike
19 në vend.

20 Po ashtu, edhe vënia në pyetje ose kritikën e UÇK-së janë
21 konsideruar si një formë e luftës speciale. Z. Krasniqi
22 denoncoi qarqet politike në Kosovë për "një luftë speciale
23 kundër UÇK-së. Ata nuk akuzojnë armë -- ushtrinë okupuese por
24 UÇK-në për dëmet e shkaktuara nga ushtria serbe".

25 Ditë më vonë, më 20 shtator 1998, 13 anëtarë të

1 delegacionit parlamentar në një vizitë humanitare në Qirez, u
2 arrestuan, u ndaluan, u keqtrajtuar nga anëtarë të UÇK-së,
3 përfshirë këtu Hashim Thaçin dhe Rexhep Selimin.

4 Më 23 shtator, Drejtoria e Policisë Ushtarake në UÇK
5 nxori një deklaratë për shtyp që mund ta shikoni në D7, duke
6 deklaruar se policia ushtarake e UÇK-së kishte arrestuar 13
7 "sindikalistë, përfaqësues të partisë institucionaliste", në
8 Qirez për "luftën e tyre përçarëse, partizane, robëruese,
9 institucionaliste dhe kundër luftës çlirimtare dhe duke vënë
10 në rrezik statusin politik të Kosovës".

11 Provat do të tregojnë gjithashtu që Hashim Thaçi i tha
12 anëtarëve të delegacionit të arrestuar që UÇK-ja nuk e njihte
13 parlamentin e Kosovës. I pyeti ata, dhe i bëri ata që të
14 shkruanin deklaratë që hiqnin dorë nga Rugova dhe nga LDK-ja.
15 Dhe iu kërkoi atyre që ata duhet të jepnin dorëheqjen nga
16 postet e tyre parlamentare.

17 Muajin pasues në tetor 1998, sipas shënimeve të gjetura
18 në kontrollin në shtëpinë e tij, Rexhep Selimi kreu një
19 inspektim në zonën e Llapit. Ai shënoi që komandanti i zonës
20 së Llapit, Remi Mustafa, kishte deklaruar se "lufta speciale
21 dhe propaganda" nuk ishin të pranishme, duke reflektuar
22 problemin dhe dijeninë e tij që kjo ishte çështje shqetësuese
23 për z. Selimi dhe për Shtabin e Përgjithshëm.

24 Në fund të atij muaji, pra në tetor 1998, kur z. Thaçi u
25 ul dhe shkroi fjalimin e parë publik të dhënë përmes

1 televizionit, ai filloi duke u përqendruar dhe duke iu
2 drejtuar atyre që nuk mbështetnin UÇK-në duke treguar se ata
3 ishin kolaboracionistë dhe tradhtarë. Ndërkohë, ai përdori
4 gjuhë të ndryshme edhe i vijoi më tej duke njohur arritjet e
5 UÇK-së, "pavarësisht propagandës dhe luftës së posaçme, luftës
6 speciale, të realizuar përpara, gjatë dhe pas ofensivave të
7 okupatorëve serbë, të ndihmuar nga elementë autonomistë".

8 Më pas më 1 nëntor 1998, Drejtoria e Policisë Ushtarake
9 të UÇK-së nxori Njoftimin për shtyp Nr. 4 që mund ta shihni
10 këtu në diapozitivin D8, duke njoftuar dy emra të LDK-së,
11 Jakup Kastrati dhe Cen Desku që ishin arrestuar nga policia
12 ushtarake e UÇK-së. Dy burrat ishin ndaluar sepse ata ishin
13 kundërshtarë politikë dhe arrestimi i tyre tregon se si
14 funksiononte dhe se si bashkëpunonin me njëra-tjetrën shërbimi
15 i zbulimit dhe instanca të tjera. Siç thuhet në njoftimi për
16 shtyp:

17 "Sipas informacionit që kemi gjatë aktivitetit të luftës
18 së UÇK-së, këta persona kanë bërë propagandë dhe kanë
19 bashkëpunuar me kolaboracionistët, përkatësisht Ramiz Hoxha
20 dhe Selman Binishi, të cilët ishin ekzekutuar ca kohë më para
21 nga UÇK-ja".

22 Ata ishin arrestuar që kishin frymëzuar gjithashtu një
23 luftë të posaçme dhe kishin iniciuar një lloj policie
24 autonome. Provat do të tregojnë gjithashtu që është gjetur një
25 urdhër ekzekutimi në trupin e Hoxhës, që e akuzonin atë për

1 bashkëpunim dhe duke -- dhe për shpërndarjen e propagandës
2 kundër shqiptarëve.

3 Më 3 nëntor, pra pas disa ditësh, një delegacion i UÇK-së
4 u takua me përfaqësues të Departamentit të Shtetit në Gjenevë.
5 Delegacioni përfshinte z. Mahmuti, emri i të cilit mund të
6 shikohet në deklaratën përkatëse i cili është përfaqësues i
7 UÇK-së jashtë Kosovës. Shënimet e këtij takimi u gjendën
8 gjithashtu në shënimet e z. Krasniqi të marra nga shtëpia e
9 tij dhe reflektuan diskutimet të cilat kishin të bënin me
10 arrestimin e z. Desku.

11 Sikurse e shikoni në ekran, D9, shënimet tregojnë se
12 Mahmuti shumë qartë shpjegoi:

13 "Sa i takon arrestimit të dy zyrtarëve të LDK-së, në këtë
14 rast kemi të bëjmë me dy spiunë. Ata janë arrestuar për shkak
15 se i kanë shkaktuar dëmtime kauzës tonë".

16 Ndërkohë që më pas, u vijua se si mund të ndodhte një gjë
17 e tillë në goftë se nuk do të kishte informacion për sa i
18 takon vendit të burgut, dhe për këtë Mahmuti thotë:

19 "Vetëm Shtabi i Përgjithshëm ka autoritet, as ne as
20 Demaçi nuk e ka këtë autoritet. Ne thjesht mund ta
21 transmetojmë këtë informacion te Shtabi i Përgjithshëm. Por
22 kjo është çështja e tyre".

23 Në shtëpinë e z. Krasniqi u gjet një draft, një projekt
24 fillestar, i një urdhri. Një urdhri i Drejtorisë së Drejtësisë
25 së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që tregohet këtu në D10,

1 që jep ndalimin e Kastratit dhe këtu thuhet, "kjo është bërë
2 sepse kanë bërë luftë speciale kundër UÇK-së dhe luftës së
3 popullit tonë për liri dhe pavarësi. Kanë arsyetuar
4 qyqarllakun e tyre dhe të partisë që ata i përkasin, gjithnjë
5 duke penguar angazhimin e popullit në luftë për liri. Kanë
6 përhapur pasiguri dhe fetisizëm kudo që kanë shkuar. Nuk kanë
7 ndihmuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Përkundrazi e kanë
8 penguar dhe e kanë sabotuar luftën e saj të drejtë".

9 Provat do të tregojnë më tej se me 6 nëntor 1998, në një
10 takim që përfshinte diplomatë të Shteteve të Bashkuara,
11 përfaqësuesin Christopher Hill, Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin
12 dhe Fatmir Limajn, Z. Hill ngriti problemin ose çështjen e
13 këtyre arrestimeve dhe Z. Krasniqi tha që këta persona do të
14 liroheshin. Një episod i vetëm që lidh së bashku faktin që
15 Shtabi i Përgjithshëm dhe konkretisht dy të akuzuarit, kishin
16 qëllimin e përbashkët të shënjestrimit të kundërshtarëve.

17 Muajin pasues, në dhjetor 1998, z. Zyrapin, shefi i
18 Shtabit të Përgjithshëm, iu kërkoi drejtuesve të zonave që të
19 merrnin pjesë në një takim dhe kjo reflektohet në diapozitivin
20 e radhës në D11. Një kopje e këtij urdhri është gjetur
21 gjithashtu në kontrollin që i është bërë shtëpisë së z.
22 Krasniqi.

23 Një temë që duhej të raportonin komandantët, kishte të
24 bënte me mbrojtjen dhe sigurinë. Pas takimit me komandantët e
25 zonës dhe dorëzimit të raportit me shkrim, z. Zyrapin raportoi:

1 "Për sigurinë ndihmëse të veçantë japin njësitë speciale
2 dhe policia ushtarake që përballojnë me sukses luftën speciale
3 të armikut dhe dorën e zgjatur të tij".

4 Sërish mund të shikoni angazhimet e Shtabit të
5 Përgjithshëm me çështjen që ata kanë me luftën speciale dhe
6 rolin që kanë njësitë speciale dhe policia ushtarake për
7 trajtimin e këtyre.

8 Tani le të kalojmë në vitin 1999, z. Halling vëreu më
9 parë një bllok shënimesh të gjetur në shtëpinë e z. Selimi që
10 ka të bëjë me shërbimet e zbulimit dhe kundërzbulimit në zonën
11 e Dukagjinit në mars 1999.

12 Më pas, në ekran do të transmetohet një diapozitiv që nuk
13 duhet të bëhet i ditur për publikun.

14 Gjithashtu në kontrollin e z. Selimi u gjet ky dokument,
15 sërish i vitit 1999, që është një raport i komandës së zonës
16 operative të Dukagjinit që përmban një listë të gjatë të të
17 dyshuarve si kolaboracionistë në të gjithë Kosovën.

18 Në qoftë se do të kalojmë në diapozitivin e radhës dhe
19 përsëri nuk dua që të shfaqet për publikun ky diapozitiv.
20 Është slajdi D13, diapozitivi D13. Dhe sikurse mund ta shikoni
21 kjo është një listë e individëve të kërkuar nga policia
22 ushtarake. Pra shumë prej emrave janë pjesë e raportit të
23 policisë ushtarake. Përsëri, edhe kjo tregon edhe një herë
24 tjetër bashkëpunimin ndërmjet sektorit të zbulimit dhe
25 policisë ushtarake për të shënjestruar kundërshtarët dhe

1 kolaboracionistët e pretenduar.

2 Dhe po ashtu shënjestrimi i kundërshtarëve nuk u
3 përfundua pas Rambujesë dhe as pas marrëveshjes së Kumanovës.
4 Persona vazhduan të ndaloreshin, të merreshin në pyetje, të
5 keqtrajtoheshin, sepse dyshoheshin se ishin kundërshtarë të
6 UÇK-së, përfshirë këtu edhe marrjen e informacionit për
7 persona të tjerë të cilët mendoheshin se ishin kundërshtarë.

8 Ndërkohë ndërkombëtarët ishin në dijeni të qendrave të
9 ndalimit në atë periudhë dhe kanë biseduar me z. Thaçi në
10 mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë gjë. Ka raporte të UNMIK-ut
11 të KFOR-it dhe të organeve të tjera që tregojnë që UÇK-ja
12 është informuar në mënyrë të vazhdueshme që ushtarët e vet nuk
13 po respektonin marrëveshjen e demilitarizimit përfshirë këtu
14 edhe shërbimet e zbulimit dhe policinë ushtarake, dhe se
15 ushtarët e tyre po ndalonin mënyrë të paligjshme serbë dhe
16 civilë të tjerë.

17 Në përmbledhje, të nderuar Gjykatës, ndërkohë që të
18 akuzuarit kanë punuar së bashku, për të formuluar, për të
19 ruajtur, për të mbikëqyrur, për të monitoruar dhe për të çuar
20 më përpara objektivin e përbashkët, ata në mënyrë publike kanë
21 shpërndarë mesazhe për të cilat kanë qenë edhe të trajtës së
22 publikuar, dhe të transmetuar, dhe kanë inkurajuar gjithashtu
23 edhe vartësit e tyre në mënyrë që të sigurojnë zbatimin e
24 tyre. Kanë mbikëqyrur këto struktura, kanë krijuar struktura
25 të tilla, kanë krijuar organe të shumta rregullatorë dhe të

1 detyrueshme në mënyrë që qëllimin e tyre të përbashkët ta
2 çonin përpara, dhe janë përfshirë në zbatimin e këtyre
3 politikave për muaj, e muaj, e muaj të tërë me radhë.

4 Të nderuar Gjykatës, tani Z. Pace do të parashtrojë
5 modelin e tensionit [sipas përkthimit], vrasjeve, dhe abuzimit
6 që ka çuar si rezultat i përmbushjes së qëllimit kriminal të
7 përbashkët dhe që është provë e mëtejshme e pranisë së
8 ekzistencës së një plani të tillë.

9 Duke pasur parasysh kohën, kam parasysh se mund të
10 vijojmë më tej, kështu që në qoftë se më lejoni, dua t'ia jap
11 fjalën z. Pace.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
13 z. Tieger.

14 Fjala për ju Z. Pace.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mirëdita.

16 "Dhe këta persona, kolaboracionistët, që ishin të shumtë,
17 nuk janë ndëshkuar shumë për atë që ishin në të vërtetë".

18 Ky është një fragment i dëshmisë së Jakup Krasniqit që ka
19 dhënë para TPNJ-së më 10 shkurt 2005. Është diapozitivi E1. Do
20 të prezantoj edhe diapozitiva të tjerë që janë për t'iu
21 përcjellë publikut.

22 Provat që do të dëgjoni, të nderuar Gjykatës, janë në
23 kundërshtim të thellë me këtë pretendim të z. Krasniqi. Provat
24 do të tregojnë se mes prillit 1998 dhe gushtit 1999, anëtarë
25 të UÇK-së nën komandën dhe kontroll të të akuzuarit u hoqën

1 lirinë qindra individëve pa proces të rregullt ligjor.

2 Ka më së paku 440 incidente sa i takon ndalimit të
3 personave për të cilat ngrihen akuza në aktakuzë, ku
4 përfshihen persona që janë mbajtur të ndaluar në vende të
5 ndryshme. Këta viktimë përfshinin persona që punonin në
6 pylltari, bujqësi, gazetarë, persona që punonin për ndërmarrje
7 shtetërore, mësues dhe të tjerë. Shumë ishin mbështetës të
8 LDK-së ose thjesht nuk mbështesnin UÇK-në.

9 Përpara se t'i ndalonin, disa prej viktimave në fakt
10 ishin ushtarë të UÇK-së, ndërsa të tjerë ishin anëtarë të
11 forcave serbe. Krahas shqiptarëve dhe serbëve, tek viktimat
12 përfshiheshin romët, malazezët, edhe boshnjakë.

13 Provat do të na tregojnë se këta persona të cilët u
14 mbajtën të ndaluar në mënyrë të jashtëligjshme, u akuzuan ndër
15 të tjera si të ashtuquajtur kolaboracionistë. Kjo akuzë
16 asokohe ishte shumë e rëndë. Madje edhe vdekjeprurëse
17 ndonjëherë.

18 Siç keni dëgjuar sot, disa nga anëtarët e UÇK-së e
19 abuzuan këtë keqpërdorim. Dyshimet për bashkëpunim shpesh
20 ishin të pabaza.

21 Vetë akti i arrestimit apo ndalimit nga ana e UÇK-së
22 nënkuptonte se viktimat për krimet për të cilat janë ngritur
23 akuza, nuk merrnin pjesë në mënyrë aktive në luftimet që po
24 ndodhnin. Këto viktimë u morën në pyetje, u rrahën dhe u
25 abuzuan fizikisht apo psikologjikisht. Ama fatkeqësisht ata

1 ishin më fatlumët. Të paktën 102 viktimat nuk mbijetuan, por
2 vdiqën mizorisht sepse konsideroheshin kundërshtarë.

3 Anëtarët e UÇK-së nuk dhanë informacion sa u takon
4 vendndodhjeve të tyre për të paktën 20 viktimave që janë pjesë
5 e akuzave për të cilat janë ngritur akuza në aktakuzë, duke i
6 lënë kështu miqtë dhe të afërmit në agoni.

7 Këto veprime, dhe të tjera, përbënin veprën penale të
8 përndjekjes për arsye politike dhe/ose etnike.

9 Shtrirja gjeografike e akuzave është relativisht e gjerë,
10 mbulon vende ndalimi në Kosovë, në gjithë Kosovën dhe disa
11 pjesë të Shqipërisë.

12 Ndonëse intensiteti ishte i ndryshëm sa i takon
13 incidenteve për të cilat janë ngritur akuza, sidoqoftë krimet
14 kryheshin në mënyrë konsistente. Nga provat do të shohim që
15 krimet nuk ishin të palidhura apo incidente të izoluara, nga
16 keqbërës apo anëtarë të UÇK-së që nuk ishin lidhje. Në fakt,
17 provat do të tregojnë se krimet u kryen në praktika të
18 ngjashme kohore dhe hapësinore.

19 U kryen në mënyrën sistematike. Ishin të zgjeruara. Ishin
20 pjesë e një sulmi që shënjestronte në mënyrë të drejtpërdrejtë
21 kundërshtarët. U kryen në kontekstin dhe asocioheshin me
22 konfliktin e armatosur mes UÇK-së dhe forcave të IRJ-së. U
23 kryen për realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal.

24 Ky gjyq, të nderuar Gjykatës, është për këto krime që
25 provat do të na tregojnë se të akuzuarit janë fajtorë.

1 Imazhet në ekranin tuaj, diapozitivi E2, është e ngjashme
2 me atë që patë më herët dhe tregon vendndodhjet në Kosovë dhe
3 disa pjesë të Shqipërisë ku apo rreth të cilave zonave u kryen
4 krime për të cilat janë ngritur akuza, pra pranë atyre zonave.

5 Imazhi që keni përballë tani, E3, tregon 440 incidentet
6 lidhur me ndalimet për të cilat janë ngritur akuzat në
7 aktakuzë, secili me pikë blu, dhe tregon afërsinë e
8 vendndodhjes së ndalimit. Ju do të dëgjoni se shumë të ndaluar
9 nuk u mbajtën vetëm në një vend të UÇK-së, por u transferuan
10 dhe në një vend tjetër, apo në shumë vende të tjera gjatë
11 kohëzgjatjes së ndalimit të tyre.

12 Kjo tregon nivelin e organizimit të UÇK-së, të
13 bashkëpunimit mes anëtarëve të UÇK-së në vende të ndryshme, të
14 kontrollit të plotë që ushtronin ata mbi të ndaluarit.

15 Të akuzuarit kishin komandën dhe kontrollin mbi anëtarët
16 e UÇK-së të përfshirë në vende të ndryshme të transferimit.

17 Do të dëgjoni prova të transferimeve që kanë ndodhur për
18 të ndaluarit nga Likoci drejt Llapushnikut, Drenocit drejt
19 Malishevës, Budakovë-Semetishtë, dhe nga Bubel në Kostërc.

20 Në gusht 1998, të paktën 8 të ndaluar u transferuan nga
21 Bare drejt Bajgorës. Në të njëjtin muaj, një delegacion i
22 Shtabit të Përgjithshëm ku ishte edhe Hashim Thaçi, Rexhep
23 Selimi dhe Jakup Krasniqi shkuan drejt Bajgorës, ku Shtabi i
24 Përgjithshëm në mënyrë formale emëroi udhëheqjen e lartë të
25 shtabit të zonës operative të Llapit.

1 Në maj dhe qershor 1999, të ndaluarit u transferuan nga
2 fabrika e metalit në Kukës, në vendndodhjen e UÇK-së në Cahan,
3 dhe në stacionin e MUP-it në Prizren. Rreth kësaj kohe, Hashim
4 Thaçi dhe Jakup Krasniqi u panë në fabrikën e metalit në Kukës
5 dhe mund ta shihni dhe në ekranin tuaj aktualisht, në slajdin
6 E4, pra diapozitivin E4.

7 Si dhe lidhur me aspektet e tjera që do të përmend pak më
8 vonë, transferimet që përmenda janë thjesht një shembull, nuk
9 janë aspak shteruese.

10 Të akuzuarit nuk akuzohen vetëm me ndalimin dhe
11 keqtrajtimin e këtyre të ndaluarve, po ashtu akuzohen për
12 vrasjen e të paktën 102 viktimave, edhe të gjithë ose janë
13 arrestuar, kidnapuar apo ndaluar nga UÇK-ja para se të
14 vdisnin.

15 102 pikat e kuqe që shihni në ekran përfaqësojnë viktimat
16 për të cilat akuzohen të akuzuarit se i kanë vrarë, në
17 aktakuzë dhe gjenden më të specifikuar në listën B të
18 aktakuzës. Këtu e kemi diapozitivin E5.

19 Shumë nga viktimat u ekzekutuan teksa ofensiva serbe i
20 afrohej zonave ku mbaheshin të ndaluar këta persona. Të
21 akuzuarit po ashtu akuzohen për zhdukjen e të paktën 20
22 personave nga 120 personat për të cilët akuzohen për vrasje.

23 Imazhi në ekran E6, tregon viktimat e zhdukjes në forcë
24 dhe këta përfaqësohen këtu me pikat portokalli.

25 Tani dua të kem vëmendjen tuaj për disa incidente më

1 specifikime [sipas përkthimit] për krimet për të cilat janë
2 ngritur akuza, thjesht për të ilustruar. Pastaj do të përmend
3 praktikat që dalin shpesh në provat që do të dëgjoni gjatë
4 gjyqimit. Po ashtu unë do të diskutoj se këto vendndodhje apo
5 afërsitë e tyre ku mbaheshin të ndaluarit, që u ndaluan, u
6 keqtrajtuuan, u vranë dhe u zhdukën, nuk ishin të panjohura apo
7 mister për të akuzuarit apo anëtarë të UÇK-së që i
8 kontrollonin ato.

9 Përkundrazi shumë nga vendet e ndalimit ku ndodhën
10 krimet, ishin në baza të UÇK-së përfshirë zonat operative dhe
11 selitë regjionale, apo shtabet regjionale. Këto ishin
12 vendndodhje ku të akuzuarit ishin shpesh të pranishëm dhe
13 kishin qasje në këto vende.

14 Në ekran, do të shihni një imazh të Jabllanicës, slajdi
15 E7, ku siç është edhe në aktakuzë, më së paku mes prillit 1998
16 dhe në fund të korrikut 1998, anëtarët e UÇK-së mbajtën të
17 paktën 13 persona në periudha të ndryshme kohore pa proces të
18 rregullt ligjor, në këtë kompleks që shërbente edhe si
19 kazermë.

20 Krahas akuzave lidhur me ndalimet dhe keqtrajtimin në
21 këtë vendndodhje, të akuzuarit akuzohen për vrasje të tre prej
22 këtyre të ndaluarve, dhe zhduken me forcë të njërit prej tyre.

23 Jabllanica është edhe vendi ku Kadri Veseli mori emrin e
24 luftës, *nom de guerre*, Luli. Tre të akuzuarit e tjerë, po
25 ashtu e njihnin këtë vendndodhje.

1 Në qershor 1998, Rexhep Selimi u takua me anëtarët e
2 tjerë të NKP-së në një shtëpi në Jabllanicë. Gjatë këtij
3 takimi, u zgjodh edhe shtabi i zonës së Dukagjinit.

4 Muajin vijues, Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, Jakup
5 Krasniqi dhe të tjerë po ashtu vizituan Jabllanicën.

6 Rreth periudhës së kësaj vizite, drejtoria e
7 informacionit të UÇK-së nxori komunikatën 49 që e pamë më
8 herët sot, ku flisnin për masat që duhet të merreshin kundër
9 atyre që quheshin kolaboracionistë. Ju patë një draft të kësaj
10 komunikate të cilën ZPS-ja e mori nga shtëpia e Jakup
11 Krasniqit.

12 Ndër provat e tjera që do të dëgjoni lidhur me krimet për
13 të cilat janë ngritur akuzat për Jabllanicën, do të dëgjoni se
14 të paktën 4 nga viktimat që ishin mbajtur atje një ishte
15 pronar -- do të dëgjojmë për 4 viktima, një ishte një pronar
16 dyqani, një ishte një njeri që donte të kyçej në UÇK. Ju do të
17 dëgjoni se ushtarë të UÇK-së përfshirë edhe një anëtar të
18 Shtabit të Përgjithshëm që është -- quhet ndryshe anëtar i
19 NKP-së, me emër, i rrahu vazhdimisht këta persona për disa
20 ditë me radhë.

21 Si pasojë, një nga të ndaluarit kishte vështirësi të
22 merrte frymë. Tjetri, nuk ishte në gjendje të qëndronte në
23 këmbë, ishte ënjtur, dhe nuk mund të lëvizte. U akuzuan si
24 spiunë dhe kolaboracionistë. Pas disa ditësh që u mbajtën në
25 ndalim, ia arritën të arratiseshin bashkë me një të ndaluar

1 tjetër. Këta të dy nuk ishin në gjendje të ecnin për shkak të
2 keqtrajtimeve dhe thjesht mund të zvarriteshin. I kapën
3 ushtarët e UÇK-së, i rrahën mizorisht dhe i kthyen në qelinë e
4 tyre.

5 Një nga dy viktimat që ishte -- kishte, gëzonte shëndet
6 të plotë para ndalimit, u çua në një spital të UÇK-së pa
7 ndjenja. Veshkat nuk i funksiononin më, trupi ishte deformuar,
8 ishte ënjtur dhe nxirë. Atje vdiq.

9 Mbetjet e viktimës së dytë u zbuluan në shtator 1998.
10 Testimi konfirmoi identitetin e tij edhe plagë me armë zjarri
11 ishte shkaku i vdekjes së tij.

12 Do të flas për një vendndodhje tjetër, Llapushnikun. Mes
13 fundit të prillit 1998 dhe 25 ose 26 korrikut 1998, të paktën
14 30 persona -- u mbajtën të ndaluar në Llapushnik pa proces të
15 rregullt ligjor. Asokohe, Shtabi i UÇK-së në Llapushnik
16 ndodhej në një kompleks të rrethuar ku ishte një haur, stallë
17 lopësh, një shtëpi e vogël, një shtëpi më e madhe, një garazh
18 dhe kishte një pus të rrumbullakët në oborr. Mund t'i shihni
19 ekran në fakt, në diapozitivin E8.

20 Të burgosurit në Llapushnik u mbajtën në dy dhoma të
21 ndara, brenda të njëjtit kompleks. Një, të burgosurit thonin
22 që ishte një stallë lopësh, ose haur, mund ta shihni në
23 diapozitivin E9 dhe E10, në fotografinë përkatëse. Dhe tjetri
24 tha që ishte një depo. Në ekranin tuaj kjo mund të jetë --
25 është E11 dhe E12.

1 Krahas akuzave për ndalim dhe keqtrajtim, të akuzuarit po
2 ashtu akuzohen për vrasjen e 10 viktimave që janë mbajtur në
3 Llapushnik. Do të dëgjoni se në korrik të 1998, anëtarë të
4 UÇK-së shoqëruan rreth 30 të burgosur që mbaheshin të ndaluar
5 atje drejt malit të Berishës në kërcënimin e armëve. Një grup
6 me rreth 20 persona u kursye, pra u lirua. Por nga këta dy nga
7 viktimat që në fakt arritën të arratiseshin u ekzekutuan me
8 pushkë.

9 Testimet ADN dhe provat e tjera përcaktuan se trupat e
10 zhvarrosura në 2001 dhe 2002 nga një vend në malet e Berishës
11 ishin ata, ishin domethënë mbetjet e disa prej këtyre
12 viktimave. Shkaku i vdekjes për shumë nga këto viktima ishte
13 plagë me armë zjarri.

14 Vendi tjetër që unë do të përmend është Zllashi. Dhe
15 sipas aktakuzës, në shtator 1998 dhe mes 1 dhe 19 prillit
16 1999, anëtarë të UÇK-së mbajtën atje të paktën 8 persona, në
17 Zllash pra. Krahas akuzave lidhur me ndalimin dhe
18 keqtrajtimin, të akuzuarit akuzohen dhe me vrasjen e
19 paligjshme dhe zhdukjen me forcë të një prej këtyre të
20 ndaluarve.

21 Në ekran është diapozitivi E13 dhe keni një imazh nga
22 ajri të Zllashit.

23 Dhe E14 është një imazh i vendndodhjes përkatëse për të
24 cilën po flasim. Do të dëgjoni se në prill 1999, anëtarë të
25 armatosur të UÇK-së morën një shqiptar të Kosovës nga fshati i

1 tij në Zllash. E rrahën gjatë rrugës kur po e çonin atje, dhe
2 kur mbërriti e rrahën disa ushtarë të UÇK-së. Gjatë 18 ditëve
3 që u mbajt i ndaluar, u kanos, ishte objekt i një ekzekutimi
4 të simuluar, u akuzua si kolaboracionist dhe u rrah edhe në
5 raste të tjera përfshirë edhe me shkop bejsbolli, duke i
6 shkaktuar kështu lëndime të rënda.

7 T'i kthehem Kleçkës. Kjo është një vendndodhje për të
8 cilën do të dëgjoni shumë në veçanti, duke qenë se anëtarë të
9 Shtabit të Përgjithshëm në kohë të ndryshme e kanë përdorur
10 Kleçkën dhe rrethinat e Divjakës si bazë.

11 Këtu shihni në diapozitivi E15 një fotografi të Jakup
12 Krasniqit me Ferat Shalën dhe Fatmir Limajn në Kleçkë në
13 qershor 1998.

14 Shtabi i Përgjithshëm kishte një qendër ndalimi në një
15 shtëpi në rrethinat e Kleçkës, afërsisht në gjysmë të rrugës
16 midis selisë së Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë dhe shtabit
17 të Brigadës 121. Rreth 200-300 metra nga burgu i Kleçkës ishin
18 tri shtëpi të djegura, të cilat gjithashtu përdoreshin për të
19 mbajtur të burgosurit.

20 Së paku midis nëntorit 1998 dhe qershorit 1999 disa
21 anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën 20 persona për
22 periudha kohe të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në
23 këto vendndodhje. Krahas akuzave të lidhura me ndalimin dhe
24 keqtrajtimin, të akuzuarit akuzohen edhe për vrasjen e
25 paligjshme të 11 prej këtyre të ndaluarve.

1 Fotografia në ekran, diapozitivi E16 tregon qendrën e
2 ndalimit në një shtëpi në rrethinat e Kleçkës. Do të dëgjoni
3 se në shkurt 1999, dy viktima u sollën në Kleçkë ku u mbajtën
4 të ndaluar deri në prill 1999, në burgun e Kleçkës dhe në
5 shtëpitë e djegura. Kufomat e tyre u nxorën nga një varr pranë
6 burgut të Kleçkës. Shkaku i vdekjes për ta ishte plagë plumbi
7 në kokë dhe në trup.

8 I nderuar Gjykatës e kam parasysh kohën. Mund të ndaloj
9 tani, ose mbase më duhen edhe 15 minuta.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
11 pushim tani, pushimin e drekës. Të rikthehemi të gjithë në
12 orën 14.30, për të mbyllur dhe seancën -- pjesën e fundit të
13 seancës sot. Faleminderit.

14 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

15 --- Seanca rifillon në orën 14.29

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, keni
17 fjalën. Mund të vazhdoni përsëri.

18 PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

19 Do të flas tani për një prej qendrave përkatëse të
20 ndalimit në Prizren. Të akuzuarit akuzohen për ndalimin e së
21 paku tre personave pa proces ligjor të rregullt më 26 qershor
22 1999 ose rreth kësaj date.

23 Do të dëgjoni se dy prej të ndaluarve ju tha të kryenin
24 marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin, të ndaluarit u rrahën
25 përpara njëri-tjetrit dhe kur një i ndaluar kërkoi ujë, e

1 detyruan të pinte hollues boje.

2 Por nuk vuajtën vetëm të ndaluarit.

3 Për t'u fokusuar për një çast në krimin e zhdukjes me
4 forcë. Të nderuar Gjykatës, do të dëgjojnë përfshirë këtu edhe
5 nga anëtarët e familjeve të viktimave, për orvatjet që bënë
6 për të marrë informacion për njerëzit e tyre, përfshirë këtu
7 dhe fatin e tyre, përfshi edhe prej disa prej të akuzuarve. Në
8 këtë rast ata hasën në heshtje apo në informacione çorientuese
9 apo thjesht të gabuara ose dhe kërcënime. U përpoqën disa herë
10 por nuk arritën asgjë.

11 Do të dëgjoni prej një personi i cili herën e fundit me
12 të shoqen foli kur u ndaluan të dy. Pas lirimit të tij u
13 përpoq të gjente informacion se ku ndodhej e shoqja por edhe e
14 bija, e cila gjithashtu ishte ndaluar. Po në vend që ta
15 informonin e kërcënuan me vdekje.

16 Në qershor të vitit 1998, dy kundërshtarë të cilët ishin
17 arrestuar, marrë në pyetje dhe në një rast rrahur rëndë prej
18 anëtarëve të NKP-së dhe instrumenteve të tyre në shtabin e
19 Drenocit i çuan pastaj në drejtim të Shtabit të Përgjithshëm
20 të UÇK-së nga Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli personalisht, ku i
21 pranishëm ishte dhe Rexhep Selimi. Për këta nuk u dëgjua më,
22 nuk u mor më vesh se ç'u bë.

23 Në fakt, në krah, kur është dëshmia e një gruaje e cila e
24 pa të birin pasi e kishin ndaluar, ai trupi ishte me shenja,
25 mavijosje dhe i rrahur. Në fakt, kufomat e disa prej viktimave

1 të zhdukjeve me forcë nuk janë gjetur më kurrë.

2 Krahas akuzave për burgim, arrestim apo ndalim të
3 paligjshëm dhe arbitrar, akte të tjera çnjerëzore, trajtim
4 mizor, torturë, vrasje të paligjshme, zhdukje me forcë, të
5 akuzuarit akuzohen edhe me përndjekje për shkaqe politike
6 dhe/ose etnike - krim kundër njerëzimit. Këto krime janë kryer
7 përmes veprimeve dhe sjelljen kriminale të cilën unë e
8 përmenda.

9 Provat të cilat i kam cekur deri tani janë vetëm disa,
10 kanë të bëjnë vetëm me disa prej pikave apo qendrave të
11 ndalimit ku kanë ndodhur këto krime të kryera nga të
12 akuzuarit. Pavarësisht nga objekti relativisht i gjerë kohor
13 dhe gjeografik, dallimeve mes viktimave sa i takon moshës,
14 përkatësisë etnike dhe profesioneve dhe kohëzgjatjes së
15 ndalimeve, të nderuar Gjykatës padyshim do ta vënë re një
16 praktikë që do dalë në provat të cilat do të paraqiten këtu,
17 që unë do t'i trajtoj tani.

18 Gjatë provave që ne do të paraqesim, do të shikoni sesi
19 të ndaluarit u mbajtën në këto qendra ndalimi, gjatë gjithë
20 kohës janë marrë në pyetje. Provat do të tregojnë se kjo
21 marrje në pyetje përfshin dhe arsyet pse ato ishin thjesht të
22 shënjestruar, pra, ato konsideroheshin si kundërshtarë,
23 domethënë; ata perceptoheshin apo mendoheshin se bashkëpunonin
24 me forcat ushtarake të Republikës Federative të Jugosllavisë
25 apo zyrtarët e institucioneve shtetërore apo se ishin të

1 lidhur me ata.

2 Në Likoc, të ndaluarit u akuzuan se ishin tradhtarë,
3 spiunë, bashkëpunëtorë të serbëve ose mbështetës të LDK-së. Në
4 Jabllanicë, të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se
5 shoqëroheshin me serbë ose punonjës policie dhe se ishin
6 spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe. Një i ndaluar
7 pranoi akuzat thjesht për t'i shpëtuar torturave të mëtejshme.
8 Në Llapushnik dhe në Drenoc, të ndaluarit u akuzuan se
9 bashkëpunonin me serbët, se ishin spiunë apo se nuk
10 mbështetnin UÇK-në. Ndërsa të ndaluarit në Budakovë, një prej
11 tyre, një i ndaluar, iu tha se ai që po i ndodhte ngaqë kishte
12 punuar me serbët. Të ndaluar të tjerë në këtë qendër ndalimi u
13 pyetën nëse kishin spiunuar kundër UÇK-se dhe se u shërbenin
14 forcave serbe dhe u akuzuan se ishin spiunë apo se përndryshe
15 punonin apo bashkëpunonin me serbët.

16 Në Bar dhe Bajgorë, të ndaluarit u akuzuan se
17 bashkëpunonin me autoritetet serbe. Njërit prej tyre iu tha të
18 pranonte se kishte bashkëpunuar me serbët përndryshe do të
19 vritej.

20 Ndërkohë që mbahej i ndaluar në një vendndodhje tjetër
21 përpara se të transferohej në Llapashticë, një të ndaluar ju
22 tha se ishte dënuar nga që kishte bashkëpunuar me serbët.

23 Gjatë marrjes në pyetje në Zllash, të ndaluarit u akuzuan
24 si kolaboracionistë, miq të serbëve apo spiunë.

25 Në Baicë, Hashim Thaçi dhe Sabit Geci morën në pyetje të

1 ndaluarit duke u identifikuar si rugovistë, duke u kërkuar që
2 të nënshkruanin deklaratat për të hequr dorë nga Ibrahim
3 Rugova dhe duke kërkuar të hiqnin dorë nga LDK-ja dhe të
4 jepnin dorëheqjen nga të gjitha funksionet parlamentare.

5 Në Cahan, të ndaluarit u morën në pyetje dhe u
6 keqtrajtuar në bazë pretendimeve se ishin kolaboracionistë dhe
7 bashkëpunëtorë të serbëve, spiunë apo simpatizantë të
8 president Rugovës dhe të LDK-së.

9 Në Bubël dhe Kosterc, të ndaluarit u akuzuan dhe u morën
10 në pyetje për mbështetjen e LDK-së dhe për kundërshtimin dhe
11 pengimin e UÇK-së.

12 Në Verban dhe Tusuz, të ndaluarit u akuzuan si persona të
13 lidhur apo si bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe.

14 Dhe, të nderuar Gjykatës, këto parashtrime të fundit mund
15 t'ju duken si të përsëritura, por ato ilustrojnë këtë praktikë
16 në të gjithat pikat e ndalimit.

17 Një tjetër praktikë që vihet re kudo, do ta vini re dhe
18 nga provat, është se të ndaluarit në shumë vende përfshi këtu
19 Likocin, Jabllanicën, Llapushnikun, Malishevën, Budakovën,
20 Jeshkovën dhe Zllashin u mbajtën në dhoma apo mjedise të cilat
21 mbaheshin të kyçura apo të ruajtura me anëtarë të UÇK-së. Të
22 ndaluarit në Likoc, Jabllanicë, Budakovë, Llapashtic, Shalë,
23 Kleçkë, Bob dhe Ivajë, Cahan dhe në ish-ndërtesën e Ministrisë
24 së Brendshme mbaheshin të lidhur me njëri-tjetrin apo edhe me
25 objekte të tjera si ndonjë pemë apo radiator, përfshirë këtu

1 dhe me litar apo me tel.

2 Të nderuar Gjykatës, këto vende, siç e përmenda, diheshin
3 mirë nga të akuzuarit dhe nga anëtarët e UÇK-së të cilët
4 komandonin.

5 Duke marrë Llapashticën si shembull, një fshat në veri të
6 Prishtinës, ishte vendndodhja e shtabit të zonës së Llapit ku
7 kishte selinë kryesore komandanti i zonës. Rreth 200-300 metra
8 larg shtabit të zonës ndodhej shtabi i policisë ushtarake dhe
9 një stallë e kthyer në qendër ndalimi.

10 Së paku midis nëntorit 1998 dhe marsit 1999, u mbajtën së
11 paku 52 të ndaluar në Llapashticë. Pak para kësaj periudhe dhe
12 nga fundi i tetorit 1998, një delegacion i Shtabit të
13 Përgjithshëm, që përfshinte Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin dhe
14 të tjerë, vizituan selinë e shtabit të Llapashticës dhe
15 mbajtën një mbledhje që u përqendrua në çështje ushtarake dhe
16 politike.

17 Në këto vende të kyçura apo të ruajtura me roje me armë
18 të ndaluarit në vende të tilla si Likoci, Jabllanica, Drenoci,
19 Malisheva, Zllashi, Kleçka, Bob dhe Ivajë, Kukës dhe ish-
20 ndërtesa e MUP-it, se të ndaluarit kishin ushqimin, ujin,
21 kushtet higjienike, sanitare, kujdesin shëndetësor dhe shtrojet
22 e mbulojet i kishin të pamjaftueshme.

23 Do të dëgjoni se në Llapushnik dyshemeja ishte prej
24 betoni, me fekale kafshësh të shpërndara përreth. Të ndaluarit
25 mbaheshin të lidhur me zinxhir. Ata ishin të detyruar të

1 urinonin dhe të bënin nevojën në një kovë të lidhur me zinxhir
2 dhe në të njëjtin vend ku flinin.

3 Do të dëgjoni prova se kushtet e ndalimit në disa vende
4 të caktuara ishin kaq të rënda sa që disa persona të caktuar të
5 mbajtur aty të ndaluar mendonin se më mirë të kishin vdekur
6 sesa të mbaheshin ashtu. Në këto vendndodhje ku të ndaluarit u
7 mbajtën në kushte kaq të këqija ishin po kështu të mirënjohura
8 për të akuzuarit, diheshin mirë pra, nga të akuzuarit.

9 Pamja në ekran, Diapozitivi E18, paraqet shtabin e UÇK-së
10 në Drenoc ku janë mbajtur disa të ndaluar. Afërsisht midis
11 majit dhe korrikut të vitit 1998, së paku 38 persona u mbajtën
12 të ndaluar dhe nën rojë të armatosur për periudha të ndryshme
13 dhe pa proces ligjor të rregullt në Drenoc.

14 Hashim Thaçi e vizitoi Drenocin disa herë midis fundit të
15 prillit dhe fillimit të gushtit të vitit 1998.

16 Në ekran, diapozitivi E19, duket Hashim Thaçi i armatosur
17 dhe me uniformë gjatë një vizite në malin e Zatriqit, që është
18 afër Drenocit, në qershor të vitit 1998. Është bashkë me dy
19 anëtarë të UÇK-së.

20 Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi gjithashtu kanë qenë në
21 Drenoc gjatë kësaj periudhe kohe.

22 Krahas kushteve të rënda në të cilat janë mbajtur të
23 ndaluarit, të ndaluarit shpesh u rrahën apo u keqtrajtuan
24 fizikisht. Anëtarë të UÇK-së nën komandën dhe në kontroll të
25 akuzuarëve përdornin lloj-lloj formash dhe instrumentesh për

1 të keqtrajtuar viktimat. Në Jabllanicë të ndaluarit u goditën
2 në tërë trupin me shkopinj bejsbolli, u grushtuan, u
3 shkelmuan, u prenë dhe u çanë me thika. Në Drenoc të ndaluarit
4 u goditën me shkopinj, grushte, shkelma dhe ju lidh në trup
5 rrymë elektrike. Në Kleçkë të ndaluarit u shkelmuan me këpucë
6 ushtarake, u goditën me grushte dhe u rrahën me kondak pushke
7 dhe me pistoleta, me tel dhe tuba plastikë. Në Zllash, të
8 ndaluarit iu kalua në trup rrymë elektrike, u dogjën me dyllin
9 e nxehtë të qiriut apo me hekur të nxehtë, u rrahën me
10 shkopinj hekuri apo me dorezën e sakicës.

11 Do të dëgjoni se disa prej rrahjeve vijuan edhe pasi të
12 ndaluarit i humbën ndjenjat.

13 Në këtë pamje do të shohim pjesën e jashtme dhe të
14 brendshme të garnizonit ushtarak në Cahan ku janë mbajtur të
15 ndaluarit. Janë diapozitivët E20 dhe E21.

16 Në Cahan, të ndaluarit u rrahën me shufra hekuri, hunj
17 druri, shkopinj gome, këpucë, një kamxhik të improvizuar, një
18 brisk rroje dhe pushkë.

19 Në Llapushnik dhe Verban, disa të ndaluarve ua shkulën
20 thonjtë e duarve me darë.

21 Do të dëgjoni se në Likoc, të ndaluarit u rrahën me
22 shishe uji, shkopinj bejsbolli, shkopinj druri, pushkë, shufra
23 metali dhe vegla. Iu lëshua dhe rrymë elektrike në trup.

24 Të ndaluarit e mbajtur në Likoc midis së paku prillit të
25 vitit 1998 dhe janarit të vitit 1999 në ish-stacionin e

1 policisë dhe në vende të tjera. Ish-stacioni i policisë në
2 Likoc gjithashtu kishte edhe komandën e zonës së Drenicës.
3 Rreth 100 metra më tutje ishte komanda e Shtabit të
4 Përgjithshëm që ndodhej në shtëpinë e një të afërmi të Hashim
5 Thaçit.

6 Në Likoc dhe Llapashticë, të ndaluarit u detyruan të
7 rrihnin njeri-tjetrin dhe të kryenin punë krahu. Do të dëgjoni
8 se të ndaluarit përfshirë edhe në Jabllanicë, Malishevë,
9 Jeshkovë dhe Cahan kishin shenja të dukshme të keqtrajtimit
10 fizik.

11 Në ekran është diapozitivi E22, pamja e një qendre
12 ndalimi në Malishevë. Në korrik të vitit 1998, disa anëtarë të
13 UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku 48 persona në periudha të
14 ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në ish-stacionin e
15 policisë në Malishevë. Ky ndalim zgjati deri më datë 26 ose 27
16 korrik të vitit 1998.

17 Siç jua përmendi kolegu im më përpara, më 23 korrik 1998,
18 ndërsa të ndaluarit ende mbaheshin në Malishevë, Hashim Thaçi
19 dhe Kadri Veseli mbajtën një takim me përfaqësues të ambasadës
20 austriake në shtabin e UÇK-së në Malishevë. Gjatë takimit u
21 diskutuan pretendimet për ndalime dhe rrëmbime të kryera nga
22 UÇK-ja. Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli u paralajmëruan se
23 shkelja e të drejtave të njeriut nga UÇK-ja nuk do t'i
24 shërbente kauzës së UÇK-së.

25 Dhimbja fizike ishte veç një prej formave të vuajtjeve që

1 pësuan viktimat në duart e anëtarëve të UÇK-së.

2 Të ndaluarit në Likoc, Jabllanicë, Zllash, Drenoc, Bar
3 dhe Bajgorë, Llapashticë u kërcënuan me vdekje apo me vdekjen
4 e personave të afërm të tyre. Në Verban një viktimë u kërcënuar
5 me përdhunimin dhe vrasjen e së shoqes dhe të bijave. Do të
6 dëgjoni se në Tusuz dhe në Llapashticë disa të ndaluar u
7 detyruan që të hapnin varrin e vet.

8 Në Jabllanicë, Tusuz, Zllash, Kleçkë, Varosh dhe Drenoc
9 të ndaluarit mund të shihnin dhe/ose të dëgjonin keqtrajtimin
10 e të ndaluarve të tjerë, padyshim kjo kontribuonte në
11 atmosferën e frikës në atë qendër.

12 Do të dëgjoni se në ish-ndërtesën e Ministrisë së
13 Brendshme të ndaluarit panë dhe dëgjuan rrahjen e të ndaluarve
14 të tjerë. Disa të ndaluar u vunë në dhoma të mbuluara me gjak.
15 Një të ndaluar e çuan në një zyrë ku ndodhej një kufomë dhe e
16 kërcënuan aty me vdekje.

17 Disa të ndaluar po kështu pësuan humbje materiale. Sendet
18 e të ndaluarve në pika të tilla si në Jabllanicë, Brenoc,
19 Budakovë dhe Jashkovë u konfiskuan dhe nuk iu kthyen kurrë.

20 Pas keqtrajtimit të pamëshirshëm që pësuan gjatë ndalimit
21 të tyre, ata që patën aq fat sa të dilnin gjallë vijuan që të
22 vuanin pasojat e keqtrajtimi që pësuan në duart e UÇK-së. Do
23 të dëgjoni se disa prej këtyre vazhdojnë të vuajnë edhe sot e
24 kësaj dite.

25 Për shembull, keqtrajtimi i të ndaluarve në Verban i kanë

1 shkaktuar që të pësojnë të mavijosura, ënjtje, gjakderdhje,
2 nuk mund të flinin, humbën vetëdijen. Pas keqtrajtimit të tyre
3 ata patën nevojë të shkonin në spital dhe të merrnin trajtim
4 mjekësor. Dhe pësuan dëmtime psikologjike dhe/ose fizike të
5 cilat vazhduan edhe pas lirimit të tyre, përfshirë edhe
6 shterpësinë.

7 Të ndaluarit pësuan trauma mendore dhe fizike afatgjata
8 si pasojë e kohës që kaluan në objektin e ndalimit në
9 Llapushnik, këtu përfshihen humbja e pjesëve të trupit dhe
10 dëmtimi i shqisave, mavijosje të rënda, eshtra të thyera dhe
11 trauma të vazhdueshme mendore. Viktimat të cilat dolën gjallë
12 nga qendra e ndalimit në Likoc apo Jabllanicë, mes të tjerash,
13 ende vijojnë të vuajnë pasojat fizike dhe psikologjike nga
14 keqtrajtimi i atyre. Këto viktima jetojnë me këtë dhimbje prej
15 dekadash.

16 Për ta mbyllur. Incidente të cilat unë i përmenda sot nuk
17 janë shteruese. Gjatë këtij gjyqi, të nderuar Gjykatës do të
18 dëgjojnë prova të gjerësishme për secilin vend të aktakuzës.
19 Viktimat kanë vuajtur shumë në heshtje dhe nën frikën e
20 hakmarrjes për thujse 25 vjet. Dëshmitarë të tjerë kanë
21 pritur po kaq gjatë që të tregojnë historinë e tyre.

22 Viktimat e krimeve për të cilat akuzohen të akuzuarit
23 duhet që të marrin drejtësi.

24 Tani, znj. Lawson do të mbajë fjalën përmbjllëse të
25 deklaratës hyrëse të ZPS-së.

1 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit, z. Pace.

2 Znj. Lawson, e keni ju fjalën.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kolegët prezantuan lidhur me
4 strukturat dhe organizimin e kontrollit përmes të cilëve
5 vepruan të akuzuarit, qëllimin kriminal të përbashkët dhe
6 krimet. Unë do të bëj disa komente përmbyllëse dhe për arsye
7 planifikimi besoj që do të përfundoj këtë prezantim brenda 15
8 minutave.

9 Ka pasur disa gjykime të mëparshme që kanë trajtuar
10 krimet e kryera nga pjesëtar individual të UÇK-së gjatë
11 konfliktit, përfshirë këtu dhe TPNJ-në, gjykatat e Kosovës dhe
12 këtë Gjykatë. Disa prej tyre kanë shqyrtuar dhe anëtarë të
13 lartë të UÇK-së; për shembull, Lahi Brahimaj, ishte anëtar i
14 Shtabit të Përgjithshëm në kohën kur ka kryer krimet e
15 torturës për të cilën ai mori vendim fajësie. Megjithatë,
16 asnjë gjykatë tjetër e mëparshme nuk i është kërkuar që të
17 shqyrtojë rolin dhe përgjegjësinë e pjesëtarëve individualë
18 kyç të Shtabit të Përgjithshëm në mënyrën që i kërkohet këtij
19 Trupi Gjykues. Po ashtu, asnjë gjykatë tjetër e mëparshme nuk
20 ka pasur prova më të plota në dispozicionin e vet sikurse ka
21 ose do të ketë ky Trup Gjykues.

22 ZPS-ja ka intervistuar mijëra dëshmitarë, pjesa më e
23 madhe e të cilëve janë shqiptarë të Kosovës; ata që kanë marrë
24 pjesë në luftime, kanë qenë pjesë e personave të intervistuar
25 prej nesh ashtu siç edhe personat e tjerë që kontribuan në

1 mënyra të tjera.

2 Kemi folur me anëtarë të UÇK-së në çdo nivel, nga
3 ushtarët e zakonshëm deri tek anëtarët e policisë ushtarake
4 dhe shërbimeve të zbulimit, gjithashtu edhe persona me poste
5 komanduese në njësite, në batalione, në zona dhe brenda për
6 brenda vetë Shtabit të Përgjithshëm. Kemi folur gjithashtu
7 edhe me ata që kanë qenë viktimë të krimeve të kryera gjatë
8 konfliktit. Kemi dëgjuar histori trimërie mbresëlënëse dhe
9 kemi dëgjuar po ashtu edhe histori të vuajtjeve të
10 paimagjinueshme.

11 Trupi Gjykses do të ketë mundësinë të dëgjojë
12 drejtpërdrejt nga shumë prej këtyre dëshmitarëve.

13 Sikurse u përshkrua nga kolegu im pak më parë, ZPS-ja do
14 të paraqesë prova të krimeve të cilat ishin të përhapura dhe
15 sistematike, që kanë ndodhur në mbi 40 qendra ndalimi të UÇK-
16 së, përfshirë këtu edhe bazat kryesore të shtabet e komandave.
17 Do jetë e hapur për Panelin që të arrijë në përfundimin që i
18 vetmi deduktim i arsyeshëm nga prova të tilla është ekzistenca
19 e qëllimit të përbashkët sikurse shkruhet në aktakuzë.

20 Megjithatë, për të qenë të qartë, ZPS-ja nuk po
21 mbështetet vetëm në modelin e sjelljes të bazuar në prova. Ky
22 model është një prej faktorëve të tjerë të shumtë përforcues
23 që do t'i bëjë të mundur këtij Trupi Gjykses që të bindet
24 përtej dyshimit të arsyeshëm.

25 ZPS-ja ka marrë një mori provash shkresore të kohës dhe

1 dokumente të tjera, përfshirë këtu dhe disa qindra faqe të
2 sekuestruara nga shtëpitë e të të akuzuarve gjatë arrestimeve
3 të tyre. Sikurse e keni dëgjuar gjatë prezantimeve të ditës së
4 sotme, qëllimi i përbashkët po ashtu dëshmohet mjaftueshëm
5 përmes këtyre dokumenteve, qofshin ato komunikata, rregullore,
6 fletore apo blloqe shënimesh, urdhra, kopje të intervistave me
7 anëtarë të lartë të UÇK-së, përfshirë të akuzuarit apo histori
8 të shkruara autentike.

9 Dhe nga provat që do të paraqiten demonstrimet më të
10 qarta dhe më bindëse si të qëllimit të përbashkët ashtu edhe
11 të kontributeve të secilit prej të akuzuarve janë vetë fjalët
12 dhe veprimet e të akuzuarëve.

13 Kemi Hashim Thaçin, i njohur si Gjarpri. Sipas një
14 dëshmitari ndërkombëtar, kur kishte ndonjë çështje që do të
15 duhej që të trajtohej që shkonte përtej trajtimit në nivel
16 zone, personi që i duhej drejtuar ishte z. Thaçi.

17 Kadri Veseli, duke e prezantuar veten në një gazetar
18 thotë dhe këtu citoj "Unë quhem Luli. Të gjithë e dinë se kush
19 jam unë". Është dokumenti F1. Veseli ka pranuar dhe citoj që
20 "Unë kam qenë në ato vendet ku kishte nevojë për mua. Kam
21 lëvizur në territoret e kontrolluara nga UÇK-ja", dokumenti
22 është F2.

23 Rexhep Selimi, i cili ka përdorur nofka të ndryshme ka
24 pranuar se ka qenë në mënyrë të vazhdueshme i pranishëm në
25 terren në Kosovë dhe ka udhëtuar gjerësisht në të gjitha

1 zonat.

2 Dhe Jakup Krasniqi, është konsideruar nga një prej
3 komandantëve të zonës si personi që mishëronte Shtabin e
4 Përgjithshëm në verën e vitit 1998.

5 Sikurse e keni parë në prezantime, Krasniqi ishte personi
6 i cili zakonisht nënshkruante dokumentet, por këtë gjë
7 gjithmonë e bënte në emër të Shtabit të Përgjithshëm. Për ta,
8 mentaliteti i pamëshirshëm që "ose je me ne dhe i nënshtrohesh
9 pushtetit tonë ose je kundër nesh" qëndronte në themelin e
10 qëllimit të përbashkët, ndërkohë që ky qëndrim është
11 reflektuar në prova herë pas here. Keni dëgjuar shumë shembuj
12 të fjalëve dhe veprime të tyre sot.

13 Rexhep Selimi duke pranuar që përfaqësues të tjerë
14 politikë dhe këtu citoj "Po përpiqen të denigrojnë luftën tonë
15 të shenjtë me qëndrimet e tyre pacifiste". Kjo është dokumenti
16 në F3.

17 Hashim Thaçi në zonën e Dukagjinit në verën e vitit 1998,
18 shoqëruar nga Rexhep Selimi, deklaroi dhe këtu citoj "Ata të
19 cilët nuk e njohin Shtabin e Përgjithshëm janë kriminelë dhe
20 ne nuk do jua lëmë armët në dorë kriminelëve. Ne do të
21 luftojmë kundër tyre". Ky është dokumenti F4.

22 Thaçi, Selimi dhe Krasniqi së bashku kanë udhëtuar në
23 zona për të këshilluar komandantët për mënyrën sesi të
24 zbulonin dhe të trajtonin formën e luftës speciale, mbartësit
25 e të cilës diskutohen që ishin kolaboracionistët dhe që ishin

1 anëtarë me lidhje të forta në LDK.

2 Krasniqi, në nëntor të vitit 1998, duke përshkruar UÇK-në
3 si dhe këtu citoj "po koordinon një luftë të posaçme nga
4 jashtë dhe nga brenda". Ky është dokumenti F5. Dhe gjetkë,
5 duke dhënë shpjegim të mëposhtëm sepse dy individë ishin
6 ndaluar nga UÇK-ja, citoj:

7 "Ata ishin në LDK dhe kishin një politikë të ndryshme,
8 mbase po mendonin që të ishin dhe pengesë për UÇK-në, por ata
9 nuk janë marrë si kolaboracionistë përderisa ne nuk e kishim
10 atë informacion".

11 Është dokumenti F6.

12 Pavarësisht roleve të tyre kryesore për formulimin,
13 artikulimin dhe shpërndarjen e politikës, të akuzuarit mund
14 përpiqen që të pretendojnë që nuk i njihnin personat që ishin
15 ndaluar, që ata nuk i njihnin personat që ishin keqtrajtuar
16 apo që u vranë. Në korrik 1998, Jakup Krasniqi ishte anëtar i
17 Shtabit të Përgjithshëm edhe zëdhënësi zyrtar i UÇK-së kur ai
18 publikisht pranoi që rrëmbimet dhe ekzekutimet po ndodhnin.

19 Dhe për më tepër, ky Trupi Gjykues do të dëgjojë për
20 rastet kur të akuzuarit përmes shembujve të tyre kanë
21 demonstruar zbatimin e kësaj politike. Për shembull, do
22 dëgjoni Thaçin dhe Veselin së bashku që i kanë nxjerrë të
23 ndaluarit nga një qendër ndalimi. Këta persona nuk janë parë
24 më kurrë që prej atëherë.

25 Thaçin dhe Veselin, edhe njëherë tjetër bashkë, që

1 kërkonin që të detyronin anëtarë të shquar të LDK-së që të
2 jepnin deklaratat publike në mbështetje të UÇK-së.

3 Thaçi, të shoqëruar kësaj here nga një anëtar i
4 identifikuar i NKP-së dhe nga kriminel i shpallur fajtor
5 Sabit Geci, që drejton ndalimin dhe marrjen në pyetje të 13
6 anëtarëve të delegacionit parlamentar, duke i marrë ata në
7 pyetje ndërkohë që ata ishin të lënduar nga rrahjet. Ky është
8 një incident në të cilin ka qenë i përfshirë dhe vetë Selimi.

9 Do dëgjoni gjithashtu edhe rastin e Selimit në një rast
10 tjetër që merrte në pyetje një të ndaluar. Dhe në një rast
11 tjetër që e kërcënon një gazetar dhe të cilin ai e akuzon se
12 ka kritikuar UÇK-në.

13 Ndërkohë Jakup Krasniqi do të shihet duke negociuar dhe
14 duke dhënë urdhra të shumta sërish në emër të Shtabit të
15 Përgjithshëm për arrestimin dhe lirim të të ndaluarve.

16 Ajo çfarë nuk do të dëgjoni është ndonjë nga të akuzuarit
17 duke marrë masat e nevojshme për të parandaluar krimet e
18 ngritura ose krimet që kanë vuajtur kundërshtarët ose që të
19 ndëshkojnë krimet që kanë vuajtur ata apo dhe mosreferimin e
20 këtyre personave për UNMIK-un apo KFOR-in për hetime. Këtë nuk
21 do ta dëgjoni sepse krimet kanë qenë të synuara nga të
22 akuzuarit dhe janë vënë në jetë prej vetë atyre.

23 Z. Whiting deklaroi që në fillim fare, por ia vlen që të
24 përmendet dhe njëherë: Këtu nuk është në gjykim UÇK-ja. Lufta
25 çlirimtare e realizuar nga UÇK-ja nuk është në gjykim. Këta

1 katër të akuzuar janë në gjykim lidhur me përgjegjësinë e tyre
2 vetjake për krimet e kryera kundër personave që ata i
3 konsideronin si kundërshtarë, pjesa dërrmuese e të cilëve, në
4 fakt, ishin bashkëpatriotë të tyre, shqiptarë të Kosovës.

5 Në përpjekjen e tyre për epërsi, ata rrënjosën një klimë
6 frike duke nxitur konfliktin midis fqinjëve, një klimë e cila
7 edhe sot e kësaj dite mbizotëron në Kosovë.

8 Për pjesën dërrmuese të mijëra vullnetarëve që u kyçën në
9 luftë, krimet e kryera nuk kishin vend në kauzën për të cilën
10 ata po luftonin. Ky gjykim kërkon që këta katër të akuzuar -
11 dhe vetëm këta të katër të akuzuar - të mbajnë përgjegjësi si
12 dirigjuesit e këtyre krimeve.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 Lawson.

15 Dua t'i kërkoj z. Laws, në qoftë se jeni të gatshëm që të
16 bëni hapjen tuaj tani përderisa përfunduar pak më herët.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Po. Me kënaqësi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë e
19 keni ju fjalën.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

21 Unë do të filloj me diçka për të cilën viktimat dhe të
22 akuzuarit mund të ndajnë të njëjtën qëndrim. Dhe kjo është kjo
23 që po them tani: Thujse 25 vite më përpara asnjë prej tyre
24 nuk ka menduar, qoftë edhe për një moment të vetëm, që do të
25 vinte një ditë ku do të takoheshin në një sallë gjyqi në Hagë.

1 Për të akuzuarit, në qoftë se provat e ZPS-së edhe
2 çështja që u përshkrua nga ZPS-ja sot është e saktë, pra, në
3 qoftë se është kështu, siç edhe e paraqitën, me siguri, që
4 atëherë do të kenë pasur një ndjeshmëri pandëshkueshmërie, ata
5 ishin persona të fortë ishin në kulmin e strukturave të
6 pushtetit në Kosovë. Në qoftë se ata do kenë qenë duke i bërë
7 këto krime, me siguri nuk e kanë imagjinuar asnjëherë që do të
8 vinte një ditë si kjo e sotmja.

9 Ndërsa për viktimat, llogaridhënia ishte tejet e
10 paimagjinueshme. Ata ishin tërësisht të paforcë, të pashpresë,
11 ndërkohë që gjëra të tilla që dëgjuam sot paradite të
12 përshkruara ju bëheshin atyre dhe ju desh që të vuanin.

13 Në atë kohë, në atë vend, llogaridhënia ishte kaq e
14 largët si mundësi saqë nuk kishte pikë kuptimi. Megjithatë, ja
15 tek jemi sot. Të paktën është pjesërisht këmbëngulja e
16 viktimave që ngjarjet janë shpalosur kaq në mënyrë të ndryshme
17 dhe, kjo si rezultat ka çuar në faktin, që ne kemi mundësi që
18 të flasim në emër të tyre sot. Kemi mundësi që të flasim në
19 emër të të gjithë viktimave që kanë marrë pjesë në këto
20 procese gjyqësore, në mënyrë të barabartë, sepse pavarësisht
21 dallimeve ndërmjet tyre, ata janë të bashkuar në dëmin që kanë
22 pësuar mbi veten.

23 Pikëllimi, dhimbja, humbja dhe padrejtësia nuk njohin
24 dallime. Ata prekën njësoj të gjithë njerëzit. Ne të gjithë
25 mavijosemi dhe të gjithë nxjerrim gjak në të njëjtën mënyrë.

1 Neve njësoj vajtojmë humbjen e personave të dashur pavarësisht
2 se çfarë etnie kemi apo çfarë prejardhje kanë pasur
3 pararendësit tonë apo çfarë lidhje politike kemi.

4 Çfarë duam të themi ne në emër të tyre? Më lejoni që t'ju
5 drejtohem mbi pesë pika kryesore. Dhe dua të bëjë një
6 përmbledhje të tyre tani. Pika 1 ka të bëjë me viktimat dhe
7 çfarë ndodhi me ta; pika 2 ka të bëjë me klimën në Kosovë;
8 pika 3 janë të drejtat e viktimave në këtë proces gjyqësor;
9 pika 4 është sjellja e këtij gjykimi nga pikëpamja e
10 viktimave; dhe, në fund, pika 5, unë do të bëj disa komente
11 përmbyllëse duke bërë një përmbledhje të parashtrimeve tona.

12 Megjithatë, së pari, më lejoni të them këtë. Ndërmjet
13 viktimave në këtë çështje ka një mori sjelljesh dhe qëndrimesh
14 të tyre në raport me UÇK-në. Kemi viktimat të cilat kanë qenë
15 pjesëtarë të UÇK-së ose që dëshironin të bëheshin anëtarë të
16 saj, të kyçeshin në të, apo që kanë dhënë mbështetjen e tyre
17 për UÇK-në dhe ka viktimat të cilat ishin dhe mbeten dhe sot e
18 kësaj dite kundër saj. Dua ta bëj shumë të qartë që nuk është
19 roli ynë si Mbrojtje e Viktimave dhe nuk është pjesë e kësaj
20 deklarate hapëse, që të bëjmë ose të japim një gjykim të asnjë
21 lloji për UÇK-në si organizatë.

22 Kur flasim për krimet e kryera kundër viktimave, duhet
23 gjithmonë të kuptohemi që i referohemi krimeve të kryera nga
24 pjesëtarë të caktuar të UÇK-së dhe nuk është se kjo duhet të
25 kuptohet si akuzim i organizatës në vetvete, i UÇK-së në

1 vetvete. Tani pasi kam bërë këtë qartësim më lejoni që të
2 vazhdoj me pikën e parë, viktimat dhe çfarë ju ndodhi atyre.

3 Synimi ynë është që me avancimin e këtij gjykimi ne nuk
4 duhet të harrojmë dy gjëra. Së pari, që këto ngjarje kanë
5 ndikuar mbi njerëz real, njerëz konkret; dhe, së dyti, që ky
6 gjykim ka rëndësi të jashtëzakonshme për ta. Dua të filloj me
7 ata, me cilët janë viktimat, pra, kush janë viktimat në këtë
8 çështje.

9 Pika e parë e rëndësishme është të theksohet diversiteti
10 i tyre. Viktimat në këtë çështje nuk duhet të kuptohen si një
11 grup homogjen por si një përfaqësim i shoqërisë kosovare në
12 vitin 1998 dhe 1999. Ndërmjet tyre janë anëtarë të
13 komuniteteve shqiptare, serbe dhe rome. Janë anëtarë të
14 besimeve myslimane, katolike dhe ortodokse. Disa prej tyre nuk
15 kishin asnjë pikë interesi në politikë. Ndërkohë që të tjerë
16 ishin pjesëtarë të LDK-së. Disa ishin fëmijë kur krimet janë
17 kryer kundër anëtarëve të familjes së tyre, ndërkohë që të
18 tjerë ishin në moshë mesatare. Ata kishin pozicione të
19 ndryshme, poste të ndryshme në jetë. Dhe siç mund të pritet
20 sigurisht që kishin perspektiva të ndryshme për të.

21 Nuk duhet të jetë çudi që edhe pse ato janë vendosur në
22 një grup për qëllimet e përfaqësimit të tyre përpara këtij
23 procesi gjyqësor, ata janë dhe mbeten diçka më tepër sesa 140
24 individë.

25 Por ajo çfarë ndajnë këta persona është një gjë, kanë një

1 gjë të përbashkët: Ata ishin viktima të krimeve që nuk kishin
2 pikë justifikimi, krimeve që sollën vdekje, vuajtje në jetët e
3 tyre për gjëra që nuk ishin fare faji i tyre. Për secilin prej
4 tyre një ditë ndryshoi jetën e tyre përgjithmonë ose, në shumë
5 raste, i dha fund jetës së tyre. Kjo ishte dita që ata u vunë
6 në shënjestër.

7 Ajo ditë erdhi në forma të ndryshme për njerëz të
8 ndryshëm. Disa ishin me familjet e tyre, madje dhe duke
9 festuar me ta. Ndërkohë që të tjerë jetonin përditshmërinë e
10 tyre. Disa thjesht po bënë një udhëtim i cili u shkurtua, u
11 ndërpre menjëherë në një rrugë. Ndërkohë që të tjerët ishin
12 duke fjetur në shtrat kur burrat e maskuar erdhën dhe morën
13 bashkëshortët e tyre, baballarët e tyre. Disa prej tyre po
14 përpiqeshin që të kyçeshin në UÇK. Të tjerët ishin të
15 angazhuar për të punuar me LDK-në atë ditë. Ishin mësues,
16 ishin oficerë, ishin ndërtues, fermerë të rrëmbyer me pushkën
17 në kokë.

18 Asgjë nuk mund të justifikojë atë çfarë iu bë atyre pasi
19 u morën. Disa nga dëmtimet e bëra për ta ishin thjesht fizike,
20 janë rrahur, janë torturuar në mënyra që i kanë dhënë plagë
21 gjatë gjithë kohës, kanë shkaktuar humbje dhëmbësh, të thonjve
22 apo dëmtime të tjera të natyrës fizike. Ata që janë torturuar
23 kanë kaluar vuajtje të tmerrshme në atë kohë dhe kanë vazhduar
24 që të vuajnë, disa prej tyre edhe sot e kësaj dite, duke qenë
25 të traumatizuar, me makthe dhe në shumë raste transportohen në

1 kohën kur ditët i kishin të mbushura plot me dhimbje.

2 Por humbjet e tyre nuk përfunduan aty. Për shumë nga të
3 mbijetuarit humbja më e madhe ishte humbja e qetësisë së
4 mendjes. Sikurse thotë njëri:

5 "Sigurisht, unë vuaj akoma nga kockat që më dhëmbin për
6 shkak të faktit sesi jam mbajtur në atë vend, megjithatë kjo
7 dhimbje nuk krahasohet fare me dëmtimin psikologjik që kam
8 pësuar".

9 Ju flisni me ta dhe ata do t'ju thonë gjëra të tilla, për
10 shembull, që "Fle me fytyrën nga dera gjatë natës dhe jam ende
11 i frikësuar që burrat mund të kthehen përsëri".

12 Ata janë me ankth dhe i kanë sytë hapur. Ata i ndjek edhe
13 sot e kësaj dite imazhi i asaj çfarë kanë pësuar vite më parë.
14 Kanë net të tëra që i ka lënë pa gjumë. Disa prej tyre e kanë
15 të vështirë që të flasin për këtë aspekt të dëmtimit që kanë
16 pësuar sepse e shikojnë këtë si shenjë dobësie. Por fakti që
17 ata nuk e kanë lënë pas krahëve dëmin e shkaktuar dhe vuajtjen
18 e shkaktuara është shumë e qartë në momentin kur t'i flet me
19 ta, nga emocionet e dukshme, nga lot që ju vijnë menjëherë në
20 sy.

21 Në disa raste familjet e tyre ndihen që ata nuk janë
22 kthyer të njëjtët persona sikurse në momentin që u morën dhe
23 ata duhet të përshtaten për të jetuar me dikë që ka ndryshuar
24 si rezultat i dëmtimit që kanë pësuar.

25 Familjet e atyre të cilët nuk mbijetuan kanë vuajtur

1 humbje të një natyre tjetër. Ata kanë humbur njerëzit e
2 dashur, bashkëshortët, prindërit, motrat dhe vëllezërit,
3 fëmijët, anëtarë të ngushtë të familjes. Citoj një prej
4 viktimave në këtë grup:

5 "Ndihem sikur më ka ikur gjysma e zemrës dhe kjo gjysmë
6 nuk mund të plotësohet nga asgjë tjetër. Dhimbja dhe stresi me
7 të cilin më duhet të jetoj për shkak të mënyrës sesi u vra ai
8 është një dhimbje, është një makth që e mbaj me vete dhe do ta
9 mbaj pafund".

10 Një tjetër viktimë përdor një metaforë të qymyrit të
11 djegur për të përshkruar, për të na përshkruar ne ndikimin
12 psikologjik të rrëmbimit të babait të tij dhe më pas vrasjes
13 së tij dhe dhimbjes që ajo ka kaluar për shkak të këtyre
14 ngjarjeve. Ajo na shpjegoi se kur digjet qymyri nuk mbetet
15 asgjë përveçse pluhuri edhe kjo është mënyra sesi ndihet ajo,
16 e mbaruar. Kjo ndjenjë është kaq e fortë sa ndonjëherë ajo
17 madje ndjen sikur e merr erë qymyrin e djegur.

18 Disa kanë pritur me vite të tëra me radhë për të gjetur
19 një trup në mënyrë që të mund ta varrosin atë me dinjitet dhe
20 të kenë një vend ku të qajnë, ndërkohë që disa prej tyre, disa
21 të tjerë nuk e kanë pasur këtë mundësi pasi trupat e të
22 dashurve të tyre nuk janë gjetur. Disa shohin komunitetet e
23 tyre lokale dhe vrasin mendjen në qoftë se ata, pra, bëhen me
24 njerëzit që janë fajtorët me kryesit e krimeve të tilla.

25 Ndërkohë që disa prej humbjeve të tjera shkojnë më tej.

1 Ka njerëz të cilët kanë humbur vendin e tyre. Ka serbë dhe
2 shqiptarë që ndjejnë që nuk kishin asnjë zgjidhje tjetër veçse
3 të largoheshin dhe të mos ktheheshin më kurrë në Kosovë. Disa
4 u ndjenë që nuk mund të jetonin në një vend ku ishte shkaktuar
5 kaq shumë dëm. Për disa, kjo ndjesi vazhdonte pasi ata
6 mendonin se nuk do të ktheheshin asnjëherë të sigurtë në
7 shtëpi. Janë persona që kanë lënë pas shpine shtëpitë e tyre,
8 tokën e tyre, zotërimet e tyre, pronat e tyre duke filluar
9 diku tjetër nga e para.

10 Ndërkohë ka persona të tjerë të cilët kanë mbajtur
11 shtëpitë e tyre por që nuk e kanë ndjenjën e sigurisë më.

12 Edhe megjithëse shumë njerëz nuk duan që t'i pranojnë
13 fakte të tilla, viktimat në këtë çështje janë shënjestruar,
14 janë rrëmbyer nga njerëzit që i përkisnin UÇK-së. Ata janë
15 mbajtur në qendra ndalimi të menaxhuar, të administruar nga
16 individë që i përkisnin UÇK-së dhe janë torturuar dhe vrarë
17 sërish nga persona që i përkisnin UÇK-së.

18 Për të mbijetuarit e torturës edhe keqtrajttimeve të tjera
19 dhe për ata persona, anëtarët e familjeve të cilëve janë
20 vrarë, dëmi i tyre është shumëfishuar nga mënyra sesi disa
21 njerëz mundohen që t'i etiketojnë ata dhe kjo më çon mua në
22 temën 2, klima në Kosovë.

23 Është shumë e rëndësishme të kuptojmë sesi shumë viktima
24 ndihen, sesi ndjejnë ata që konsiderohen nga disa pjesë të
25 shoqërisë kosovare dua ta theksoj - jo nga të gjithë shoqëria

1 e Kosovës, por nga disa pjesë të saj. Ata e shohin veten që
2 janë etiketuar si tradhtarë ose si persona që janë të
3 papëlqyer vetëm thjesht për faktin që janë viktimat. Me fjalë
4 të tjera, ata vazhdojnë që të dëmtohen nga e para për shkak të
5 saj çfarë ju ka ndodhur atyre gjatë konfliktit.

6 Dhe ky dëmtim i mëtejshëm ka ndikim mbi familjet e tyre
7 dhe megjithëse këta janë persona të cilët nuk janë të dëmtuar
8 në mënyrë të drejtpërdrejtë pavarësisht kësaj ata janë
9 etiketuar si anëtarët e tjerë të familjes së tyre. Dhe kjo
10 tregohet në mënyra të ndryshme. Për shembull, me fëmijët që
11 kanë frikë të shkojnë në shkollë, të rritur që kanë ndjesinë
12 që karrierat e tyre janë prishur për shkak të lidhjes me
13 viktimën.

14 Viktimat që ne përfaqësojmë i kundërshtojnë këto
15 etiketime si tradhtarë ose persona të urreyer.

16 Këto janë thjesht etiketime që janë lidhur me këta
17 persona për asnjë arsye tjetër po përveç faktit që ata janë të
18 lidhur me krimet ndaj të cilëve kanë vuajtur dhe për faktin që
19 kanë kërkuar drejtësi për çfarë u ka ndodhur. Me fjalë të
20 tjera, janë etiketuar në këtë mënyrë vetëm thjesht për faktin
21 që kanë kërkuar diçka që do ta kërkonte çdo person normal në
22 një situatë të tillë: Pra, që faktet të vërtetoheshin përpara
23 një gjykate. Dhe kjo nuk është një gjë jopatriotike për t'u
24 bërë.

25 Por etiketat të vrasin. Një person na tregoi për

1 krenarinë e tij dhe mënyrën sesi personat e mëparshëm të
2 familjes së tij kanë dhënë kontributet e veta për Kosovën që
3 kanë marrë pjesë në luftime për gjenerata të tjera me radhë
4 dhe ndërkohë pavarësisht pjesëmarrjes së familjarëve dhe
5 pararendësve të tij në luftëra kundër otomanëve dhe nazistëve,
6 ai edhe sot e kësaj dite etiketohet si jopatriot.

7 Disa prej tyre janë të frikësuar, janë të frikësuar për
8 hakmarrjet, janë të frikësuar për jetët e tyre, janë të
9 frikësuar se ka dëshmitarë të vrarë në procese të tjera
10 gjyqësore që lidhen me ngjarjet në Kosovë, ata e dinë që disa
11 në Kosovë do kishin preferuar të heshtnin. Por nuk do ta bëjnë
12 këtë. Janë edhe më të fortë dhe më të fortë se rrëmbyesit e
13 tyre dhe vrasësit e tyre dhe më të fortë seç mund ta
14 imagjinonin ata. Ata e dinë që kurajo nuk do të thotë të mos
15 kesh frikë. Do të thotë të bësh diçka ndonëse ke frikë.

16 Ka të tjerë që nuk kanë frikë sidomos nga viktimat që
17 janë në moshë më të thyer që ndihen goxha të qetë sa i takon
18 fatit, ç'pret fati për ta, për sa kohë mund të thonë atë që
19 duan të thonë.

20 Viktimat që po janë po ashtu dëshmitarë do t'i thonë
21 gjërat pavarësisht çdo gjëje që mund të ndodhë. Të gjithë i
22 kushtojnë shumë rëndësi këtij procesi gjyqësor dhe e vendosin
23 veten përpara çdo dëmi.

24 Edhe përveç kësaj klime ka dhe pjesë të medias në Kosovë
25 që përpiqen të hedhin hije dyshimi mbi punën e kësaj Gjykate.

1 Dhe do të shohim, përmes dëshmitarëve këtu, që, në fakt, nuk
2 është një qasje me të cilën pajtohen. Përkundrazi, ndjehen
3 edhe më të fortë, se të paktën më në fund, kjo Gjykatë ju
4 ofron një farë llogaridhënieje.

5 Shumë viktima besojnë se shumica e personave në Kosovë
6 nuk i gjykojnë viktimat në këtë formë, por i mbështesin ata
7 siç mbështesin këtë Gjykatë. Por ata nuk janë zërat që
8 dëgjojnë më shpesh në publik apo në media. Ata janë shumica që
9 hesht.

10 Kemi dy histori këtu që do të diskutojmë për shqiptarët e
11 Kosovës. Një fokusohet tek kuraja e luftëtarëve të UÇK-së dhe
12 roli i tyre për sigurimin e pavarësisë. Por historia tjetër,
13 historia e krimeve që janë kryer nga anëtarët e UÇK-së, është
14 më e vështirë për disa persona ta dëgjojnë e ta pranojnë, po
15 kjo është në mënyrë të pashmangshme historia që ne do të
16 dëgjojmë e do të fokusohet kjo Gjykatë dhe ajo është e
17 vërteta.

18 A është nevoja që këto dy histori të konkurrojnë me
19 njëra-tjetrën? Është krejt normale që të dyja të jenë të krejt
20 të vërteta. Dhe do na ndihmonte ta shihnim këtë edhe nga
21 perspektiva e viktimave, sepse ju do të dëgjoni disa prej tyre
22 që do të thonë ata prisnin që të ishin serbët ata që do të
23 ishin personat që do t'u krijonin rrezik gjatë konfliktit.
24 Por, për viktimat shqiptarë, fakti që ishte vetë ana e tyre,
25 që ishin bashkëkombësit të tyre që po e bënë këtë, e bëri

1 edhe më të vështirë ta pranonin. "Pse po na e bëjnë këtë?"
2 këtë deshën të dinin.

3 Dhe është interesante, se mund të dëgjoni të njëjtën gjë
4 edhe nga viktimat serbe, sesa të surprizuar ishin dhe ata kur
5 kuptuan që shqiptarët kishin marrë armët kundër tyre thjesht
6 për shkak të kombësisë së kishin, ndonëse kishin jetuar në
7 paqe me komshinjtë e tyre shqiptarë.

8 Pra, në përmbledhje, janë bërë përpjekje për t'i
9 turpëruar shqiptarët që të mos flasin. Dhe do të them këtë si
10 kundërpërgjigje: Këto përpjekje nuk kanë funksionuar dhe nuk
11 do të funksionojnë.

12 Për viktimat serbe shumë ikën nga Kosova. Sigurisht
13 viktimat pjesëmarrëse në proces i të njëjtës trysni nga
14 komuniteti. Çmimi që duhet të paguanin disa prej tyre në fakt
15 ishte jeta në mërgim.

16 Titulli im i tretë është e drejta e viktimave në këtë
17 gjykim.

18 Pikë së pari, ne identifikojmë të drejtën për të
19 vërtetën. Ligji është shprehur mbi këtë aspekt dhe viktimat e
20 krimeve kanë të drejtën për të zbuluar të vërtetën, Kanë të
21 drejtën për të dëgjuar dëshmi të sakta dhe të pranohen
22 zyrtarisht vuajtjet që kanë pësuar ata dhe anëtarët e familjes
23 së tyre dhe roli i atyre që është përgjegjës për këto përvoja
24 të tmerrshme që patën.

25 E drejta për të vërtetën. E di që duket një nocion pak

1 abstrakt, por ju garantoj që nuk është kështu për viktimat.
2 Disa nga viktimat kanë jetuar më shumë se 20 vjet pa pasur një
3 ide të qartë lidhur me këto krime pse ata dhe të dashurit e
4 tyre ishin në shënjestër dhe ku është përgjegjësia për dëmin
5 që u shkaktua atyre.

6 Duan të gjejnë përgjigje për këto pyetje sepse këto
7 ngjarje kanë luajtur një rol vendimtar në jetën e tyre. Për
8 ata të jetonin pa përgjigje ishte si të bashkëjetonin me
9 padrejtësinë. Ata kanë të drejtën ta shohin, të hedhin
10 vështrimin në këtë çështje gjyqësore për të gjetur përgjigje,
11 duke shpresuar që këto përgjigje në të vërtetë do të jepen.

12 Unë do t'i lutesha Sekretares së Gjykatës të hapë
13 prezantimin PowerPoint shkurtimisht. Dhe mund të përcillen
14 publikisht. Thjesht kemi hequr disa, kemi marrë disa nene nga
15 Rregullorja dhe nga Ligji dhe i kemi vendosur në diapozitiv
16 për t'ju treguar bazën për këtë.

17 Nëse mund të shohim diapozitivin e parë, ju lutem.

18 Pranimi është pika e tretë, të drejtat e viktimave në
19 këtë gjykim. Neni 22, pika 3, mund ta shohim qysh në fillin të
20 diapozitivit, ku thuhet:

21 "Interesi personal i viktimës dhe të drejtat e viktimave
22 në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë
23 njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi".

24 Po unë do të fokusohem tek pranimi për pak çaste.

25 Pranimi i krimeve. Çfarë nënkupton kjo për viktimat?

1 Pikë së pari, do të thotë të pranojë ky Trup Gjykues se
2 një individ ka pësuar dëm. Fakti që këta persona kanë
3 përjetuar gjëra të paimagjinueshme. Se janë mbajtur të ndaluar
4 kundër vullnetit të tyre, u shkëputën nga bota, në kushte të
5 vështira dhe ndonjëherë në kushte të tmerrshme, me kapuçë në
6 kokë, të prangosur dhe u keqtrajtuat mizorisht në atë gjendje
7 të cenueshme që ishin.

8 Disa, sikurse dëgjuam, u rrahën pamëshirë për ditë me
9 radhë. Disave u hodhën kripë, vërtetë kripë, në plagët e tyre
10 apo ju shkulën thonjtë, apo i kaluan në rrymë elektrike. Të
11 tjerët u përdorën si praktikë qitje me municion të vërtetë.
12 Fatlumët mbijetuan por shumë nuk mundën të mbijetonin. U vranë
13 dhe keqtrajtimi i tyre nuk përfundoi as me vdekjen e tyre, të
14 cilat unë thashë në mënyrën sesi ishin fshehur trupat.

15 Dhe për çfarë? Për shqiptarët, mbase sepse i përkisnin
16 partisë së gabuar politike apo se dyshoheshin si
17 kolaboracionistë, ndonjëherë do të shohim dhe për shkak të
18 provave që, në fakt, mund t'i përshkruajmë si thjesht prova
19 qesharake, si një bazë qesharake.

20 Për serbët, etnia e tyre mjaftonte që të viheshin në
21 shënjestër për kidnapim, për t'u torturuar dhe për t'u vranë
22 pavarësisht faktit se, në fakt, Kosova ishte mëmëdheu i tyre,
23 se atje ishin rritur, kishin jetuar në paqe në atë komunitet
24 dhe kishin kontribuar në të.

25 Këtë nënkuptojmë me pranim dhe rëndësinë që ka pranimi

1 dhe kjo reflektohet dhe në rregullën 134, të cilën po e nxjerr
2 dhe në ekran. Rregulla thekson rolin e veçantë që ka Mbrojtësi
3 i Viktimave në fazat e fundit të gjykimit ku dorëzon një
4 deklaratë mbi ndikimin që kanë pasur krimet e pretenduara mbi
5 viktimat. Siç mund ta shohim, edhe vetë Mbrojtësi i Viktimave
6 duhet të dorëzojë "një deklaratë mbi ndikimin që kanë pasur
7 krimet e pretenduara" dhe këtë do ta bëjë përmes dosjes
8 gjyqësore përfundimtare, siç bën dhe Prokurori i Specializuar
9 edhe Mbrojtja.

10 Nëse i kthehemi diapozitivit të dytë, mund të shohim
11 nenin 22(7) dhe rregullën 159.

12 Trupi Gjykses, në këtë nen, ka kompetencën të pranojë
13 dëmtimin në aktgjykimin e vetë pavarësisht konstatimeve të
14 tjera. Dhe neni 22(7) thotë:

15 "Në aktgjykimin e tij, Trupi Gjykses mundet, që në bazë
16 të ndonjë kërkesë me propozim të vetën në rrethanat e
17 zakonshme, të përfshijë një vendim lidhur me shkallën dhe
18 përmasat e dëmit, humbjes dhe lëndimeve ndaj viktimave ose në
19 lidhje me to dhe i deklaron parimet sipas të cilave vepron".

20 Ky nen plotësohet më tej nga rregulla 159(1) që jep edhe
21 afatin për shqiptimin e aktgjykimit dhe e bën të qartë se
22 aktgjykimi mund të përfshijë një vendim sipas nenit 22(7) të
23 ligjit, pra, nenit që sapo lexova.

24 Pra, ftojme Trupin Gjykses që në aktgjykimin e vet të
25 këtë parasysh nenin 22(7) dhe rregullën 159 dhe të përfshijë

1 dhe vendimin dhe të specifikojë atje që, në fakt, është dhe
2 mënyra më kuptimplotë sesi mund të pranohet dëmi i kryer.

3 Dhe do t'i kthehem tani temës ku do të fokusohemi
4 kryesisht në këtë gjyqësore.

5 Të pranojmë dëmin që është shkaktuar, që është bërë dhe
6 për të marrë një vendim sipas nenit 22(7), është e pamundur pa
7 kuptuar siç duhet këtë dëm. Dhe do të përpiqemi ne të ofrojmë
8 ndihmën tonë me deklaratat tona sa i takon dëmit sipas
9 rregullës 134. Këtu përfshihet fakti që duhet të fokusohemi në
10 këtë gjykim dhe në provat që mund të kenë pak ose aspak
11 rëndësi sa i takon deklaramit të fajësisë së të akuzuarëve.
12 Dhe ata që janë të sistemit të së drejtës zakonore, kjo
13 zhvendoset nga çështja e fajësisë që fillimisht që kur e them
14 këtu duket pak e paqartë, por në fakt nuk është. Të marrësh
15 prova për dëmin është pjesë e detyrës së kësaj Gjykate. Pa
16 marrë këto prova nuk mund t'u jepet viktimave e drejta për
17 pranim, nuk mund të veprojnë në bazë të nenit 22(7) dhe as të
18 marrë një urdhër të bazuar në informacion për zhdëmtim sipas
19 nenit 22(8).

20 Duke pasur parasysh klimën në Kosovë të cilën e
21 përshkrova, ky aspekt i çështjes ka rëndësi më të zgjeruar
22 sesa ajo e një viktime pjesëmarrëse individuale. Konstatimet
23 që bëni në këtë drejtim mund të luajnë një rol sa i takon edhe
24 klimës së armiqësisë që unë ju përshkrova sot më herët. Me
25 fjalë të tjera, për të shpërndarë të vërtetën për atë çka u ka

1 ndodhur vërtetë atyre, gënjeshtër që ju janë thënë rreth
2 viktimave, se janë tradhtarë dhe persona të urryer, të cilën
3 do të ekspozohen më tej.

4 Do të përfshijë pranimin se ajo që u ndodhi atyre ishte e
5 gabuar. Anëtarët e UÇK-së i kthyen krimet e ndalimit në vende
6 krimesh, në vende ku njerëzit zhdukeshin, ku ishin objekt i
7 abuzimeve të papranueshme dhe ku personat vriteshin. Dhe kjo
8 nuk justifikohet nga beteja kundër serbëve.

9 Duhet pranuar se këto krime janë kryer dhe kjo është një
10 pikënisje për të trajtuar këtë version të rremë, sipas së
11 cilit viktimat nuk kanë asnjë kauzë për t'u ankuar por në fakt
12 janë vetë ata problemi.

13 Pjesa tjetër është zhdëmtimi.

14 Të pasurit urdhra zhdëmtimi, sikurse të gjithë e dimë,
15 varet, pikë së pari, nëse ka shpallje fajësie apo jo në këtë
16 çështje. Ne sugjerojmë që kjo temë të trajtohet më mirë pasi
17 të shqiptohet aktgjykimi i Trupit Gjykses dhe këtë e themi,
18 këtë mund ta bëjmë me shumë hollësi dhe mund ta trajtojmë me
19 shumë hollësi në një fazë të mëvonshme. Por, sidoqoftë, kjo
20 është në dorën e Trupit Gjykses dhe duhet që të ndjekim këtë
21 që propozojmë për tre mënyra.

22 Zhdëmtimet, si monetare dhe jo monetare, do të
23 inkuadroheshim më pas apo do të rregulloheshin në kuadër të
24 konkluzioneve të Trupit Gjykses mbi faktet pas aktgjykimit,
25 konkretisht dhe të mos e bëjmë në abstrakt.

1 Së dyti, kjo qasje na duket sikur është konsekuente me
2 rregullën 168, që i jep Trupit Gjykses kompetencën të caktojë
3 ekspertë që të na ndihmojnë me çështjen e zhdëmtimeve. Në një
4 çështje me përmasa të tilla, sigurisht që kërkohen shumë
5 ekspertë të ndryshëm, të cilët mund të jenë akademikë, përveç
6 nëse nuk do të kishte shpallje fajësie.

7 Nga pikëpamja praktike, sugjerojmë që është më mirë ta
8 shqyrtojmë këtë çështje pas shpalljes së aktgjykimit sepse në
9 një çështje me përmasa të tilla, me këtë vëllim materialesh që
10 kemi të gjitha kërkesat e Trupit Gjykses dhe palëve ka krejt
11 kuptim është krejt logjike që ta trajtojmë çështjen e
12 zhdëmtimeve në një fazë kur të jetë e qartë puna që duhet të
13 kryhet dhe t'i japim rëndësinë që i takon.

14 Së fundmi mbi këtë pikë, ju ftojme të mos i referoheni
15 çështjes së litigimit civil në Kosovë, debatet juridik civil
16 në Kosovë sipas rregullës 167 për të gjitha arsyet që Trupi
17 Gjykses ka marrë parasysh në çështjen 05, në çështjen Sali
18 Mustafa, ku doli në përfundimin që në fakt nuk ishte momenti
19 më i përshtatshëm dhe është vendimi me numrin F310.

20 Titulli i katërt apo pika e katërt, zhvillimi i këtij
21 gjykimi nga pikëpamja e viktimave.

22 Ne si mbrojtës të viktimave, kemi për detyrë të
23 garantohe mi që, së pari, të drejtat që kemi evidentuar të jenë
24 të vërteta dhe jo iluzion dhe këto procese të jenë të
25 njëmendta për viktimat pjesëmarrëse në këtë proces dhe, B,

1 Trupi Gjykues të ketë gjithë informacionin që i nevojitet për
2 të krijuar një tablo të qartë të rrethanave të këtyre krimeve
3 dhe pasojave që kanë pasur ata.

4 Objektivi ynë është ta bëjmë këtë duke ndihmuar Trupin
5 Gjykues që ta kuptojnë dëmin që kanë vuajtur viktimat
6 pjesëmarrëse në mënyrë që të pranohet ky dëm dhe aty ku është
7 e mundur të ofrojmë ndihmë për të gjetur të vërtetën.

8 Çfarë duam ne? Sigurisht ne nuk duam të jemi prokurorë në
9 sallën e gjyqit. Nuk kemi asnjë synim që ta bëjmë diçka të
10 tillë. Sidoqoftë, ka disa fusha ku provat që do të paraqesë
11 ZPS-ja do të kenë një interes të veçantë dhe legjitim për
12 viktimat sa i takon përcaktimit çfarë ka ndodhur dhe kush
13 ishte përgjegjës për dëmin që u është shkaktuar atyre.

14 Është e rëndësishme që të gjejmë të vërtetën nëse këta të
15 katër të akuzuar kanë përgjegjësi ligjore për këtë rrjet
16 kampesh që ishin krijuar nëpër Kosovë dhe nëpër Shqipëri. Dhe
17 kjo është një pikëpyetje apo një çështje për të cilën Trupi
18 Gjykues - më falni - do të trajtohet gjerësisht nga Trupi
19 Gjykues në këtë sallë gjyqi.

20 Do të ndodhë shpesh që udhëheqësit të thonë që nuk e
21 dinin se çfarë bënin vartësit e tyre dhe ndonjëherë kjo do të
22 jetë dhe e vërteta. Ndonjëherë do jetë thjesht një gënjeshtër
23 sepse ju konvenon. Ju duhet të vendosni cila vlen në atë rast.
24 Megjithatë ne do bëjmë një konstatim në këtë fazë: Ajo që nuk
25 mund të thotë një drejtues për një kamp ndalimi në Ballkan në

1 fundin e viteve 1990 është pikërisht fakti që nuk ishte në
2 dijeni të rreziqeve që sillte krijimi i kampeve, i vendeve të
3 tilla. Kjo kërkon të mos njohësh historinë që ka ndodhur në
4 ish-Jugosllavi dhe kjo është shumë e habitshme.

5 Të ndalosh njerëzit është të krijosh kushte për t'i
6 abuzuar, për keqtrajtim dhe për t'i vrarë, T'u japësh disa
7 personave kompetenca absolute sa u takon armiqve të perceptuar
8 është një ftesë për të kryer një krim të rëndë. Këto nuk janë
9 mësimet të reja, nuk i mësuam sot dhe nuk kanë qenë të reja as
10 dikur.

11 Pra, nëse këta të akuzuar ishin ndër personat përgjegjës
12 për krijimin, mbështetjen apo përdorimin e këtij rrjeti
13 ndalimi atëherë është çështje interesash të vërtetë dhe
14 legjitim për ata persona që janë dëmtuar dhe për ata që humbën
15 të dashurit.

16 Dhe shkoj në fund, që është dhe titulli im i pestë dhe
17 është dhe përfundimi, kjo është në përmbledhje.

18 Ka gjithmonë persona që thonë se qëllimi justifikon
19 mjetin. Pikëpamja e dikujt varet a kanë qenë aty për t'i
20 dëshmuar këto apo ju jeni një nga mjetet sesi arrihet ky
21 qëllim. Nëse Prokuroria ka të drejtë, atëherë të akuzuarit u
22 angazhuan në dy konflikte. Një ishte fushata ushtarake, pra,
23 lufta kundër serbëve dhe tjetra shënjestronte anëtarët e
24 popullatës civile që i perceptonin si kundërshtarë. Dhe
25 konflikti i dytë ishte mjete për një qëllim.

1 Të mbijetuarit e këtij konflikti të dytë dhe të afërmit e
2 atyre që vdiqën në të janë një grup personash të cilët iu
3 është bërë një e keqe e madhe. Dhe asgjë s'mund ta zhbëjë
4 dëmin që u është shkaktuar, kjo Gjykatë është në pozicion t'u
5 ofrojë një sens drejtësie përmes pjesëmarrjes si viktima dhe
6 në mënyrat si në vijim.

7 Mund t'ju jap mundësinë të kuptojnë pse u kryen këto
8 krime kundër tyre dhe të kuptojnë kush ishte përgjegjës për
9 to. Kjo Gjykatë duhet të jetë në gjendje të pranojë dëmin që u
10 shkaktua dhe mund ta bëjë këtë pavarësisht vendimit në
11 aktakuzë. Është e mundur për këtë gjykatë që të nxjerrë urdhra
12 për zhdëmtim të llojeve të ndryshme që mund të kontribuojnë në
13 procesin e rikuperimit të dëmit që u është shkaktuar viktimave
14 dhe është e mundur, thjesht e mundur, që puna mund të fillojë
15 me procesin e ndryshimit të sjelljes së viktimave të UÇK-së
16 ndër disa në Kosovë.

17 Këto janë synimet që ne, në llogari të tyre, kemi
18 parasysh teksa fillon kjo çështje.

19 Faleminderit. Faleminderit që më dëgjuat.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
21 z. Laws.

22 Sot mbylлим seancën publike. Takohemi nesër më 4 prill në
23 orën 9.00 paradite, për të vazhduar me deklaratat hyrëse të
24 ekipeve mbrojtëse, fillojmë me Mbrojtjen e Thaçit.

25 A ka ndonjë gjë që doni të parashtroni në këtë moment?

1 Faleminderit.

2 Do të doja t'ju kujtoja ekipeve të mbrojtjes të dërgojnë
3 deklaratat hyrëse NJAGJ-së për t'ua shpërndarë përkthyesve se
4 do t'i ndihmonte që të bënin një përkthim sa më të saktë.
5 Sepse të gjithë kanë punuar shumë fort për këtë.

6 Falënderoj palët, Zyrën Administrative për pjesëmarrjen.
7 Faleminderit përkthyesve, stenografit, teknikëve të sigurisë
8 për ndihmën e tyre të shkëlqyer.

9 Seanca mbyllet.

10 --- Seanca mbyllet në orën 15.43

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25